

**GLOBAL
INITIATIVE**

AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME

TENTAKULAT E KRIMIT NDËRKOMBËTAR

Zonat Problematiche të Krimit
të Organizuar nga Vendet e
Ballkanit Perëndimor

WALTER KEMP

KORRIK 2020

TENTAKULAT E KRIMIT NDËRKOMBËTAR

*Zonat Problematike të Krimin të Organizuar
nga Vendet e Ballkanit Perëndimor*

Walter Kemp

Korrik 2020

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Ky raport është hartuar nga Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore (SEE-Obs).

SEE-Obs është një platformë që mbledh së bashku dhe fuqizon organizata të shoqërisë civile në Shqipëri, Bosnjë Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, dhe në Serbi. Observatori kërkon t'i krijojë mundësi shoqërisë civile që të identifikojë, analizojë dhe të krijojë një tablo të prirjeve dhe tendencave kriminale, si dhe ndikimin e tyre mbi trafiket e paligjshme, qeverisjen, zhvillimin, marrëdhëniet ndëretnike, sigurinë dhe respektimin e ligjit. SEE-Obs mbështet organizatat e shoqërisë civile në punën e tyre për monitorimin e zhvillimeve dhe tendencave të krimin të organizuar në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Observatori u krijua në vitin 2018, pas takimit të Londrës mbi vendet e Ballkanit perëndimor, në kuadër të Procesit të Berlinit.

Ky raport bazohet mbi të dhëna, informacione dhe analiza të mbledhura nga organizata dhe aktivistë të shoqërisë civile nga vendet e Ballkanit perëndimor, me ndihmën dhe kontributin e një grupi prej 15 studiuesish dhe ekspertësh. I falënderojmë për ndihmesën e vyer përgjatë këtij procesi, si dhe për angazhimin e hapur dhe konstruktiv gjatë punës studimore. Të dhënat nga puna kërkimore u analizuan dhe u përmbledhën nga Walter Kemp, me ndihmën e Fatjona Mejdinit, Ugi Zvekic, Fabian Zhillës, dhe Kristina Amerhauser.

Ky raport u hartua me mbështetjen financiare të Fondit për Konfliktet, Stabilitetin, dhe Sigurinë të Mbretërisë së Bashkuar (United Kingdom's Conflict, Stability and Security Fund). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, dhe nuk pasqyron domosdoshëmrish pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.

NË LIDHJE ME AUTORIN

Walter Kemp drejton zyrën e studimeve në Iniciativën Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), dhe drejton Observatorin e Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore (SEE-Obs). Më parë ka mbajtur një sërë postesh të rëndësishme në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, ka qenë zëvendës president i Institutit Ndërkombëtar të Paqes (International Peace Institute), si dhe ka punuar si zëdhënës dhe autor deklaratash e fjalimesh pranë Zyrës mbi Drogën dhe Krimin të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Është autor i një sërë punimesh mbi parandalimin e konflikteve, marrëdhëniet midis krimin dhe konflikteve, si dhe mbi çështje që lidhen me sigurinë në Evropë.

© 2020 Global Initiative Against Transnational Organized Crime.

Të gjitha të drejtat e

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdoq formë apo mënyre pa miratimin me shkrim të Global Initiative

Kopertina nga Flame Design

Hartografia: Paulina Rosol-Barrass

Për çdo informacion, ju lutemi të kontaktoni:

The Global Initiative Against Transnational Organized Crime

Avenue de France 23

Geneva, CH-1202

Switzerland

www.globalinitiative.net

PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive	1
Zona problematike në botë.....	2
Konteksti: Shpërngulja si pasojë e trazirave.....	4
Periudha komuniste: Krimi i organizuar në Jugosllavi dhe Shqipëri	7
Shqipëri.....	8
Lidhja me Turqinë.....	9
Lufta dhe pasojat e saj	11
Kriminelët në vijën e frontit.....	11
Sanksionet dhe ‘fabrika e krimit’.....	12
Shpërthimi i një vale krimi brenda vendit.....	13
Shembja e piramidës shqiptare.....	15
Krim dhe konflikt në Kosovë.....	15
Shtet mafioz.....	16
Mblidh mendjen ose mblidh plaçkat.....	17
Shqiptarët zgjerojnë territorin.....	19
Shpërngulja dhe diaspora.....	20
Evropa Perëndimore	22
Itali: Partnerë në krim.....	24
Spanjë: Nga hajdutë në bosë.....	27
Hollandë: ‘ <i>Jugomafia</i> ’.....	29
Republika Çeke.....	32
Afrika e Jugut	35
Importim kriminelësh.....	35
Krejçir dhe Gavriç.....	36
Larje hesapesh.....	37
Aktorë të rinj në skena të reja?.....	39
Turqi: Porta e hyrjes për në lindje	41
Lidhje të forta midis Turqisë dhe Ballkanit.....	41
Nga valixhet tek kamionët.....	42
Thithja e investimeve dhe tregtisë.....	43
‘Korridori Ballkanik’ i heroinës.....	44
Kanabis dhe super marihuana.....	46
Trafikimi i emigrantëve.....	47

Amerika Latine	51
Zanafilla e grupeve të kokainës	51
Pse Amerika Latine është vend kaq tërheqës	53
Në vendin e duhur dhe në kohën e duhur	55
Roli i grupeve nga vendet e Ballkanit perëndimor	56
Korridoret dhe mënyrat e trafikimit	60
Metoda të tjera të trafikimit të drogës.....	64
Një model i suksesshëm biznesi	65
Australia: Tentakulat zgjaten deri poshtë në jug	67
Mafia ballkanike është vënë në lëvizje	70
Përfundime	74
Karakteristikat e grupeve.....	75
Një model biznesi i pashoq.....	76
Faktorë ndihmës.....	76
Bashkëpunimi midis forcave të ruajtjes së rendit	77
Një përjasje e shumanshme	78
Roli i shoqërisë civile.....	80
Dhunë dhe heshtje.....	80
Shënime	81

Prishtinë, Kosovë. Lufta e Kosovës gjatë viteve 1998 dhe 1999 nuk shkaktoi vetëm ►
një tragjedi humanitare, por krijoi dhe një terren pjellor për krimin e organizuar.

© Pjeter Gjergjaj/EyeEm nga Getty Images





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Vendet e Ballkanit perëndimor shpesh konsiderohen si zona problematike të krimit të organizuar. Ashtu siç është raportuar edhe në publikime të tjera të Iniciativës Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC), ky rajon është një korridor për trafikimin e drogës, armëve dhe qenieve njerëzore, dhe vuan nga nivele të larta krimi dhe korrupsioni. Sidoqoftë, e parë nga një këndvështrim global, Ballkani perëndimor është një rajon relativisht i qëndrueshëm. Vetë rajoni paraqet një treg të vogël për mallra dhe shërbime të paligjshme – dhe disa nga grupet kriminale nga Ballkani perëndimor e kanë kuptuar se rajone të tjera ofrojnë pasuri më të mëdha.

Ky raport përqendrohet mbi zona problematike të krimit të organizuar në rang global, nga grupe që vijnë nga gjashtë vende të Ballkanit perëndimor – Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kosova,¹ Mali i Zi, Maqedonia e Veriut,² dhe Serbia. Ky raport nuk pretendon të jetë gjithëpërfshirës. Në pamundësi për të marrë nën shqyrtim gjithçka, studimi përqendrohet kryesisht mbi disa vende në Evropën perëndimore dhe Amerikën latine, si dhe mbi Afrikën e Jugut, Turqinë, dhe Australinë. Këto shtete apo rajone u përzgjedhën pasi aty ndeshen të gjitha tipet dhe llojet e grupeve të përfshira në aktivitete kriminale, tregjet e ndryshme kriminale, natyrën e lidhjeve ndërkombëtare të krimit, si dhe evoluimin e aktiviteteve që kryhen në vende të huaja nga grupe kriminale nga Ballkani perëndimor. Po kështu këto janë vende ku GI-TOC bashkëpunon ngushtë me ekspertë vendas. Më shumë vëmendje mund t'i kushtohet edhe grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor që veprojnë në Brazil, Bullgari, Gjermani, Greqi, Rumani, Shtetet e Bashkuara, si dhe në Afrikën veriore. Këto vende do të jenë në fokusin e një studimi tjetër.

Ky raport bën një prezantim të faktorëve nxitës, në lidhje me mënyrat dhe arsyet se si grupe dhe individë nga Ballkani perëndimor arritën të krijojnë baza për kryerjen e aktiviteteve kriminale në vende të ndryshme të botës. Ky raport analizon gjithashtu edhe forcimin dhe rritjen e influencës të disa grupeve nga Ballkani perëndimor gjatë 20 viteve të fundit, që nga fillimet e tyre si grupe hajdutësh e keqbërësish të vegjël, në korrierë krimi, deri sa u kthyen në shpërndarës kryesorë të drogave, me rrjete kriminale që shtrihen nga America Latine në Evropën perëndimore, dhe Afrikën e Jugut. Raporti analizon edhe lidhjet që këto grupe mbajnë me Ballkanin perëndimor. Sidoqoftë, duhet patur parasysh se ndonëse ky raport përqendrohet mbi grupe kriminale nga Ballkani perëndimor, nuk duhet të harrojmë se në shumicën e vendeve të huaja ku operojnë këto grupe elementi kriminal mbizotëruar mbeten bandat kriminale vendase.

◀ Podgorica, Mal i Zi. Përgjatë viteve të fundit, Spanja është shndërruar një qendër për grupet kriminale nga ky vend. © Aiman Suhaimi/EyeEm për Shutterstock

Shumica e grupeve kriminale nga vende të Ballkanit perëndimor i zhvillojnë aktivitetet e tyre në vende të tjera jashtë rajonit.

Raporti bazohet edhe mbi studimet e mëparshme të GI-TOC për të identifikuar zonat me aktivitet të dënuar kriminal në nivel lokal, rajonal dhe global. Ky raport mund të konsiderohet edhe bashkëshoqërues i raportit të GI-TOC me titull *Zonat Problematike të Krimin të Organizuar në Ballkanin Perëndimor (Hotspots of Organized Crime in the Western Balkans)* të publikuar në maj 2019. Ashtu si dhe studimi i vitit 2019, ky raport është prodhim i Observatorit të Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore të GI-TOC. Studimi bazohet mbi të dhëna dhe analiza të mbledhura dhe të bëra publike nga aktivistë të shoqërisë civile në Ballkanin perëndimor, si dhe nga ekspertë (veçanërisht nga gazetarë investigativë) në vendet ky zhvillojnë aktivitetin e tyre kriminal grupe kriminale nga Ballkani perëndimor.

Ky raport bazohet mbi informacione të mbledhura nga burime të hapura, dhe intervista. Megjithatë raporti është bazuar mbi informacione të mbledhura nga studiues vendas në rajonet e analizuar nga ky raport, ai është i kufizuar nga lloji dhe sasia e informacionit në qarkullim. Zakonisht informacioni që vihet në dispozicion të publikut i referohet ngjarjeve dhe incidenteve që tashmë kanë ndodhur dhe që janë raportuar në media, por kjo është vetëm një fraksion i asaj që ndodh në realitet. Nga ana tjetër, ka edhe një farë vonese kohore deri sa të përfundojë procesi i analizimit të situatës dhe informacionit. Raporte të kësaj natyre analizojnë ngjarje të së kaluarës, por kriminelët janë gjithmonë në evoluim për t'iu përshtatur vazhdimisht zhvillimeve dhe hapësirave të reja për veprim, për të zbuluar tregje të reja dhe të zhvillojnë teknika të reja (si transporti i narkotikëve me avionë, apo *narco-jets*; komunikimi me telefonë celularë të koduar; dhe pastrimi i parave nëpërmjet kriptomonedhave, apo në në parajsë bankare në ishuj të ndryshëm). Forcat e ruajtjes së rendit kanë për detyrë që t'i paraprijnë këtyre zhvillimeve kriminale.

Ky raport u përpilua në fund të muajit mars 2020, dhe gjatë shkrimit të këtij raporti nuk ishte e qartë se çfarë ndikimi do të kishte mbi tregjet e krimin kriza e COVID-19, dhe kufizimet e vendosura mbi lëvizjet e popullatës. A do të shtohet kontigjenti i ushtarëve për grupet kriminale, dhe a do të krijohen zona të reja problematike, apo do të ketë më pak kërkesa për drogë? Ndikimi i pandemisë globale mbi aktivitetin e grupeve nga Ballkani perëndimor do të jetë një çështje që do të ndiqet nga afër nga Observatori i Shoqërisë Civile Kundër Krimin të Organizuar në Evropën Juglindore të GI-TOC.

Zona problematike në botë

Ballkani perëndimor paraqet një treg relativisht të vogël për krimin e organizuar. Shumica e grupeve kriminale nga ky rajon kryejnë aktivitetet e tyre jashtë këtij rajoni, veçanërisht në Evropën perëndimore dhe Amerikën Latine. Këto zona problematike analizohen në këtë raport.

Ndonëse ka patur pretendime në media për 'kartel ballkanik', nuk ka të dhëna apo prova për ekzistencën e tyre, por sidoqoftë grupe të ndryshme kriminale bashkëpunojnë më njëri-tjetrin, madje ka edhe grupe multietnike. Shumica e grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor veprojnë në mënyrë të efektshme dhe pa rënë në sy në zona problematike nëpër botë, megjithatë namin që kanë marrë si të dhunshëm. Pjesa më e madhe e akteve të dhunës nga grupet kriminale duket se ka të bëjë me larje hesapësh brenda radhëve të tyre, apo me grupe rivale.

Grupet nga ky rajon janë modernë, dinamikë dhe të zgjuar, kanë treguar se kanë zotësi të adaptohen dhe të përdorin taktika të reja, të përdorin teknologjinë për avantazhin e

tyre (për shembull, të përdorin forma të koduara komunikimi; identifikimi i korridoreve dhe mënyrave të reja të trafikimit, si 'avionët e drogës' për të trafikuar narkotikë; pastrimi i parave nëpërmjet konvertimit në kriptomonedha, transferimi i parave në parajsë financiare ofshore, apo në vendet e origjinës). Raportohet se grupe të tilla janë përgjegjëse për financimin, transportimin dhe shpërndarjen e sasive të mëdha të kokainës nga Amerika e Jugut në Evropë. Aftësia e tyre për të bashkëpunuar me grupe kriminale vendase dhe për të shtënë në dorë sasi të mëdha kokaine në vendin e prodhimit, si dhe prania e tyre në qytetet kryesore portuale evropiane, tregon se këto grupe janë në gjendje të kontrollojnë të gjithë zinxhirin e trafikimit të kokainës.

Inteligjenca operative e këtyre grupeve i ka krijuar mundësi që të ngjiten më lart në hierarkinë kriminale në vende të ndryshme gjatë 20 viteve të fundit. Në disa vende (si në Itali, Spanjë, Ekuador, në Mbretërinë e Bashkuar, dhe Hollandë) janë kthyer në faktorë kyç, veçanërisht për trafikun e kokainës. Tregu më i madh për trafiket e grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor është Evropa perëndimore.

Fillimisht kriminelët shkuan në shumë nga zonat problematike që analizohen në këtë raport, si rezultat i kushteve të vështira të shkaktuara nga lufta dhe paqëndrueshmëria në vendet e Ballkanit perëndimor në vitet 90. Me përjashtim të Amerikës Latine, grupet kriminale nga Ballkani perëndimor veprojnë në shtete ku ka shumë emigrantë nga ky rajon, duke përfshirë këtu Hollandën, Italinë, Turqinë dhe Afrikën e Jugut. Është e rëndësishme të nënvizojmë faktin se, ndonëse problemet që lidhen me krimin e organizuar në Ballkanin perëndimor janë transferuar në vendet perëndimore, aktivitetet e këtyre grupeve kriminale kanë dëmtuar reputacionin e vendeve të tyre të origjinës, sidomos në lidhje me procesin e pranimin në BE. Për më tepër, disa nga problemet dhe vështirësitë që shkaktuan largimin e njerëzve nga vendet e Ballkanit perëndimor në të kaluarën, vazhdojnë të ekzistojnë akoma – si, papunësia, mungesa e shanseve për të çarë përpara, pakënaqësia ndaj qeverive të këtyre vendeve, si dhe vonesat në procesin e integritimit evropian. Nëse nuk zgjidhen këto probleme, atëherë radhët e grupeve kriminale nga vendet e Ballkanit perëndimor do të shtohen dita-ditës.

Eliminimi i kërcënimit që vjen nga grupet kriminale ballkanike duhet të vijë edhe nga jashtë, nëpërmjet një bashkëpunimi ndërkombëtar më të ngushtë midis autoriteteve ligjvënëse, në identifikimin dhe konfiskimin e pasurive, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit, pasi kriminelët preferojnë të përdorin disa identitete për të humbur gjurmët. Gjatë periudhës 2018–2020 pati një rritje të numrit të operacioneve të suksesshme ndërkombëtare në luftën kundër narkotikëve, dhe në disa nga këto operacione policore u konfiskuan disa tonelata drogë. Sidoqoftë, ka nevojë që të përmirësohet bashkëpunimi midis forcave të ruajtjes së rendit në shtetet e prodhimit dhe destinacionit të trafikeve, si dhe me kolegët e tyre në vendet e Ballkanit perëndimor.

Shoqëria civile në vendet e Ballkanit perëndimor dhe në diasporë mund të luajë një rol të rëndësishëm duke kontribuar në forcimin e kulturës së respektimit të ligjit në vendet respektive, t'i bëjë komunitetet më të qëndrueshme, dhe të bëjë thirrje për një shoqëri pa krime dhe dhunë.

Ndërsa komuniteti ndërkombëtar – dhe veçanërisht qeveritë e vendeve të Evropës perëndimore – duhet të përballet me sfidën e reduktimit të kërkesës për mallra dhe shërbimë që ofrohen nga grupe kriminale nga Ballkani perëndimor, dhe të mundohet të përmirësojnë situatën në vende si Ekuadori dhe Kolumbia, ku prodhohet kokaina. Përndryshe tentakulat e grupeve kriminale – përfshi edhe ato nga Ballkani Perëndimor – do të vazhdojnë të shtrihen nëpër të gjithë globin.



Konteksti: Shpërngulja si pasojë e trazirave

Pasojat e bombardimit nga ana e NATO-s në Pejë, ish-Jugosllavi, gusht 1999.

© Scott Peterson/Liaison nga Getty Images

Ndryshime rrënjësore në sistem mund të sjellin çorientim dhe trazira në vend dhe kjo mund të ndikojë mbi tregjet dhe faktorët kriminalë.³ Këto ndryshime mund të krijojnë hapësira dhe terren pjellor për krimin dhe korrupsionin. Federico Varese thotë në librin e tij *Mafia është vënë në lëvizje* se, “organizatat mafioze dalin nga shoqëri që kalojnë nëpër një proces tranzicioni të beftë dhe të vonuar drejt ekonomisë së tregut, nuk kanë struktura ligjore që të mbrojnë në mënyrë të kënaqshme të drejtën e pronës, dhe si pasojë e këtyre proceseve një numër i madh njerëzish të mësuar me dhunën humbasin vendet e punës”.⁴ Ashtu si do të përshkruhet edhe në këtë raport, këto kushte ekzistonin në Shqipëri dhe në shumë vende të ish Jugosllavisë në fundin e viteve 90.

Përveç krijimit të kushteve për formimin e grupeve kriminale, konfliktet apo krizat humanitare shpesh shkaktojnë shpërnguljen e një pjese të madhe të popullsisë, që më pas mund të sjellë ato që Varese e quan ‘transplantim’ të grupeve kriminale. Një rast tipik në këtë drejtim është transplantimi i mafies italiane nga Italia në Shtetet e Bashkuara në vitet 1920. Nga rastet e tjera mund të përmendet transplantimi i mafies ruse pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, apo përhapja e Ibos nga Nigeria në vende të ndryshme të botës.

Gjatë procesit të transplantimit grupe kriminelësh nga vende të Ballkanit perëndimor përfituan nga turbullirat politike në vendet e tyre të origjinës, që po përjetonin ndryshime rrënjësore të sistemit. Edhe Amerika Latine ka përjetuar (dhe vazhdon akoma të përjetojë) kohë të turbullta, si për shembull, armëpushimi dhe paqja pas një konflikti 50 vjeçar në Kolumbi (prodhuesi më i madh i kokainës në botë), dhe trazirat në Venezuelë. Po kështu, qeverisje dhe institucione të dobëta në shtete si Ekuadori dhe Afrika e Jugut ka krijuar hapësira zhvillimi për grupet kriminale vendase dhe atyre që vijnë nga jashtë. Ky element mbështet mendimin e Vareses se është më e lehtë për grupet kriminale që të transplantohen në zona ku niveli i besimit ndaj autoriteteve është i ulët, ku mungon angazhimi apo kultura qytetare, dhe kapitali shoqëror. Në sisteme të tilla, komunitetet janë më pak të qëndrueshme dhe ka më shumë hapësira veprimi për kriminelët.⁵

Sidoqoftë, ky raport nëvizon faktin se grupet kriminale mund të depërtojnë edhe në vende të zhvilluara ku ekonomia e tregut është e qëndrueshme. Duket se në këto raste kriminelët përfitojnë nga ekzistenca e diasporave të mëdha në vendet e zhvilluara. Po kështu, është e rëndësishme të kujtojmë se kriminelët nuk lëvizin gjithmonë qëllimisht drejt vendeve të huaja, por shpesh kjo ndodh si rezultat i zhvillimeve të paparashikuara.⁶ A i shkonte në mend atyre burrave që luftonin gjatë viteve 90 në Ballkan se 20 vite më vonë do të bënin pazare kokaine në Brazil, apo do punonin si bodigardë në Afrikën e Jugut? A i shkonte në mendje disa të rinjve nga fshatrat më të varfra të Shqipërisë apo Kosovës nga mesi i viteve 90, se më pas do të bëheshin trafikantë me emër në tregjet e drogës në Londër, Amsterdam apo Romë?

Nga ana tjetër, përveç studimit të grupeve mafioze me strukturë hierarkike, është e rëndësishme që të analizohen edhe aktivitete të paligjshme që kryhen nga rrjete kriminale me struktura jo-konvencionale.⁷ Ky raport tregon se si individë nga Ballkani perëndimor kanë krijuar dhe zhfrytëzuar mundësi dhe hapësira për të përfituar nga tregjet e paligjshme. Nuk është se në perëndim janë transplantuar nga Ballkani grupe kriminale të mirëfillta, por shumë nga individët dhe grupet që përmenden në këtë raport e nisën aktivitetin e tyre jashtë vendit si kriminelë ordinerë, dhe me kalimin e kohës u shndërruan në elementë kryesorë në disa nga tregjet më të mëdha të narkotikëve në botë. Ekziston rreziku që këto grupe të transplantojnë disa nga aktivitetet dhe influencën e tyre në Ballkan, veçanërisht nëpërmjet pastrimit të parave, dhe vrasjeve të kundërshtarëve të tyre. Kjo mund të ketë pasoja serioze mbi ekonominë politike të vendeve të Ballkanit perëndimor.

Ky raport mundohet të paraqesë një tablo mbi aktivitetin kriminal 20 vjeçar të grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor, përhapjen e tyre globale, dhe ngjitjen e shkallëve të hierarkisë kriminale. Tentakulat e këtij oktapodi janë shtrirë nëpër të gjithë botën: që nga furnizimi me kokainë në Amerikën Latine, deri në rrugët e Evropës perëndimore; nga korridoret e trafikimit të heroinës në Turqi në Evropë; nga fushat e kanabisit në Shqipëri drejt Turqisë, dhe vendeve të Bashkimit Evropian. Ballkani perëndimor mbetet epiqendra e këtyre trafikëve: si rajon tranzit; si bazë rekrutimi për ushtarë të thjeshtë të grupeve kriminale; si rajon për t'iu fshehur autoriteteve, si dhe për të investuar e pastruar të ardhurat e krimit – por sidoqoftë aktiviteti i tyre kryesor zhvillohet jashtë këtij rajoni.

Gjatë 20 viteve të fundit, grupet kriminale nga Ballkani perëndimor janë përhapur nëpër të gjithë botën.



PERIUDHA KOMUNISTE

KRIMI I ORGANIZUAR NË
JUGOSLLAVI DHE SHQIPËRI



Në mënyrë që të analizojmë zonat problematike jashtë Ballkanit perëndimor në ditët tona, është e nevojshme që të rikujtojmë historinë dhe evoluimin e strukturave kriminale, tregjeve dhe elementëve kriminalë në këtë rajon.

Gjatë viteve 1970 dhe 1980, shtetasit e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) kishin një standard jete relativisht më të lartë se ata që jetonin në vende të tjera socialiste. Mund të udhëtonin fare lirshëm në vende të tjera, dhe për pasojë shumë prej tyre zgjodhën të emigronin jashtë shtetit. Në fakt, si ata që emigronin për punë jashtë vendit ashtu dhe punëdhënësit e tyre e kishin të qartë se kjo ishte diçka e përkohshme (nga kjo vjen edhe termi gjermanisht 'Gastarbeiter', apo punëtor mysafir). Disa prej tyre emigruan deri në Afrikën e Jugut, duke përfituar nga fushata e atij shteti për të tërhequr evropianë të bardhë me oferta të mira pune.⁸ Po kështu, shumë njerëz emigruan jashtë vendit me kontrata pune sezonale.

Shumë jugosllavë që emigruan jashtë vendit ishin punëtorë të zellshëm, respektues të ligjit, punëtorë pa arsim të lartë që kërkonin një të ardhme më të mirë. Por ashtu si ndodh rëndom gjatë valëve të mëdhaja të emigrimit, kjo lëvizje njerëzish krijoi hapësira të reja për krimin. Ashtu si e shpjegon ish-korrespondenti i BBC-së Misha Glenny në librin e botuar në vitin 2008 *McMafia*, komuniteti i madh i punëtorëve mysafirë "krijoi një mjedis të përshtatshëm, ku persona të dyshimtë nga Jugosllavia mund të fshiheshin dhe të humbnin gjurmët kur i kërkonte policia".⁹ Këta elementë filluan të merreshin me veprimtari kriminale të nivelit të ulët, duke u marrë me zhvatje dhe shantazhe, si dhe me vjedhjen e dyqaneve të mallrave të luksit, shtëpive dhe kasafortave.

◀ Pamje nga periudha komuniste në Beograd, kryeqyteti i ish-Jugosllavisë nga viti 1918 deri në shpërbërjen e vendit në vitin 2006. © Arkiva e gazetës Toronto Star /Toronto Star nga Getty Images.

Disa nga këto personazhe, që morën njëfarë emri gjatë asaj periudhe, ishin Milenko Mikanoviç Lazin, Rade Kotour, Goran 'Majmun' Vukoviç, Ljubomir Magaš, si dhe Zheljko Ražnatoviç, që njihet më shumë si Arkan. Gjatë periudhës 1972-1983, Arkani u dënua me burg apo kërkohet nga policia në Belgjikë, Hollandë, Suedi, Gjermani Perëndimore, Austri, Zvicër dhe Itali, kryesisht për grabitje me armë. Ai arriti të arratiset nga burgu në pesë shtete të ndryshme.¹⁰ Kjo valë e parë kriminelësh udhëtonte rregullisht nga Evropa perëndimore në Jugosllavi, dhe anasjelltas. Kur ktheheshin në vendin e tyre ata shpenzonin apo investonin paratë e mbledhura në perëndim, dhe më pas shkonin jashtë vendit për një 'xhiro' tjetër.

Kjo sjellje nuk kalonte pa rënë në sy të shërbimeve të sigurimit të shtetit. Në fakt, kriminelët nganjëherë nxiteshin nga vetë autoritetet që të emigronin. Ata madje ndihmoheshin gjatë pajisjes me dokumenta, duke iu dhënë pasaporta dhe dokumente të tjera udhëtimi. Duke i ndihmuar që të dilnin jashtë vendit, autoritetet e ruajtjes së rendit siguroheshin që kriminelët nuk do të shkaktonin trazira në vendin e tyre. Kjo lloj ndihme që i jepej kriminelëve i krijonte mundësi shërbimeve të sigurimit që t'i përdorte këto persona për misione të ndryshme, si vrasja e emigrantëve politikë.¹¹ Për shembull, Xhorxhe 'Giska Bozhoviç (Đorđe Božović), që njihet edhe si 'mbreti i kriminit në Beograd', përdorej herë pas here nga shërbimet sekrete për të eliminuar disidentë politikë dhe armiq të shtetit. Për shembull, ka zëra se ai planifikoi vrasjen e disidentit politik kroat dhe biznesmenit Stejpan Xhurekoviç (Stejpan Đureković) në Gjermaninë Perëndimore në vitin 1983.¹²

Shqipëri

Situata në Shqipëri ishte krejt ndryshe, pasi kufijtë ishin krejtësisht të mbyllur nga viti 1945 deri në 1990. Ndërsa Jugosllavia ishte një nga vendet komuniste më të hapura ndaj botës, Shqipëria ishte një nga më të mbyllurat. Në këtë ambient tërësisht të kontrolluar nga shteti, autoritetet duhet të kishin njohuri për çdo aktivitet të paligjshëm, dhe mbase mund të ishin edhe vetë të përfshira në këto veprimtari.

Si rezultat i vështirësisë në thithjen e investimeve të huaja dhe infrastrukturës së dobët, Shqipëria ishte një nga vendet më të varfra të bllokut komunist. Në përpjekje për të gjetur burime për thithjen e valutës së huaj, qeveria shqiptare nuk mundi t'i rezistojë një oferte të bërë në vitin 1966 për t'u përfshirë në kontrabandën e cigareve.¹³ Plani ishte që të trafikoheshin për në Itali cigare të markave amerikane, dhe që atje këto cigare shpërndaheshin më tej në vende të tjera të Evropës, dhe në Lindjen e Mesme.

Ndërmjetësit zvicëranë që bënë këtë ofertë kishin lidhje me mafian italiane, që po kërkonte korridore të reja trafikimi pasi operacionet policore në Detin Tirren ishin bërë më të efektshme. Sipas një ish-prokurori italian të antimafias, bosë mafiozë si Raffaello Cutolo (kreu i Nuova Camorra Organizzata – Kamorrës së Re të Organizuar) arritën të kuptonin se kontrolli i shtetit pas Perdes së Hekurt ishte strikt vetën për çështje politike, por nuk përbënte ndonjë pengesë serioze për trafikë të paligjshme, duke përfshirë edhe cigaret.

Qeveria shqiptare krijoi një zonë të lirë ekonomike që shërbente si pikë tranziti për kontrabandën e cigareve që vinin nga Shtetet e Bashkuara, dhe krijoi kompaninë Albtrans, që mendohet se administrohej nga Sigurimi i Shtetit, që siguronte

mbarëvajtjen e punës në Shqipëri në shkëmbim të një tarife prej nëntë dollarësh amerikanë për koli. Llogaritet se qeveria shqiptare ka grumbulluar rreth 35 milionë dollarë nëpërmjet kësaj veprimtarie gjatë periudhës 1968–1991.¹⁴ Si pasojë e kësaj veprimtarie Deti Adriatik, që deri në atë kohë konsiderohej thjesht si 'kufi blu', u transformua në

një korridor shumë fitimprurës për në lindje për grupet kriminale italiane. Nga ana tjetër qeveria shqiptare siguroi lidhje me rrjete ndërkombëtare, duke bërë tregti dhe duke thithur valutë të huaj. Kjo ishte edhe zanafilla e 'korridorit ballkanik' që do të zhfrutëzohej për aktivitete kriminale për dekada me radhë.

Lidhja me Turqinë

Në të njëjtën kohë që mafia italiane po i hidhte sytë drejt lindjes, trafikantët turq po shikonin drejt perëndimit. Që nga vitet 70, grupet kriminale turke kishin krijuar kompani transporti dhe firma për shkëmbime tregtare ndërkombëtare për të mundësuar trafikimin e heroinës drejt tregjeve të pasura të Evropës perëndimore. Ballkani konsiderohej si korridor me rrezikshmëri të ulët, dhe përdorej si për tranzit ashtu edhe për magazinimin e përkohshëm të ngarkesave me drogë. Grupet turke parapëlqenin të punonin me shqiptarë të Jugosllavisë – ngaqë konsideroheshin si njerëz punëtorë dhe të besueshëm – dhe shpesh përdoreshin si shoferë dhe korrierë.

Për grupet kriminale turke, Jugosllavia nuk konsiderohej si ndonjë treg i pasur, por (ashtu si dhe Bullgaria) konsiderohej si territor i sigurtë dhe i volitshëm për të zhvilluar takime dhe për të bashkëpunuar me grupe kriminale italiane dhe nga vende të tjera. Ndërkohë që blenin heroinë, grupet italiane herë pas here shisnin armë dhe municione. Armët ishin shumë të kërkuara në Turqi në vitet 70 si pasojë e rivalitetit dhe konfliktit të ashpër dhe të dhunshëm midis nacionalistëve të krahut të djathtë dhe komunistëve.¹⁵ Më pas, në vitin 1980 një grusht shteti i organizuar nga ushtria arriti të ndalë dhunën, dhe qeveria e re turke mbajti qëndrim të ashpër ndaj krimit të organizuar.¹⁶ Gjatë operacionit Padrinot (Babalar Operasyonu), shumë nga krerët e grupeve mafioze në Turqi u arrestuan dhe morën nga gjykata dënime të gjata me burg. Shumë krerë mafiozë u ekzekutuan në rrethana misterioze nga vrasës me pagesë, që mendohej se punonin për llogari të strukturave klandestine brenda vetë shtetit. Disa të tjerë u arratisën jashtë vendit, dhe burime mediatike mendonin se ata arritën të shpëtonin falë lidhjeve të fshehta me shtetin turk.¹⁷

Në vitet 80, edhe forcat e ruajtjes së rendit në Evropën perëndimore filluan të tregoheshin më vigjilente ndaj grupeve kriminale nga Turqia. Shumë shtetas turq – duke përfshirë politikanë, punonjës të shërbimeve sekrete, dhe oficerë policie të infiltruar në radhët e grupeve kriminale – u arrestuan për trafikimin e heroinës në Evropë. Nga ana tjetër, megjithëse operacioni Padrinot dhe ndërhyrjet më të efektshme nga forcat policore në Evropën perëndimore e shtuan nivelin e rrezikut për grupet kriminale turke, ato krijuan hapësira dhe mundësi të reja për grupe nga Ballkani. Meqë makinat me targa turke filluan të shiheshin me dyshim nga autoritetet ndërkombëtare, trafikantët filluan të përdornin gjithnjë e më shpesh makina me targa jugosllave dhe bullgare. Grupet e krimit të organizuar turk bashkëpunonin me falsifikues pasaportash në Bullgari për të nxjerrë pasaporta false për shqiptarët e Jugosllavisë që punonin si shoferë dhe korrierë në rrjetet e trafikimit të drogës.

Fundi i regjimit komunist solli ndryshime rrënjësore në këtë rajon. Në Shqipëri, demonstratat studentore në Tiranë, në dhjetor të vitit 1990, shënuan fundin e regjimit shtypës të Enver Hoxhës dhe izolimit të vendit, që zgjati më shumë se 45 vjet. Ndryshimi i sistemit solli vështirësi ekonomike, trazira politike dhe sociale, por solli edhe liri që ishin të paimagjinueshme për rininë shqiptare të asaj kohe. Shumë prej tyre përfituan nga rasti dhe ikën jashtë shtetit. Një nga pamjet më të famshme të asaj periudhe ishte anija Vlora që po hynte në portin e Barit me mijëra emigrantë shqiptarë, në gusht 1991. Por, ndërkohë që shumë shqiptarë dhe jugosllavë shpresonin për kohë më të mira, rrëmujat nuk do të vononin.



LUFTA DHE PASOJAT E SAJ



Zhvillimet dramatike të viteve 1989 dhe 1990 në Evropën lindore dhe Bashkimin Sovjetik patën ndikimin e tyre edhe në Jugosllavi. Partia Komuniste u shpërbë në fraksione nacionaliste, dhe në vitin 1991 Kroacia dhe Sllovenia shpallën pavarësinë. Këto zhvillime u pasuan nga një konflikt katërvjeçar me luftime sporadike, kryesisht në Kroaci dhe Bosnjë Hercegovinë, deri sa u nënshkrua marrëveshja e paqes në Dayton në dhjetor 1995. Rajoni u trondit dhe u destabilizua akoma më tej pas falimentimit të skemave piramidale në Shqipëri në vitin 1997, dhe lufta në Kosovë në periudhën 1998–99. Ky kapitull analizon ndikimin që patën këto ngjarje mbi vendndodhjen, kohën, dhe arsyen e daljes në skenë të zonave problematike të krimit të organizuar jashtë Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Kriminelët në vijën e frontit

Kur nisi lufta në vitin 1991, kriminelë nga RSFJ, që zhvillonin aktivitetet e tyre në Evropën perëndimore në vitet 80, u kthyen në vendet e tyre dhe u bënë pjesë e grupeve paraushtarake. Me miratimin e autoriteteve radhët e këtyre grupe paraushtarake u shtuan me kriminelë të thjeshtë, hajdutë, dhe tifoza huliganë për të luftuar në vijën e frontit.¹⁸ John Mueller i përshkruan në këtë mënyrë grupet paraushtarake:

Grupet më dinamike (dhe më gjakësore) serbe nuk ishin formuar nga ideologë dhe nacionalistë të zjarrtë, as nga banorë vendas që donin të hakmerreshin ndaj fqinjëve të tyre, as nga njerëz të thjeshtë që ishin ndezur nga demagogjia dhe media, por ishin formuar nga kriminelë të thjeshtë që ishin rekrutuar pikërisht për atë qëllim.¹⁹

Grupi më famëkeq ishte Garda Vullnetare Serbe, që njiheshin ndryshe edhe si Tigrat e Arkanit. Ata luftonin, përdhunonin, dhe plaçkisnin në zonat e Sllavonisë Lindore dhe në Bosnjë Hercegovinë.²⁰ Edhe nga krahu tjetër kishte personazhe të ngjashëm, si Mladen Naletiliç Tuta, një kroat i Bosnjës që drejtonte Batalionin e Burgaxhinjve; apo si Jusuf 'Juka' Prazhina, një gangster boshnjak që kishte formuar një njësi paraushtarake me anëtarë bandash për të ndihmuar në mbrojtjen e Sarajevës.²¹ Këto ishin grupe relativisht të vogla por shpesh ishin njësitë më aktive në fushatat e pastrimit etnik dhe mizorive të tjera që ndodhën gjatë luftës. Si kriminelë tipikë që ishin, i ofronin mbrojtje

◀ Banorë të Prizrenit, Kosovë, fshihen pas një autoblinde të forcave ndërkombëtare në Kosovë, për t'u mbrojtur nga zjarri i snajperëve serbë, Qershor 1999. © Christophe Simon/AFP nga Getty Images

atyre që i bindeshin apo që i paguanin. Aktivitetet kriminale mbuloheshin me flamurin kombëtar, dhe kjo legjitimonte veprimet e tyre, me justifikimin e mbrojtjes së atdheut, ndërkohë që i frynin zjarrit të urrejtjes etnike. Ashtu si vëren edhe Mueller, ajo që shpesh cilësohej si 'luftë etnike', në fakt, ishte diçka shumë më banale: "krijimi i komuniteteve të dhunës kriminale dhe plaçkitjes".²²

Shumë njerëz i trembeshin këtyre kriminelëve, por shumë të tjerë i adhuronin. Warren Zimmerman (Zimmerman) vëren se "fundërrinat e shoqërisë – mashtruesit, rrugaçët, madje edhe vrasësit profesionistë – e ngritën kokën nga llumi dhe u kthyen në luftëtarë për liri dhe heronj kombëtarë".²³ Në një intervistë me gazetën *The Wall Street Journal* në vitin 1993, një gazetar serb në Beograd tha se "heronjtë më të mëdhenj deri tani janë kriminelë. Besoj se rreth 3,000 kriminelë nga Beogradi po luftojnë në Bosnjë në front... Ata janë trima, të zgjuar, dhe janë besnikë ndaj popullit të tyre."²⁴

Sanksionet dhe 'fabrika e krimit'

Embargoja ndërkombëtare, që u vendos nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën 1992–1996, krijoi shumë probleme dhe vështirësi në Jugosllavi, dhe pati efekte anësore edhe mbi shtetet fqinje, por, nga ana tjetër, krijoi hapësira dhe mundësi për aktivitete kriminale. David Samuels vëren se: "një mur i padukshëm që ishte ndërtuar nga Perëndimi po pasuronte elitën kriminale të Serbisë, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë lëngonte në varfëri".²⁵

Gjatë kësaj periudhe tregu i zi fitoi një rol të dorës së parë në sigurimin e atyre pak mallrave të konsumit që qarkullonin në këto vende. Për shembull, kroatët dhe boshnjakët kishin nevojë për armë, pasi fillimi i luftës i kapi në disavantazh, ngaqë pjesa më e madhe e armëve dhe mjeteve të Ushtrisë Popullore Jugosllave u transferuan në Serbi dhe Mal të Zi, dhe më pas Kombet e Bashkuara vendosën një embargo armësh në vitin 1992. Bosnjakët e rrethuar në Sarajevë kishin nevojë për armë, municione, karburant dhe ushqime për të mbijetuar; ndërsa Serbët kishin nevojë për karburant. Tregu i makinave të vjedhura po lulëzonte. Në mënyrë që të anashkaloheshin sanksionet shpesh dilte nevoja që të bëheshin marrëveshje me armikun: kroatët blinin armë nga serbët, ndërsa serbët blinin karburant nga boshnjakët dhe kroatët.

Sidoqoftë, disa nga këta personazhe nganjëherë e tepronin me veprimet e tyre, dhe krijonin pakënaqësi edhe midis vetë njerëzve të tyre. Për shembull, në tetor 1993, autoritetet e pjesës myslimane të Bosnjës arrestuan dy gangsterë me emër brenda radhëve të tyre, pasi zhvatnin para nga po ata banorë që duhet të mbronin gjatë rrethimit të Sarajevës. Sipas një raportimi në media të asaj kohe, dy kriminelët (Ramiz Delaliç që njihej me nofken 'Celo' dhe Musan Topaloviç me nofken 'Caco') kishin ndërmarrë një fushatë vrasjesh, grabitjesh, dhe përdhunimesh. Me sa duket, banda e tyre kishte vënë nën kontroll tregun e zi, që ishte i vetmi burim për furnizimin e Sarajevës, duke fituar shumë të mëdha në një kohë kur shumica e banorëve të Sarajevës mundoheshin gjithë ditën duke rrëmuar për bukë dhe ujë.²⁵ Si përfundim, lufta pasuroi disa nga këta kriminelë, ndërsa të tjerë morën nam të madh. Po kështu, lufta i mësoi të rinjtë si të ushtronin dhunë ekstreme, si dhe krijoi tregje e hapësira shumë fitimprurëse për aktivitete kriminale.

Kur nisi të ndihej ndikimi i sanksioneve, udhëheqja në Beograd filloi të varej gjithnjë e më tepër nga pazaret dhe tregjet kriminale për të siguruar mallra të nevojshme. Në atë kohë një gazetar tha se: "Tregu i zi është e vetmja rrugë për të ruajtur paqen sociale në Beograd. Kështu që shteti po mundohet të bashkëjetojë me të".²⁷ Qeveria e Slobodan Millosheviçit përzieu së bashku forcat e ruajtjes së rendit, dhe shërbimet sekrete, me individë të përfshirë me krimin e organizuar, jo vetëm për të krijuar marrëdhënie me interes reciprok, por edhe për të patur nën kontroll tregun e zi dhe ekonominë gri. Kontrabanda ishte në interes të shtetit dhe në disa raste drejtohej nga vetë shteti.²⁸ Në një farë mënyre, tregtia e paligjshme në tregun e zi u kthye në një aktivitet legjitim. Për shembull, ka zëra se Sigurimi Shtetëror i Serbisë financohej pjesërisht nga fonde që vinin nga shitja e mallrave (duke përfshirë edhe drogat) që konfiskoheshin nëpër doganat.²⁹ Po kështu, qeveritë në Beograd dhe Podgoricë ishin përfshirë në kontrabandën e cigareve, që ishte një burim i pasur i valutës së huaj. Llogaritet se qeveria malazeze fitonte rreth 700 milionë dollarë në vit nga tregtia e cigareve, që kryesisht zhvillohej me Italinë.

Sanksionet po dëmtonin rëndë edhe ekonominë e disa vendeve fqinje. Ashtu si shpjegon edhe Glenni: "Fqinjëve të Jugosllavisë nuk iu ofua asnjë lloj ndihme apo kompensimi – prej tyre pritej që të mbanin vetë mbi shpatulla peshën dhe koston e nderinjtës morale të perëndimit. Për pasojë, e vetmja mënyrë për të gjetur para për të paguar pensionet, rrogat, dhe për të mbajtur spitalet hapur, ishte që të lejonin grupet kriminale që të përdornin lirshëm korridorët kryesorë tregtare të vendit, duke u hequr sikur nuk dinin gjë, sikur nuk kishin çfarë bënin, dhe madje përdornin edhe të dyja justifikimet së bashku. Me thellimin e krizës u forcua edhe marrëdhënia simbiotike midis politikës dhe krimit."³⁰

Sasi të mëdha naftë kalonin kontrabandë nëpër Liqenin e Shkodrës, nga Shqipëria në Malin e Zi, si dhe nëpërmjet kufirit tokësor të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Në fakt, shkelja e

sanksioneve, kufijtë e rinj të krijuar nga prishja e ish-Jugosllavisë, hapësirat dhe mundësitë e reja për të zhvilluar kontrabandë, sollën pasoja të papritura në zhvillimin e grupeve kriminale, dhe rritjen e ndikimit të tyre në ekonominë e disa vendeve fqinje.

Disa nga veçoritë dhe karakteristikat e ekosistemit të krimit që vazhdojnë të ekzistojnë në shumë zona të Ballkanit janë rezultate të luftës në Jugosllavi, dhe ndërhyrjes së komunitetit ndërkombëtar. Glenni shkruan se: "Gjithë kjo orgji lufte dhe konsumizmi do të kishtë faturën e vet... pasi shkelja e sanksioneve arriti të krijonte një rrjet ballkanik gjigand të krimit të organizuar... dhe, nga ana tjetër, mënyra më e lehtë për shtetin për të siguruar fonde ishte nëpërmjet bizneseve mafioze: drogës, armëve, naftës, trafikimit të femrave dhe emigrantëve. Themelet e fabrikës së krimit ishin hedhur tashmë."³¹


Shpërthimi i një vale krimi brenda vendit

Larg nga fronti i luftës, brenda vendit krimi i organizuar po lulëzonte. Armët gjendeshin me lehtësi; lufta dhe sanksionet kishin shkatërruar ekonominë, dhe kishin shkaktuar hiperinflacion. Gjatë dy viteve të para të luftës, të paktën 300,000 të rinj e braktisën Jugosllavinë; ndërsa për ata që mbetën mundësitë ishin të pakta. Ashtu si paraqitet edhe në filmin *The Wounds (Plagët)*, një film i prodhuar në vitin 1998 nga Serxhan Dragojević (Srđan Dragojević), shumë të rinj ndiheshin të rrënuar dhe të braktisur. Të vetmit njerëz me para dhe pushtet ishin gangsterët që ktheheshin nga perëndimi apo që përfitonin nga ekonomia e luftës. Në atë kohë një vëzhgues tha se, "me punë të nderhme nuk bën dot asgjë. Gjithnjë e më shumë të rinj e kanë ndarë mendjen: o vdekje, o lavdi".³²

Ndërkohë që shumë nga gangsterët që kishin bërë emër në perëndim gjatë viteve 80 u bashkuan me forcat paraushtarake, kriminelët e rinj po shijonin suksesin në qytetet kryesore. Ashtu si tregohet edhe në dokumentarin me titull *Shihemi në Njoftimet e Vdekjes (See You in the Obituary)*, kriminelëve, që shpesh ishin nën efektin e drogave, u pëlqente dhuna dhe fama po aq sa edhe paratë që fitonin nga krimi i organizuar.³³ Si rezultat i dhunës ndërmjet bandave rivale – veçanërisht në zonat e Beogradit të Ri, dhe Vozdovac – numri i vrasjeve në kryeqytetin

serb u dyfishua gjatë dy viteve të para të luftës. Një nga kriminelët e Beogradit tha asokohe: "Ky është një pellg i vogël dhe ka shumë krokodilë brenda".³⁴

Aty rreth vitit 1992, të rinjtë e përshirë në aktivitete kriminale filluan të visheshin sipas një stili të veçantë, me tuta sportive, atlete, me flokë të prera shkurt, syze dielli, dhe mbanin zinxhirë floriri shumë të trashë. Edhe pantallonat xhins të markës Diesel ishin shumë të përhapura midis këtyre të rinjve, aq sa kriminelët e këtij lloji morën edhe nofkën: *diezelašë* (dizelaši).³⁵



Aleksandër 'Knele' Knezhević

Automatet e bankave dhe grabitjet

Në fillim të viteve 90, kriminelët nga Ballkani perëndimor morën nam të keq për organizimin e grabitjeve jashtë këtij rajoni. Këtu përfshiheshin grabitje bankash në vende të Evropës perëndimore, dhe vjedhje gurësh të çmuar dhe bizhuterishë. Në Shtetet e Bashkuara, forcat e ruajtjes së rendit u kapën në befasi nga një numër i madh sulmesh të mirëorganizuar ndaj dyqaneve të argjendarive dhe bizhuterive, si dhe grabitjeve të bankomateve (ATM).

Filluan të vinin re se shumë nga autorët e këtyre krimeve ishin nga vendet e Ballkanit, dhe këtij grupi i vunë nofkën YACS (Yugoslavs, Albanians, Croats and Serbs – Jugosllavë, Shqiptarë, Kroatë, dhe Serbë).³⁸ Gjatë hetimit u vu re se grupi YACS ishte një rrjet personash pa ndonjë lidhje të fortë mes tyre, por anëtarët e grupit mblidheshin së bashku për të organizuar dhe kryer herë pas here grabitje të planifikuara me imtësi. Me pas anëtarët e grupit shpërndaheshin, por pas njëfarë kohe mblidheshin sërish për të planifikuar grabitjen e radhës.³⁹ Anëtarët e grupeve YACS çanin vrima të gjera në tavan⁴⁰ për të hyrë në dhomën e kasafortës apo bankomatit, si dhe shkëputnin linjat telefonike dhe sistemet e alarmit.⁴¹

Policia amerikane e kishte të vështirë që të kuptonte taktikat e këtyre grupeve, pasi nuk kishte njohuri mbi karakteristikat kulturore të Ballkanit perëndimor, dhe gjuhët ballkanike. Anëtarët e grupeve YACS shpesh përdornin identitete të rreme, gjë që e bënte të vështirë zbulimin dhe gjurmimin e tyre, madje edhe nëse arrestoheshin, ata mbanin me vete një numër telefoni, dhe pasi kontaktonin në atë numër u paguhej garancia e lirimit me kusht.⁴² Në Shtetet e Bashkuara, në vitin 1998, policia identifikoi rreth 300 të dyshuar si pjesëtarë

të kësaj bande. Ata ishin në përgjithësi emigrantë nga vende të Ballkanit⁴³, shumica e tyre ishin shqiptarë etnikë, dhe disa prej tyre kishin hyrë ilegalisht në Shtetet e Bashkuara. Por grupi rekrutonte edhe anëtarë me prejardhje të ndryshme etnike.⁴⁴

Ky grup filloi të paraqiste një kërcënim aq të madh nga mesi i viteve 90, sa që FBI u detyrua të ngrinte një task force për të hetuar në lidhje me këtë rrjet kriminal.⁴⁵ Ky grup duket se doli jashtë qarkullimit gjatë dekadës që erdhi më pas, por emri i tij u përmend përsëri në vitin 2017, kur u hodhën disa sugjerime se taktikat e përdorura gjatë vjedhjes së bizhuterive me vlerë 9 milionë dollarë nga Kim Kardashian, ngjasonin shumë me metodat e përdorura nga grupi YACS.⁴⁶ Sidoqoftë nuk pati asnjë konfirmim zyrtar në lidhje me këto zëra.

Gjatë viteve të fundit, një numër i madh vjedhjesh në vende të Evropës perëndimore dyshohet se janë kryer nga persona nga vende të Ballkanit perëndimor, dhe veçanërisht nga shqiptarë. Të ashtuquajturit *Skifterët* janë grupe të vogla, pa ndonjë bazë të përhershme, me të rinj që mblidhen së bashku për të vjedhur shtëpi dhe pastaj shpërndahen sërish. Ata udhëtojnë rregullisht nga Ballkani perëndimor në vendet e BE-së, dhe anasjelltas. Në kapitullin që flet për Spanjën raportohet se këto teknika mund të jenë përdorur për të vjedhur shtëpitë e lojtarëve të futbollit. Këto kohët e fundit një grup shqiptarësh u kap në Australi pas një sërë grabitjesh bankomatesh, gjatë të cilave u përdorën metoda të ngjashme me taktikat e grupeve YACS, dhe vjedhjeve në vendet e Evropës perëndimore.⁴⁷ Autoritetet shqiptare e kanë marrë qaq seriozisht këtë problem sa që kanë krijuar një njësi anti-Skifter.

Aleksandar 'Knele' Knezhević (Knežević) ishte një nga kriminelët më famëkeqë të Beogradit, që para se të mbushte 20 vjeç, ishte gangsteri tipik i asaj periudhe, dhe një nga përfaqësuesit kryesorë të stilit diezelas. "Në një vend të ngërthyer nga lufta dhe kolapsi i plotë shoqëror, ku e gjithë rroga duhej shpenzuar menjëherë pasi inflacioni e zhvlerësonte monedhën minutë pas minute, gangsterët si Knele shiheshin me adhurim pasi ata ishin të vetmit njerëz që po jetonin mirë."³⁶ Knele bënte një jetë të bujshme dhe vdiq në

moshë të re, pasi u vra në rrethana misterioze në Hotel Hyatt në Beograd në moshën 21 vjeçare. Ai ishte vetëm një nga shumë kriminelë të rinj që u vranë në atentate të stilit mafioz, dhe gati asnjë nga autorët e këtyre vrasjeve nuk është identifikuar apo arrestuar nga policia.³⁷ Shumica e kriminelëve që i shpëtuan gjallë kësaj periudhe të dhunshme ngjitën shkallët e hierarkisë kriminale pas përfundimit të luftës, ose ikën jashtë shtetit.

Shembja e piramidës shqiptare

Megjithëse Shqipëria nuk u përfshi direkt në luftërat në ish-Jugosllavi, disa shqiptarë arritën të nxirrin fitime të mëdha nga kontrabanda. Këto të ardhura, paralelisht me mungesën e rregullave të forta në sistemin bankar, dhe dëshirës për të fituar para me lehtësi, krijuan kushtet e duhura për lulëzimin e skemave piramidale në vitin 1996. Gati dy të tretat e popullatës investuan në këto skema piramidale, aq sa sasia e parave në këto firma ishin baraz me gjysmën e prodhimit të përgjithshëm bruto të Shqipërisë. Falimentimi i këtyre skemave piramidale në vitin 1997 nuk solli vetëm destabilizim ekonomik, por edhe trazira sociale dhe politike. Pati protesta të dhunshme nëpër të gjithë territorin, dhe shteti humbi kontrollin mbi disa qytete: disa prej tyre ishin pranë porteve detare dhe përgjatë kufirit me ish-Jugosllavinë dhe Greqinë.⁴⁸ Depot e armatimeve të reparteve ushtarake u plaçkitën, dhe gati 600,000 armë u shpërndanë nëpër të gjithë vendin, duke përfshirë edhe 226,000 kallashnikovë.⁴⁹

Në këtë situatë ku nuk respektohej më ligji dhe rendi publik (u vranë rreth 2,000 civilë), disa individë themeluan struktura dhe komitete shpëtimi, për të mbrojtur veten nga grupet kriminale.⁵⁰ Në disa zona të tjera, organizata kriminale me struktura të qarta hierarkike zunë vendin e lënë nga organet qeverisëse dhe i ofruan qytetarëve mbrojtje kundrejt pagesës. Disa grupe kriminale rekrutuan ish-pjesëtarë të forcave speciale të ushtrisë, policisë, apo shërbimeve sekrete, për të qenë në gjendje që të kryenin aktivitete kriminale të sofistikuar.⁵¹

Në këtë situatë të turbullt krimi i organizuar po lulëzonte. Numri i grupeve kriminale u rrit brenda një kohe shumë të shkurtër, dhe po kështu edhe radhët e tyre u shtuan me anëtarë të rinj.⁵² Trafikimi i drogës dhe vjedhjet e makinave ishin disa nga aktivitetet kryesorë të asaj kohe, madje edhe pastrimi i parave po lulëzonte.⁵³ Mungesa e ligjit dhe stabilitetit në vend u rëndua akoma më tej nga përkeqësimi i krizës në Kosovën fqinje. Mendohet se të paktën 6,000 kalashnikovë kaluan kontrabandë nga Shqipëria në Kosovë, përpara dhe gjatë luftës së Kosovës, ndërsa rreth 465,000 kosovarë u strehuan në Shqipëri.⁵⁴⁵⁵⁵⁶

Krim dhe konflikt në Kosovë

Lufta e Kosovës në vitet 1998 dhe 1999 shkaktoi një tragjedi humanitare, çrregullime, dhe bëri të mundur krijimin e një terreni pjellor për zhvillimin e kriminit të organizuar.⁵⁷ Ngaqë Kosova ishte një territor pa status të përcaktuar qartë, gjatë luftës kishte nevojë për ndihmë nga jashtë që të mbijetonte. Si rezultat, përveç mbështetjes financiare dhe politike nga jashtë (duke përfshirë edhe diasporën), filluan të lulëzonin edhe aktivitete të paligjshme, si trafikimi i armëve dhe drogës, kontrabanda e naftës, makinave të vjedhura, si dhe korrupsioni.⁵⁸ Këto aktivitete mundësoheshin nga rrjetet informale dhe ekonomia gri, që ishin krijuar si rezultat i kushteve të vështira social-ekonomike në Kosovë gjatë viteve 90.

Gjatë periudhës 1999–2008, Kosova u qeveris nga Misioni Ndërkombëtar Administrativ i OKB-së në Kosovë (UNMIK) – por transferimi i qeverisjes tek autoritetet vendore filloi aty nga viti 2005.⁵⁹ Që nga viti 2008, Kosova është ndihmuar nga misioni i Bashkimit Evropian për respektimin e ligjit (EULEX) për të ngritur institucionet ligjore, dhe për të mundësuar procesin e integritetit të Kosovës në BE.⁶⁰ Në këtë periudhë paslufte të ngritjes së shtetit, ku institucionet dhe infrastruktura ishin të dobëta, disa individë në pozita të forta, që kishin marrë pjesë në luftë dhe kishin lidhje të forta me diasporën, e shtuan ndjeshëm pasurinë dhe influencën e tyre, duke u marrë njëkohësisht si me aktivitete të ligjshme, ashtu edhe me veprimtari kriminale.⁶¹ Disa prej tyre iu futën

Themelet e fabrikës së kriminit u hodhën gjatë luftës në Jugosllavi.

politikës, madje kishin në dorë edhe administrimin e fondeve publike.⁶² Për disa ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u fol se ishin të përfshirë në aktivitete kriminale (si pika karburanti që përdorëshin për pastrimin e parave të pista).⁶³ Disa të tjerë, veçanërisht ata që ishin përfshirë në të ashtuquajturin 'biznes të mbrojtjes', krijuan kompani të policive private për të maskuar me legjitimitet aktivitetet e tyre.⁶⁴

Megjithë hapat e hedhura përpara në proceset shtetformuese, qeveria e Prishtinës, edhe sot e kësaj dite, ka shumë pak kontroll mbi veriun e Kosovës, ku shumica e popullsisë është serbe. Institucionet e veriut të Kosovës kanë pushtet të limituar, si pasojë e hapave të ngadalshme të reformës së vetë-administrimit, ndërkohë që kjo zonë është bërë objekt konflikti midis Beogradit dhe Prishtinës në lidhje me statusin dhe kufijtë e zonës veriore. Si rezultat ky territor ka mbetur një zonë gri, dhe është kthyer në terren pjellor për aktivitete të paligjshme.⁶⁵ Ashtu si thuhet pa dorashka edhe në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën: "Situata në veri të Kosovës vazhdon të paraqesë sfida të mëdha për forcat e ruajtjes së rendit në lidhje me krimin e organizuar".⁶⁶

Shtet mafioz

Ashtu si do të shpjegohet edhe më poshtë, gjatë luftërave në Jugosllavi, regjimi i Milosheviçit u përfshi në aktivitete kontrabande në mënyrë që të mbijetonte, dhe futi brenda radhëve të veta një numër të madh kriminelësh me emër. Ky lloj sistemi vazhdoi edhe pas luftës, duke përfshirë edhe trafikimin e armëve dhe drogës. Ashtu si shpjegon edhe Glenny: "Krimi i organizuar dhe policia sekrete bashkëpunonin ngushtë në Jugosllavi; madje ishte nganjëherë e pamundur që të dalloje njërin nga tjetri."⁶⁷ Në ndryshim nga vende të tjera të Evropës lindore nuk pati analiza të pastërtisë për figurat publike pas përfundimit të luftës, apo pas fundit të komunizmit, në mënyrë që të evitohet pjesëmarrja e elementëve kriminalë në qeverinë e re të Republikës Federative të Jugosllavisë. Ujqit e vjetër thjesht ndërruan qimen.



Nacionalisti serb dhe kriminel i luftës Zheljko Raznatović, që njihet më shumë si Arkani. Gjatë periudhës 1972–1983, Arkani kërkohet nga policia në Belgjikë, Hollandë, Suedi, Gjermani Perëndimore, Austri, Zvicër, dhe Itali. © Antoine Gyori/Syigma nga Getty Images

Nga ana tjetër, Millosheviçi ishte në një pozitë shumë të vështirë, si përsa i përket pushtetit politik, ashtu edhe kontrollit mbi aktivitetet dhe tregjet kriminale. U shtua shumë numri i vrasjeve, duke përfshirë edhe vrasjet e kriminelëve si Arkani, dhe politikanëve të opozitës, si Ivan Stamboliç. Zyrtarë të lartë të sigurimit shtetëror luajtën role kryesore në luftën për pushtet midis Millosheviçit dhe opozitës, gjatë periudhës 1999–2003. Përfshirja e tyre në këtë proces komplikohet akoma më tej nga lidhjet midis policisë sekrete dhe krimit të organizuar, si në rastin e Njësisë të Operacioneve Speciale (JSO). Kishte zëra se pjesëtarë të JSO-së ishin anëtarë të klanit famëkeq të Zemunit. Ky grup kriminal, që e mori emrin nga një lagje e Beogradit, doli aty nga viti 1993; dhe në vitin 2001, kur morën peng edhe biznesmenin e njohur serb Miroslav Mishkoviç, klani i Zemunit përmendej si një nga organizatat kriminale më të forta në Evropë, edhe ngaqë për vite me radhë patën gëzuar mbrojtjen e shtetit.⁶⁸ Por ndërkohë, situata politike po ndryshonte. Millosheviçi dha dorëheqjen në tetor të vitit 2000, pas përfundimit të zgjedhjeve presidenciale me rezultat të ngushtë. Ai u arrestua në prill 2001, dhe u ekstradua në Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë (ICTY) në Hagë.⁶⁹

Disa personazhe që kishin kaluar nga kampi i Millosheviçit në mbështetje të kryeministrit të ri Zoran Xhinxhiç (Đinđić), si kreu i JSO-së Milorad 'Legija' Lukoviç, filluan të bëheshin nervozë nga deklaratat e Xhinxhiç se do të godiste fort krimin e organizuar. Në këtë periudhë gjykata e Hagës kërkoi arrestimin e Lukoviçit. Pas kësaj, mendohet se një grup policësh – disa prej të cilëve kishin qenë anëtarë të grupeve paraushtarake gjatë luftës, dhe kishin lidhje me qarqet kriminale – ekzekutuan Xhinxhiç më 12 mars 2003.⁷⁰

Edhe gjysma tjetër e Republikës Federative të Jugosllavisë, Mali i Zi, po mundohej me vështirësi të kalonte pasojat e luftës, efektin shkatërrues të sanksioneve dhe hiperinflacionit. Një nga mënyrat e daljes nga situata ishte kontrabanda e cigareve. Gjatë periudhës 1994–2002, kontrabanda e cigareve u zhvillua në përmasa gjigande. Ky aktivitet i paligjshëm – që llogaritet se i ka sjellë shtetit malazet rreth 700 milionë dollarë në vit – u krye në bashkëpunim me grupe të mafias italiane. Një hetim i kryer nga autoritetet italiane zbuloi se kontrabanda kontrollohej nga shteti dhe se i gjithë ky aktivitet drejtohej nga kryeministri i atëhershëm i Malit të Zi, Milo Xhukanoviç (që tani është president i vendit). Ata nxorën një urdhër arresti kundër tij në vitin 2005, por që u hoq në vitin 2009. Kjo kontrabandë masive krijoi kushte të përsosura për korrupsion, dhe fuqizoi rrjetet e kriminelëve në vend, dhe forcoi lidhjet e tyre me jashtë. Po kështu, kontrabanda e transformoi Malin e Zi në një destinacion tërheqës për kriminelët italianë. Sipas një ish-prokurori anti-mafia në Bari, në vitet 90 shumë nga kriminelët kryesorë italianë e kalonin kohën në Malin e Zi: "Më shumë se 100 nga personat më të rrezikshëm që kërkohen nga policia italiane [jetojnë] në një vend me vetëm 600,000 banorë. Si ka mundësi?"

Mblidh mendjen ose mblidh plaçkat

Vrasja e Xhinxhiç ishte një goditje serioze për Republikën Federative të Jugosllavisë. Për t'iu përgjigjur kësaj situatë u deklarua gjendja e jashtëzakonshe, dhe në vitin 2003 u morën masa serioze kundër krimit të organizuar, në kuadër të operacionit Shpata (Sabjla). Më shumë se 10,000 persona u ndaluan nga policia, ndërsa hetimet zbuluan një rrjetë lidhjesh të ngushta midis politikës dhe grupeve kriminale, si dhe midis shërbimeve sekrete dhe krimit të organizuar. Disa anëtarë të bandës së Zemunit u dënuan për vrasje dhe akte terroriste. Si rezultat i këtyre ndërhyrjeve, ky grup kriminal pothuajse u eliminua krejtësisht, ose të paktën u shpërbë. Sipas raportimeve të asaj kohe, gjatë operacionit Shpata, numri i trafikantëve të drogës në qarkullim u zvogëlua aq shumë saqë çmimi i narkotikëve u rrit ndjeshëm.

Krimi i organizuar dhe policia sekrete bashkëpunonin ngushtë në Jugosllavi; madje ishte nganjëherë e pamundur që të dalloje njërin nga tjetri.



Kjo pamje nga një kamera sigurie tregon një anëtar të bandës së Panterave Rozë gjatë një grabitjeje bizhuterish. © Facebook

Panterat rozë: Hyr e vidh

Panterat Rozë ishte nofka që iu vu nga INTERPOL një rrjeti ndërkombëtar hajdutësh që vidhnin argjendari dhe ora. Ky rrjet kishte rreth 200 anëtarë dhe ndihmës (plus edhe shumë bashkëpunëtorë të tjerë), dhe gati të gjithë vinin nga Ballkani perëndimor. Ky grup ishte autor i disa prej vjedhjeve më të mëdha dhe më të guximshme të argjendarive dhe gurëve të çmuar të të gjitha kohërave, dhe zhvillonte aktivitetin e tij në disa shtete dhe në disa kontinente. Sipas burimeve të ndryshme, ky grup ishte përgjegjës për vjedhjen e më shumë se 350 milionë eurove në ar dhe diamante. Kishte dyshime se disa nga grabitjet e kryera nga ky grup mund të ishin porositur nga persona të tretë në shtete të pasura të Evropës.⁷²

Shumë nga anëtarët e grupit flisinin disa gjuhë të huaja, mbanin me vete disa pasaporta të rreme. Ata kishin përvojë e stërvitje ushatareke, dhe disa prej tyre kishin një të kaluar të dhunshme që nga koha e luftërave në Jugosllavi. Sipas një personi që kishte lidhje me këtë rrjet, një nga arsyet e angazhimit të disa personave në aktivitet kriminal ishin inati dhe hakmarrja. "Jugosllavia ishte një shtet pasaporta e të cilit vlenite më shumë se e çdo vendi tjetër në Evropë... Pastaj, papritur e papandehur u shemb e gjitha. U kthyem në qytetarë të klasit të tretë. Na

konsideronin si egërsira. E gjithë kjo na nderoi urrejtjen. Nganjëherë i hynim asaj pune vetëm për hakmarrje".⁷³

Duket se Panterat Rozë ishin më tepër një rrjet, sesa një grup i mirëfilltë i krimin të organizuar, pa krerë apo udhëheqje të përcaktuar qartë. Sipas një personi që e njihnte mirë këtë rrjet, "struktura organizative e Panterave i ngjasonte një oktapodi".⁷⁴ Brenda grupit kishte edhe persona më të rëndësishëm se pjesa tjetër, dhe që mund të konsiderohen si hajdutë 'mjeshtër', por nuk është se ata ushtronin ndonjë autoritet apo kontroll mbi anëtarët e tjerë të rrjetit kriminal. Vjedhjet zhvilloheshin zakonisht nga celula që ndodheshin që më parë në shtetin ku do të zhvillohej grabitja, apo në vendet fqinje. Sidoqoftë, grabitësit shpesh ktheheshin në vendin e tyre në Malin e Zi (shumica e tyre në Cetinje), ose në Serbi (veçanërisht në qytetin e Nishit), ku qëndronin 'në pritje' deri sa të vinte koha për vjedhjen tjetër. Duket se shumë prej tyre kishin kontakte dhe apartamente në Itali.⁷⁵ INTERPOL ndërmori një operacion të madh kundër këtij grupi në vitin 2007, dhe kjo e dëmtoi rëndë këtë rrjet hajdutësh, por ka të dhëna se disa nga anëtarët mund të jenë akoma duke zhvilluar aktivitetin e tyre.

Ashtu si vëren edhe Varese, "organizatat mafioze spostohen në territore të reja për t'i shpëtuar goditjeve nga shteti, konflikteve mafioze, ose mosmarrëveshjeve të brendshme, apo edhe ngaqë kanë marrë urdhër nga shteti që të largohen diku tjetër".⁷¹ Serbia pas vitit 2003 ishte një shembull i mirë në këtë drejtim: mesazhi nga qeveria ishte: mblidh mendjen ose mblidh plackat e ik jashtë. Ashtu si do të shohim edhe në disa nga rastet studimore më poshtë, shumë kriminelë zgjodhën alternativën e dytë, duke u larguar drejt Evropës perëndimore (veçanërisht në Spanjë) dhe në Afrikën e Jugut, shpesh me dokumente dhe identitete false.

Shqiptarët zgjerojnë territorin

Pas zgjedhjeve, në qershor 1997, situata në Shqipëri u stabilizua: u formua një qeveri e re dhe u zgjodh presidenti i ri.⁷⁶ Qeveria e re filloi të godasë krimin e organizuar: në vitin 2000 qeveria shqiptare raportoi se kishte ngritur akuza për 23 grupe kriminale që ishin përfshirë në trafikun e drogës.⁷⁷ Brenda vendit pati arrestime të shumta në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigrantëve, trafikimit të armëve, dhe vjedhjes së makinave.⁷⁸

Si pasojë e konflikteve midis bandave, punës më efektive të forcave të ruajtjes së rendit, dhe mundësive për fitime më të mëdha jashtë vendit, disa nga grupet kriminale shqiptare filluan t'i transferonin aktivitetet e tyre në Evropën perëndimore, dhe Turqi. Kështu, që nga viti 2000, një numër i madh shqiptarësh të përfshirë në aktivitete të paligjshme ishin larguar nga vendi, dhe kishin krijuar baza jashtë vendit, veçanërisht në Greqi, Itali, Zvicër dhe Gjermani. Vetëm gjatë muajve të pranverës të vitit 1997, rreth 10,600 shqiptarë, duke përfshirë edhe shumë kriminelë, emigruan ilegalisht në Pulia, Itali.⁷⁹ Që nga viti 2001, grupe kriminale shqipfolëse (duke përfshirë edhe grupe nga Kosova, dhe Maqedonia e Veriut) ishin përfshirë në trafikimin e heroinës në disa shtete evropiane, si në Republikën Çeke, Belgjikë, Greqi, Austri, dhe Zvicër.⁸⁰ Nga viti 2005, ata kishin filluar të trafikonin heroinë në vendet nordike, kryesisht në Suedi.⁸² Itinerari i zakonshëm ishte blerja e heroinës nga organizata kriminale turke dhe transportimi i drogës drejt Evropës perëndimore, veçanërisht nëpërmjet Hungarisë.⁸³

Rreth asaj periudhe (nga viti 2001), Shqipëria u bë edhe vend origjine për kanabisin e shitur në Evropë pas mbjelljeve masive të kanabisit në vend gjatë viteve 90.⁸⁴ Shqipëria u bë gjithashtu një nga burimet kryesore për barishte kanabisi për tregjet italiane dhe greke, dhe gradualisht u kthye në një nga burimet kryesore edhe për rezinën e kanabisit.⁸⁵ Grupet kriminale shqiptare u përfshinë edhe në trafikimin e qenieve njerëzore në Belgjikë, Francë, Itali dhe në Mbretërinë e Bashkuar, por ata ishin veçanërisht aktivë në Itali, ku punonin krah për krah me mafian italiane.⁸⁶ Disa nga këto bashkëpunime do të krijonin themelet për krijimin e rrjeteve të mëvonshme të trafikimit të drogës. Ka gjithashtu të dhëna se shqiptarë kanë marrë pjesë në grabitje me armë në Greqi si pjesëtarë të grupeve kriminale të përbëra nga grekë, shqiptarë, rumunë, dhe shtetas nga vende të ish-Jugosllavisë.⁸⁷ Brenda një kohe të shkurtër, disa grupe shqiptare ngjiten shkallët e krimit, dhe nuk punonin më si ushtarë të organizatave më të forta kriminale (turke dhe italiane), dhe u transformuan në faktorë të rëndësishëm në fushën e trafikut të drogës, emigracionit të paligjshëm, dhe trafikimit të qenieve njerëzore në disa vende të Evropës.⁸⁸

Që nga viti 2001, grupe kriminale shqipfolëse ishin përfshirë në trafikimin e heroinës në disa shtete evropiane.

Shpërngulja dhe diaspora

Emigracioni ishte një nga pasojat e luftës në Jugosllavi, që do të luante më pas një rol të dorës së parë në krijimin e zonave problematike për aktivitete kriminale nëpër botë. Ashtu si u përmend më sipër, vala e parë e emigrimit nga Jugosllavia u zhvillua gjatë viteve 70 dhe 80. Lufta shkaktoi një valë të dytë akoma më të madhe. Në vitet 90, qindra mijëra njerëz nga ky rajon u larguan jashtë, dhe një pjesë e tyre kërkoi strehim në vende të huaja. Dhjetëra mijëra njerëz shkuan në shtete si Austria, Danimarka, Holanda dhe Suedia, dhe qindra mijëra të tjerë shkuan në Gjermani. Po kështu, edhe destabilizimi i vendit në Shqipëri dhe Kosovë shkaktoi eksod në Itali, Evropën perëndimore, dhe Turqi. Llogaritet se disa qindra mijëra kosovarë jetojnë jashtë vendit.⁸⁹ Pas luftës, ritmi i ngadalshëm i reformave në disa vende të Ballkanit perëndimor shkaktoi një 'largim të trurit'. Pati edhe një valë emigrimi nga Kosova dhe Shqipëria në vitin 2015, kur shtetas të këtyre vendeve iu bashkuan turmave të refugjatëve dhe emigrantëve, që vinin shumica nga Siria, drejt Evropës perëndimore.

Një përqindje e vogël e kësaj mase të madhe njerëzish në lëvizje ishin kriminelë. Ashtu si vëren edhe Varese, "duke patur parasysh se një përqindje e popullatës mund të jenë kriminelë, i bie që sa më e madhe të jetë masa e emigrantëve nga ajo popullsia, po aq më i madh do të jetë edhe numri i kriminelëve që hyjnë në territorin e ri".⁹⁰

Prirje dhe tendenca të ngjashme janë ndeshur edhe në vende të tjera në të kaluarën, si për shembull emigrimi i italianëve drejt SHBA pas luftës së dytë botërore. Diasporat në vende si Gjermania, Austria dhe Holanda u bënë baza të rëndësishme për grupet kriminale nga Ballkani, që përfituan nga situata në territoret e reja për t'u përfshirë në aktivitete kriminale. Në të njëjtën kohë, procesi i globalizimit ofronte hapësira dhe mundësi të reja, duke e bërë më të lehtë lëvizjen e njerëzve, parave, dhe mallrave – një element që do të përdorej shumë shpejt nga kriminelët që kryenin aktivitetin e tyre në Amerikën Latine, dhe në Afrikën e Jugut.

Situata të paqëndrueshme në Shqipëri dhe Kosovë shkaktuan emigrim masiv drejt Evropës perëndimore. Në këtë foto paraqiten refugjatë shqiptarë në portin e Barit, Itali. © Patrick Durand/Sygma nga Getty Images





EVROPA PERËNDIMORE




Evropa perëndimore është zona me e nxehtë për grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor. Aty janë më aktivë se kudo tjetër, pasi ky është edhe tregu kryesor për shitjen e drogës. Ky kapitull do të bëjë një portretizim të aktiviteteve të tyre në Itali, Spanjë, Hollandë dhe në Republikën Çeke. Do të analizojë arsyet dhe mënyrat që i bënë këto grupe kriminale kaq aktive në këto tregje, dhe si kanë arritur të ngjiten lart në shkallën e krimit, nga kriminelë rrugësh deri tek shpërndarës kryesorë të drogës.

Grupe nga ky rajon janë kthyer tashmë në disa nga trafikantët kryesorë të heroinës, kanabisit, dhe kokainës. Ato përqendrohen veçanërisht në vende me diaspora të mëdha, duke qenë se krimi i organizuar zakonisht shfrytëzon së pari komunitetin e vet. Për shembull, e ashtuquajtura 'Mafia e Frankfurtit' mori nam për trafikimin e heroinës nga Maqedonia e Veriut për në Frankfurt, dhe Vienë (dy qytete me diasporë të madhe).⁹¹ Ky grup përbëhej kryesisht nga shtetas maqedonas nga qyteti i Veleshit. Sipas burimeve policore, Mafia e Frankfurtit arriti të hynte shumë shpejt në treg duke shitur heroinë të cilësisë së lartë me çmime të arsyeshme. Llogaritet se vetëm në Vienë fitimt e tyre arrinin shifrën 80,000 euro në ditë (105,000 dollarë).⁹² Gjatë periudhës 2010–2013, forcat policore në Gjermani, Austri, dhe Maqedoninë e Veriut arrestuan rreth 450 persona që mendohej se ishin pjesë e këtij rrjeti. Në vitin 2013, policia maqedonase arrestoi edhe 60 shtetas maqedonas për lidhje me Mafian e Frankfurtit.⁹³ Megjithë këto goditje, grupi vazhdon të jetë aktiv dhe thjesht ka ndryshuar taktikat.⁹⁴

Në një rast tjetër, në Suedi kriminelë nga vende të Ballkanit perëndimor kanë ngjitur shkallët e krimit. Në vitet 70 dhe 80, disa kriminelë – si Arkani – u përfshinë në grabitje bankash dhe zhvatje. "Jugo Mafia" (*Juggemaffian*, ashtu si njihej në vendet skandinave) më pas filloi të merrej me trafikimin e cigareve, drogës, dhe armëve. Armë nga vendet e ish-Jugosllavisë, duke përfshirë edhe granata dore, thuhet se dhanë kontributin e tyre në rritjen e nivelit të dhunës në disa lagje të qyteteve suedeze.⁹⁵ Disa 'ish-jugosllavë', ashtu si quheshin ndonjëherë nga publiku, duket se kishin lidhje me banda motoçiklistësh në Suedi, Danimarkë, dhe Norvegji. Një nga grupet kriminale kryesore në Suedi drejtohej nga Naser Xhelili, një shqiptar nga Maqedonia. Grupi ushtronte aktivitetin në Goteborg, dhe merrej me trafikun e drogës, zhvatjes, dhe grabitjeve me armë.⁹⁶

- ◀ Evropa perëndimore është tregu i jashtëm kryesor për grupet kriminale nga vendet e Ballkanit perëndimor. Kjo foto paraqet policë gjermanë gjatë një operacioni për goditjen e një rrjeti të trafikut të drogës në Frankfurt, ku banojnë një numër i madh emigrantësh maqedonas. © Boris Roessler/ Picture Alliance nga Getty Images



FIGURË 1 Korridoret e trafikimit në Evropën perëndimore që studiohen në këtë raport

Disa nga krerët e mafias serbe në Suedi janë vrarë si pasojë e rivaliteteve dhe hasmërive. Një mik i ngushtë i Arkanit, Dragan Jasković, që konsiderohej si mbreti i gangsterëve të Stokholmit, u vra në një pistë për gara kuajsh në vitin 1998 – mesa duket me urdhër të një personi që e kishte patur ortak në krim, Dragan Kovaç. Ky i fundit u ekzekutua para hyrjes së një restoranti në Stokholm, vetëm pak muaj më vonë. Vendin e Jasković e zuri Ratko ‘Cobra’ Xhokiç (Đokić), që u vra në maj 2003. Ky u zëvendësua nga Milo Sevo, që mori nofkën ‘padrinoja i Stokholmit’.⁹⁷ Raportohet se në ditët e sotme Sevo paraqitet në Serbi si ‘biznesmen’.

Po kështu duket se lidhje me Ballkanin perëndimor ka edhe një grabitje e bujshme e një ndërtese për magazinën e parave në Stokholm, në shtator 2009, që njihet edhe si grabitja me helikopter në Vestberga.⁹⁸ Këto krime të bujshme dhe një numër personazhesh piktoreske nga bota e krimit kanë frymëzuar një sërë dokumentarësh dhe filmash mbi krimin. Këto kohët e fundit, u zhvillua një operacion i madh policor kundër një grupi kriminal shqiptar, që trafikonte 1,650 kilogramë kokainë dhe heroinë në Suedi dhe Danimarkë.⁹⁹

Një tjetër rast i pazakontë në lidhje me kriminelët nga Ballkani perëndimor është edhe rasti i vëllezërve Culum, Armin dhe Nermis, që emigruan në Gjermani nga Bosnjë Hercegovina. Në vitin 2004 ata themeluan Klubin e Motoçiklistëve Tribunët e Bashkuar (United Tribuns Motorcycle Club), që njihet për përfshirje në trafikimin e qenieve njerëzore, prostitucion, dhe vrasje. Në vitin 2014, Gjermania i cilësoi Tribunët e Bashkuar si kërcënim serioz për sigurinë kombëtare. U lëshuan shumë urdhra arresti, ndërsa vëllezërit u kthyen në Bosnjë, prej nga vazhdojnë të drejtojnë aktivitetet e tyre.

Në Mbretërinë e Bashkuar, mijëra persona nga Shqipëria dhe Kosova (duke përfshirë edhe shumë shqiptarë që u hoqën sikur ishin nga Kosova) hynë në këtë vend gjatë periudhës 1999–2000. Ashtu si edhe në rastin e komuniteteve të tjera të emigrantëve, një përqindje e vogël e tyre u përfshi në aktivitete të paligjshme, kryesisht në trafikimin e qenieve njerëzore dhe trafikimin e heroinës, si dhe në kultivimin dhe trafikimin e kanabisit.¹⁰⁰ Në fillimet e viteve 2000,

Itali: Partnerë në krim

Ashtu si u përmend më lart, në kapitujt e mëparshëm të këtij raporti, ka patur lidhje të ngushta midis grupeve të krimit në Itali dhe Ballkanin perëndimor që nga vitet 80. Një nga aktivitetet më të hershme ishte kontrabanda e cigareve me Malin e Zi, Serbinë, dhe Shqipërinë. Italia ishte vendi i parë ku kriminelë nga Ballkani perëndimor hodhën hapat e para për të ngjitur shkallët e krimit. Kriminelë nga Jugosllavia arritën në këtë vend në vitet 80 dhe 90 me valët e refugjatëve nga lufta e Jugosllavisë, dhe u përfshinë në vjedhjen e gjërave të luksit si rroba dhe orë. Për shembull, besohet se Milenko Mikanović Lazin e nisi aktivitetin e tij kriminal në vitet 80. Ai u largua nga Jugosllavia për të punuar në Itali, ku filloi të vidhte shtëpitë e italianëve të pasur. Më pas filloi të bashkëpunonte me kriminelë të tjerë nga rajoni, dhe nisën të planifikonin grabitje argjendarish. Ka raportime se policia në Bosnjë ishte në dijeni të aktiviteteve të tij, por nuk vepruan asnjëherë për ta ndaluar.

Gjatë një vale të dytë, Italia u bë një nyje kryesore për kontrabandën e cigareve, kryesisht në bashkëpunim me grupet kriminale serbe dhe malazeze. Raportohet se, që nga vitet 2000, serbët kanë bashkëpunuar ngushtë me mafian italiane, për llogari të të cilës transportonin dhe shpërndanin drogë nëpër të gjithë vendin dhe Evropën perëndimore.

Në lidhje me trafikimin e heroinës në Itali, duket se grupet nga Ballkani perëndimor i kanë konsoliduar lidhjet e tyre me grupet turke. Në fakt, këto të fundit duket se e kanë ulur përfshirjen e tyre direkte në trafikimin drejt Italisë, duke i lënë më shumë hapësirë shqiptarëve. Thuhet se shqiptarët janë aktivë edhe në tregun e kanabisit, sidomos me importin e kanabisit nga vendi i tyre. Por sidoqoftë, droga më fitimprurëse është kokaina. Në vitet 90, shqiptarët ishin aktivë në trafikimin

shqiptarët filluan pak a nga pak të shtinin në dorë tregun e madh të kokainës në Londër.¹⁰¹ Nga viti 2015, ata ishin kthyer në disa nga trafikantët kryesorë në kryeqytetin britanik dhe zona të tjera anembanë vendit. Ata janë aktivë jo vetëm në shpërndarjen e drogës, por bandat shqiptare kanë marrë goxha nam dhe luajnë rol kryesor në shitjen e drogave, në grabitjet me armë, dhe zhvatjet. Një në dhjetë të burgosur në Britani është shqiptar.¹⁰²

e qenieve njerëzore në Itali, para se të kalonin tek trafiku i drogës. Fillimisht shqiptarët ishin në shërbim të italianëve në këtë bashkëpunim, por gjatë dy dekadave të fundit – falë edhe lidhjeve me furnizuesit e kokainës në Amerikën Latine dhe rrjetet e tyre në vende të Evropës perëndimore ku ka shumë emigrantë shqiptarë – ata kanë arritur të ngjitin shkallët e hierarkisë kriminale, deri në atë pikë sa në disa raste janë bërë partnerë të barabartë me grupe mafioze italiane.

Bregu lindor i Italisë është një portë kryesore për hyrjen e drogave, ashtu siç shihet edhe nga numri relativisht i lartë i konfiskimit të drogave të fshehura në makina, në portet e Barit dhe Ankonës nga tragetet që nisen nga Durrësi. Shqiptarët në Itali që kryejnë importimin e drogës përgjatë bregdetit puljez gëzojnë një avantazh të dyfishtë: kanë lidhje me bashkëkombësit e tyre në burimin e furnizimit, si dhe me grupe në Shqipëri që mund të sigurojnë shpërndarjen. Kjo i jep dorë kur vjen puna tek organizimi i dërgesave të mëdha me drogë, duke përcaktuar çmimin dhe duke luajtur rolin e ndërmjetësit. Këto grupe janë kthyer në administratorë të transportit dhe shpërndarjes, dhe janë bërë faktorë kryesorë në marrjen e vendimeve. Ata nganjëherë konsiderohen edhe si krahu i armatosur i aleancave kriminale. Kjo ka bërë që të fitojnë respektin e grupeve italiane me eksperiencë shumë më të madhe. Po kështu ata po fitojnë respekt edhe në vendin e tyre, dhe kjo ka filluar të shqetësojë policinë. Sipas një hetuesi italian, bashkimi i grupeve italiane dhe shqiptare është një përzjerje e rrezikshme: “Kombinimi i i elementëve nga grupet mafioze tradicionale, veçanërisht grupeve nga Kalabria, me egërsinë e bosëve shqiptarë të krimit, arrin një dimension akoma më shkatërrimtar.”¹⁰³



Lidhjet e ngushta midis grupeve të krimit në Itali dhe në Ballkanin perëndimor datojnë që katër dekada më parë. Këtu, karabinierët kanë konfiskuar 800 kilogramë hashish. © Salvatore Laporta/KONTROLAB /LightRocket nga Getty Images

Disa nga këto lidhje janë krijuar nëpër burgje. (Deri në muajin shkurt 2020 kishte më shumë se 2,300 shqiptarë në burgjet italiane). Burgu është shpesh pikënisja e një jete krimi dhe jo fundi. Për shembull, në burgjet puljeze kriminelët shqiptarë po bien në kontakt me mafian italiane. Duket se ky është edhe rasti i Arben Zogut që filloi furnizimin e Romës me kokainë që tani kontrollohet nga shqiptarët.¹⁰⁴ Ai vuante dënimin në të njëjtin burg me Rocco Bellocco, bosin e një prej familjeve më të fuqishme të Ndrangetas, një situatë që krijon premisa për një shoqëri fitimprurëse. Në fakt, pretendohet se grupet italiane dhe shqiptare jo vetëm që po formojnë aleanca, por janë duke krijuar dhe grupe të përziera. Kjo duket se është tendenca e re, ku disa grupe kriminale italiane janë të gatshme që të delegojnë disa aktivitete dhe të reduktojnë numrin e personelit të tyre, duke lënë grupe të tjera që të kontrollojnë punën në terren me lejen e tyre.¹⁰⁵ Sipas një kryeprokurori:

Shqiptarët punojnë me të gjitha grupet. Kanë krijuar lidhje të shumta, e dinë ku ta gjejnë drogën dhe si ta transportojnë, janë partnerë me vlerë dhe nuk i prek kurrkush, pasi mbrohen nga grupet mafioze më të fuqishme, që nga Mafia, Camorra dhe Ndrangeta. Ata

nuk merren me shpërndarje me sasira të vogla nëpër rrugë; luajnë rolin e ndërmjetësit dhe punojnë mirë, janë të besueshëm.

Lidhjet midis grupeve italiane dhe shqiptare janë evidentuar nga një numër operacionesh policie në periudhën midis 2019 dhe 2020. Gjatë operacionit Rëra 2 (Sabbia 2) në muajin dhjetor 2019, nëntë të dyshuar – shtatë prej tyre ishin shqiptarë – u arrestuan nga karabinierët si pjesë e goditjes së trafikimit të kanabisit dhe kokainës në FIRENCE. Në janar 2019, një shqiptar dhe një malazez u arrestuan së bashku me anëtarët e klanit të Kazamonikës në Romë, si pjesë e operacionit Brazil Low Cost që shkatërroi një grup që furnizonte me kokainë Romën dhe Napolin. (Shqiptari Dorion Petoku, thuhet se është një nga krerët e grupit të Arben Zogut.) Ky grup po planifikonte që të transportonte shtatë tonë kokainë të pastër nga Brazili në Evropë, me avionë privatë. (Plani i tyre fillestar ishte që të transportonte drogën në Romë, por më pas destinacioni u ndërrua, për në Sitten në Zvicër.) Malazezi Tomislav Pavlovic kishte krijuar kontakte me grupe kolumbiane gjatë disa udhëtimeve në Brazil për planifikimin e trafikut të drogës.¹⁰⁶

*Lidhjet midis
grupeve kriminale
shqiptare dhe
italiane janë
evidentuar kohët
e fundit nga një
sërë operacionesh
policore.*

Më 1 gusht 2019, pesë shqiptarë, një rumun, dhe një italian u arrestuan në kuadër të operacionit Shqiponja e Zezë. Sipas informacionit që erdhi pas arrestimeve, kokaina nga Kolumbia arrinte në Rotterdam, dhe aty ndahej në pako më të vogla me nga 15 deri në 50 kilogramë, dhe më pas transportohej për në Itali nga shqiptarë me vetura të modifikuara, me dysheme me fund të dyfishtë (makinat modifikoheshin në një oficinë në Madrid, që mendohet se ishte në pronësi të kolumbianëve, kundrejt pagesave prej 10,000 deri në 20,000 euro, si dhe pagesë në kokainë), si dhe në furgonë dhe autostrada. Droga i shitej më pas grupeve italiane në varësi të kushteve të rëna dakord paraprakisht. Një metodë e ngjashme u identifikua nga policia italiane në mars 2018 kur 15 persona, duke përfshirë edhe disa shqiptarë, u arrestuan në Bolonja si pjesë e një rrjeti të sofistikuar trafikimi nga Belgjika dhe Shqipëria.¹⁰⁷ Ka edhe shumë raste të tjera të ngjashme.¹⁰⁸

Në nëntor 2019, policia italiane zhvilloi një operacion të madh kundër krimit të organizuar në Romë. Objektivi kryesor ishte mafia italiane, por një oficer policie që ishte marrë me atë rast tha se "bosët e rinj të drogës në Romë janë shqiptarë. Grupet kriminale të Romës e blejnë prej tyre pluhurin e bardhë për 28,000 euro për kilogram. Nuk gjen kurrë më lirë se aq." Në shkurt 2020, në kuadër të operacionit Herostrati (Erostrato), një grup me 11 shqiptarë dhe italianë, që njihet edhe si mafia e Viterbos, u dënuan me një total prej 135 vitesh në burg për zhvatje dhe shantazh në qytetin e Viterbos. Krerët e grupit, një italian nga Kalabria dhe një shqiptar nuk janë kapur akoma.

Për të ilustruar raportin midis palëve në marrëdhëniet midis grupeve shqiptarë dhe atyre italiane mund të merret si shembull një rast ku disa shqiptarë që po negocionin për një pazar droge në Siçili, thuhet se mbajtën peng dy mafiozë siçilianë, si garanci për pagesën e ngarkesës së drogës. Sipas një burimi nga policia financiare italiane, mbajtja e pengjeve është diçka normale në marrëdhëniet midis grupeve kriminale, "por kur shqiptarë mbajnë peng siçilianë, atëherë kjo tregon se gjërat kanë ndryshuar dhe janë bërë goxha të fuqishëm".¹⁰⁹

Një valë vrasjesh në periudhën 2019–2020 tregon se tregu i pasur i kokainës në Romë po përjeton një kohë të turbullt ndryshimesh. Më 7 gusht 2019, një nga krerët e krimit në Romë, Fabrizio Piscitelli (që njihet ndryshe edhe si Diabolik) u qëllua me plumb në kokë ndërsa qëndronte ulur në një stol në park. Në janar 2020, trafikanti shqiptar i drogës Gentian Kasa u vra përballë shtëpisë së tij në Romë. Ka zëra se këto vrasje tregojnë se po zhvillohet një luftë për pushtet midis grupeve me shqiptarë dhe fraksione të ndryshme të mafias italiane.¹¹⁰ Nga kjo del qartë se është gabim të mendohet se marrëdhëniet midis grupeve shqiptare dhe italiane janë gjithmonë në harmoni të plotë dhe unitet të pathyer: duket qartë se ka konflikte dhe polemika të brendshme që bëhen shkas për konkurrencë dhe dhunë.

Një shqiptar që ka jetuar në Itali për shumë vite me radhë tregon se si bashkëkombësit e tij ngjithën shkallët e hierarkisë së krimit: "Kur erdha këtu ishim të rinj. Të gjithë mbajmë mend anijen e madhe plot me njerëz të dëshpëruar në portin e Barit, sot ti troket në derën tonë për të gjetur punë.

"Ne jemi bërë gjithnjë e më të fuqishëm, jo vetëm ngaqë jemi të fortë, por edhe ngaqë i kemi shërbyer të tjerëve për një kohë të gjatë. Në ditët e sotme ka shumë drogë në Itali sepse ne dimë si ta transportojmë, jo vetëm nga Shqipëria, por nga të gjitha vendet e Evropës. Ne marrin përsipër shumë rreziqe, dhe në ditët e sotme italianët nuk duan më të rrezikojnë.

"Ne jemi në krye, por e dimë shumë mirë se kush e komandon vendin, ne respektojmë italianët dhe ata na respektojnë ne, pasi e dimë mirë si funksionojnë gjërat në këtë biznes."

Spanjë: Nga hajdutë në bosë

Grupet nga Ballkani arritën në Spanjë pas luftës në Jugosllavi. Ata i tërhoqi Spanja për të njëjtat arsye që pëlqehet edhe nga kriminelë të vendeve të tjera (për shembull nga Britania dhe Rusia) që zhvillojnë aktivitetin nga vende si Costa del Sol, Costa Valencia dhe Costa Brava – kohë me diell, pozicion i mirë gjeografik, infrastrukturë e mirë, dhe mundësi të shumta për pastrimin e parave të pista. Aktivitetet e para kriminale (në fillim të viteve 2000) ishin kryesisht vjedhje dhe grabitje. Disa banda (veçanërisht me shqiptarë dhe kosovarë) duket se ishin specializuar në grabitje të ndërtesave të biznesit. Këto lloj hajdutësh njiheshin me nofkën 'butroneros' (grabitësit) pasi kishin aftësi të hapnin kasaforta dhe të neutralizonin sisteme alarmi dhe sigurie. Grupe të tjera ishin të specializuara në vjedhjen e shtëpive luksoze, veçanërisht shtëpitë e futbollistëve me emër. Disa grupe ishin përfshirë edhe në trafikimin e armëve. Ashtu si edhe në zona të tjera problematike nëpër botë, duket se kriminelët shpesh përdornin dokumente false e identitete të rreme, dhe shkonin e vinin nga vendet e tyre. Në fakt, policia spanjolle i konsideronte si grupe lëvizëse.

Më vonë, disa nga këto grupe ngjitën shkallët e krimit dhe filluan të përfshihen në trafikimin e drogës (kanabis, heroinë dhe kokainë). Ashtu si vëren edhe një oficer i lartë i njësisë spanjolle antidrogë dhe kundër krimit të organizuar, "ata janë shndërruar nga hajdutë në bosë".¹¹¹ Spanja është një nga portat kryesore për hyrjen e kokainës nga Amerika Latine, nëpërmjet konteinerëve në disa porte (si Algeciras dhe Valencia) – duke përdorur shpesh anije të Kompanisë Mesdhetare të Transportit (Mediterranean Shipping Company). Ka patur edhe disa raportime në lidhje me ekuipazhe anijesh që hidhnin në det ngarkesa të paketuara në mënyrë të posaçme dhe të pajisuar me aparat GPS, pasi hynin në ujërat territoriale spanjolle. Droga më pas mblidhej nga motoskafe dhe gomone. Kjo metodë duket të jetë përdorur nga grupi që drejtohej nga Vinetu Cokovic (një shtetas malazez), që u arrestua nga policia spanjolle në vitin 2015, gjatë një operacioni që kapi 3.5 tonë kokainë dhe 9.3 milionë euro në para të thata.¹¹²

Valencia duket se është një bazë e rëndësishme për grupet nga Serbia dhe Mali i Zi. Luka Bojović, kreu i grupit famëkeq të Zemunit (dhe ish-anëtar i Tigrave të Arkanit), u arrestua atje në shkurt 2012 (pas lëshimit të një urdhër arresti nga INTERPOL në lidhje me disa vrasje) së bashku me dy anëtarë të tjerë të klanit të Zemunit, Vladimir Milisavljeviç dhe Sinisha Petriç. Valencia luajti rol të rëndësishëm edhe në zhvillimin e kartelit të Kotorit. Në vitin 2014, në Valencia u zhdukën nga apartamenti i Goran Radoman (një shtetas malazez) rreth 200 kilogramë kokainë. Mosmarrëveshjet në lidhje me faktin se çfarë kishte ndodhur me atë ngarkesë droge nisi një konflikt brenda klanit të Kotorit, duke e ndarë në dy grupe rivale **Shkaljarski dhe Kavacki**. Radoman u vra në shkurt 2015. Kjo vrasje nisi një cikël sulmesh për hakmarrje që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Ja vlen të përmendet edhe një element tjetër interesant për lidhjet midis Spanjës dhe grupeve kriminale nga Ballkani. Në muajin janar 2015, një helikopter me rreth 900 kilogramë hashish në bord – që mendohet të jetë nisur nga Maroku – u përplas pranë Malagas. Piloti ishte major në forcat e armatosura të Shqipërisë.¹¹³ Ky nuk ishte i vetmi incident i këtij lloji: duket se ka një trafik të vazhdueshëm helikopterësh dhe avionësh të lehtë që transportojnë drogë nga Maroku në Spanjë, por niveli i angazhimit të pilotëve nga Ballkani në këtë trafik është akoma i paqartë.¹¹⁴




Porti i Valencias është një nga pikat kresore për trafikimin e kokainës në Evropë nga grupe te Ballkanit perëndimor.

© Blom UK nga Getty Images

Ka shenja se Afrika e Veriut është një zonë e re ku po shtrihet veprimtarinë e tyre grupet kriminale nga Ballkani. Trafikimi i kokainës nëpër këtë rajon po rritet, ashtu siç vërtetohet edhe nga kapja e dy sasive të mëdha me drogë në Algjeri në vitin 2019.¹¹⁵ Në gusht 2018, 11 malazezë u arrestuan në një anije (që lundronte nga ishujt Kanarie për në Turqi) me 20 tonë hashish, pasi autoritetet italiane vunë re se anija po lundonte në mënyrë të dyshimtë përgjatë bregdetit të Afrikës veriore.¹¹⁶ Po kështu, ka të dhëna se cigare dhe drogë po trafikohen nga Libia për në Ballkan,¹¹⁷ paralelisht me trafikimin e armëve nga Serbia për në Libi.¹¹⁸

Ndërkohë që shqiptarët, serbët dhe malazezët përmenden shpesh në lidhje me trafikimin e kokainës, ia vlen të përmendet se në nëntor 2019, dy shtetas nga Maqedonia e Veriut u arrestuan

në kuadër të një operacioni për të parandaluar trafikimin e 700 kilogramëve kokainë nga Madridi në Ballkan. Megjithatë, është interesant fakti se autoritetet spanjolle nuk i konsiderojnë shumë të rrezikshme grupet kriminale nga Ballkani. Sipas statistikave për periudhën nga viti 2017 deri në 2018 individë nga Ballkani perëndimor përbëjnë vetëm një për qind të personave të përfshirë në aktivitete kriminale. Ka zëra se disa nga figurat kryesore e kanë transferuar aktivitetin e tyre në Dubai.¹¹⁹ Ka të ngjarë se kjo lëvizje ka ardhur si pasojë e shtimit të ndjeshëm të dhunës në Costa del Sol në vitin 2018.¹²⁰ Sidoqoftë, megjithë numrin relativisht të vogël, grupet kriminale nga Ballkani perëndimor duket se luajnë rol të rëndësishëm në botën e krimit në Spanjë.



Hollandë: 'Jugomafia'

Në Hollandë, kriminelët nga Ballkani filluan të bëhen objekte të hetimeve policore nga fillimi i viteve 90. Shumica e pazareve kriminale në atë kohë (veçanërisht ndërmjet grupeve kriminale serbe dhe hollandeze) kishin të bënin me kontrabandën e armëve nga ish-Jugosllavia, në shkëmbim të drogave sintetike si ekstazi. Disa nga pjesëtarët e Jugomafias, ose *Joegomaffia* siç quhej nga hollandezët, kishin dalë nga gjiri i komunitetit të refugjatëve që kishin vajtur në atë vend pas përfundimit të luftës, ndërsa pjesa tjetër hynin e dilnin nga vendi. Mes këtyre të fundit kishte edhe vrasës me pagesë nga Ballkani. Sipas gazetarit të kronikës së zezë Wouter Laumans, aty rreth vitit 2000, grupet e krimit të organizuar në Hollandë paguanin individë nga Serbia për të kryer vrasje: "Në qarqet kriminale kishin reputacion shumë të mirë: "Jugot" ishin profesionistë të vërtetë kur vinte puna për të kryer një vrasje me pagesë." Një nga gangsterët me namin më të keq ishte serbi

Sreten Jociç, që njihet edhe si 'Joca Amsterdam'. Në vitin 1993 ai u akuzua në Hollandë për sulm ndaj një oficeri të policisë. U largua në drejtim të Bullgarisë, por më pas u arrestua dhe vuajti dënimin me burg. Në vitin 2010 u dënua me 15 vjet burg për vrasjen e rivalit të tij Goran Marjanoviç në vitin 1995.

Shqiptarët u përfshinë në trafikimin e qenieve njerëzore në vitet 90, dhe më pas në trafikimin e emigrantëve (për shembull, nga portet hollandeze për në Mbetërinë e Bashkuar), ndërsa pas vitit 2010 u përfshinë më shumë në trafikimin e drogës. (Mbase nuk është koinçidencë që kjo përkon me kohën kur u bë i mundur udhëtimi pa viza në Hollandë, në 2010.) Ashtu si përmendet edhe në lidhje me zona të tjera problematike të analizuar në këtë raport, ngjitja e shqiptarëve në shkallën e krimit ndjek pak a shumë të njëjtin model. Mesa duket ata hynë në tregun hollandez duke punuar për grupet



Hollanda është kthyer në një pikë të rëndësishme për kultivimin në ambiente të mbyllura të kanabisit që trafikohet nga grupe shqiptare nëpër Evropë.

© FlickrVision nga Getty Images

italiane, por sot, në vitin 2020, ata janë shndërruar në një nga faktorët kryesorë të tregjeve kriminale. Në fakt, ka të dhëna se shqiptarët ndërmarrin operacionet e veta transatlantike.

Hollanda është vend tërheqës për grupet kriminale nga Ballkani, falë pozicionit të saj dhe pikave të rëndësishme të transportit, si porti i Roterdamit, dhe aeroporti Schiphol. Duke qenë një njeje me famë botërore për transportimin e mallrave që prishen shpejt (veçanërisht lule, fruta dhe perime), kompanitë hollandeze janë mësuar që të punojnë me shpejtësi për transportimin e volumeve të mëdha me mallra. Por nga ana tjetër, kjo shpejtësi dhe efikasitet në punë do të thotë se shumë nga konteinerët nuk kontrollohen. Kjo është situatë ideale për trafikantët e drogës.

Ashtu si do të përmendet edhe më pas kapitullin e këtij raporti mbi Amerikën Latine, portet në Hollandë dhe Belgjikë (si Roterdami dhe Anversa) përdoren shpesh për të importuar sasi të mëdha kokaine nga Ekuadori, Brazili dhe Kolumbia – në vitin 2017, shtatë persona u arrestuan dhe u kapën dhjetëra kilogramë kokainë që vinin nga Ekuadori. Në fushën e trafikimit të drogës grupet shqiptare në Hollandë shpesh quhen 'uithalers' – që do të thotë 'marrësit' – me fjalë të tjera, persona që e marrin drogën, veçanërisht kokainë dhe heroinë, nga porte dhe e shpërndajnë anembanë veriut të Evropës perëndimore. Shumë nga grupet shqiptare të krimit të organizuar që veprojnë në Hollandë (dhe Belgjikë) i përdorin bazat e tyre si platforma për trafikimin e kokainës në Britani, tregu më i madh i kokainës në Evropë.

Shqiptarë të urtë

Është gabim t'i quash këto grupe një kartel shqiptar. Në fakt, kemi rreth 15 grupe kriminale shqiptare në vendet e Beneluksit që kanë krijuar lidhje me tre apo katër grupe shqiptare të krimit të organizuar me baza në Amerikën Latine, duke patur akses direkt në tregun e shitjes me shumicë të kokainës. Një grup me madhësi mesatare në Hollandë ka rreth 10 deri në 15 anëtarë. Ndonëse këto grupe preferojnë të punojnë me persona të njohur (nga i njëjti fis, apo nga e njëjta krahinë), këto kohët e fundit është vënë re një tendencë për formimin e grupeve multi-etnike. Në fushën e shpërndarjes së kanabisit, raportohet se grupet shqiptare të krimit të organizuar bashkëpunojnë ngushtë me organizata kriminale hollandeze, italiane, dhe marokene.¹²¹ Duket se ata kanë përfituar nga konflikti midis luftës së bandave midis kriminelëve me origjinë marokene.¹²² Thuhet se shqiptarët luajnë rol të dorës së parë në botën e krimit në Amsterdam.¹²³

Në shtator 2018, dy nga krerët e klanit Bajri u arrestuan në Rotterdam për trafik droge, kontrabandë armësh, prostitucion, zhvatje, organizimin e llotarive të paligjshme, dhe lojëra fati pa leje.¹²⁴ Po kështu, (siç u përshkrua më lart në kapitullin mbi Italinë) në gusht 2019, policia italiane arrestoi 17 persona që ishin pjesë e një rrjeti shqiptar për trafikimin e gati 200 kilogramëve kokainë nga Holanda në Itali.¹²⁵

Zyrtarisht, numri i shqiptarëve në Hollandë është shumë i vogël – rreth 1,200. Sidoqoftë, mendohet se ka shumë më tepër shqiptarë që jetojnë ilegalisht në këtë vend duke përdorur pasaporta të falsifikuara të vendeve të tjera të Bashkimit Evropian (veçanërisht nga Italia dhe Greqia), ndërsa shumë të tjerë jetojnë atje për një kohë të shkurtër.¹²⁶ Sipas një studimi nga një prokuror, mund të ketë afro 40,000 shqiptarë në Hollandë. Shumica e tyre janë mbledhur rreth Amsterdamit dhe Roterdamit, por ka edhe një komunitet të madh në Limburg, në jug të vendit.¹²⁷ Kjo zonë, që është shumë pranë Belgjikës dhe Gjermanisë, është bërë bazë e kultivimit të kanabisit në ambiente të mbyllura, dhe llogaritet se ky aktivitet mund të sjellë rreth 200 milionë euro në vit.¹²⁸ Për shembull, gjatë operacionit Shqipëria, në maj 2019, u arrestuan 30 persona të dyshuar në zonën e Limburgut, dhe 25 prej tyre ishin shqiptarë.

Grupet që zhvillojnë aktivitetin e tyre rreth zonës së Limburgut duket se janë të mirëorganizuar dhe të mirëinformuar. Përdorin eksperiencën e fituar në Shqipëri për rritjen e kanabisit (që në fakt e mësuan nga hollandezët). Kjo duket se është një prirje e përgjithshme. Ndërkohë që autoritetet shqiptare po godasin kultivimin e kanabisit në vendin e tyre, grupet shqiptare të krimit të organizuar e kanë transferuar përvojën e tyre jashtë vendit, jo vetëm në Hollandë, por edhe në Belgjikë, Britani, dhe Turqi. Duket se grupet shqiptare i kanë xhepat plot me para, ose kanë akses në fonde të mëdha, duke parë numrin e shtëpive që kanë blerë me para në dorë në zonën e Limburgut. Një prokuror nga Limburgu thotë se: "Është e çuditshme sa të zotë janë në gjetjen e pikave të dobëta në shoqërinë tonë. Dinë si të përdorin dokumente identifikimi false për të marrë shtëpi me qera në mënyrë të paligjshme. E dinë si të shfrytëzojnë noterët hollandezë, janë në gjendje të përdorin agjencitë e pronave të paluajtëshme për të blerë shtëpi; përdorin metoda shumë të rafinuara, dhe e dinë shumë mirë si të veprojnë."¹²⁹

Grupet shqiptare nuk konsiderohen si të dhunshëm, dhe nuk tërheqin vëmendjen e të tjerëve, pasi kjo do t'i prishte punë. Sipas një prokurori, edhe kur arrestohen, shqiptarët nuk bëjnë fjalë, dhe shpesh gjatë procesit gjyqësor "nuk e hapin gojën fare".¹³⁰

Mendohet se grupet shqiptare të krimit të organizuar luajnë një rol kryesor në skenën e krimit në Amsterdam.

Karteli i Titos dhe Dinos

Një nga grupet më të forta nga Ballkani perëndimor në Hollandë është karteli i Titos dhe Dinos. Udhëhiqet nga Edin Gaçanin, që u largua nga Bosnja gjatë luftës së bashku me familjen e tij dhe u vendos në Breda.

Në organizatën e tij marrin pjesë të afërm të familjes dhe persona nga ish-lagjja e tij e vjetër në Sarajevë, dhe mendohet se ky grup ka akoma lidhje të forta me politikanë dhe biznesmenë në Bosnjë. Gaçanini i hyri biznesit të drogës duke ndihmuar kriminelin Elvis Hodžić (Hodžić) në organizimin dhe transportin e kokainës nga Peruja në Evropë. Në ditët e sotme, ky grup ka krijuar lidhje të ngushta me kartelet kolumbiane dhe peruane. Për shembull, besohet se disa anëtarë të kartelit Tito dhe Dino aktualisht banojnë në Truillo, Peru, duke bashkëpunuar me katër kartelet vendase, për të bërë pazare dhe për të organizuar dërgesa droge për në Evropë.

Ata vazhdojnë të mbajnë lidhje me Bosnjën për pastrimin e parave të pista (ndonëse paratë pasi pastrohen në Bosnjë transferohen në llogari bankare në Hollandë). Po kështu, kanë themeluar kompani në Spanjë dhe Hollandë, që ka shumë mundësi të përdoren për pastrimin e parave të pista. Ky kartel ka lëshuar rrënjë të thella në Amerikën Latine, SHBA, dhe Evropë, si dhe ka krijuar lidhje në Sri Lanka dhe Hong Kong (ku janë kapur disa dërgesa me drogë të organizuara nga ky kartel). Gaçanini besohet se aktualisht jeton në Dubai.¹³¹ Thuhet se grupi i tij mban lidhje të ngushta me organizata kriminale marokeno-hollandeze, italiane dhe irlandeze (disa madje e kanë quajtur këtë grup 'super kartel') që mendohet se importojnë 30 tonë kokainë çdo vit nga portet e Roterdamit dhe Anversës.¹³²

Republika Çeke

Republika Çeke është një shembull tipik i vendeve që kanë ndërmarrë ndryshime thelbësore, por me të meta të shumta, në rrugën drejt ekonomisë së tregut. Pikërisht për këtë arsye këto vende janë shumë tërheqëse për mafiat që duan të gjejnë territore të reja.¹³³ Fokusi i këtij rasti studimor ka të bëjë më shumë me krimin ekonomik sesa me trafikimin.

Pas Revolucionit të Kadifenjtë të vitit 1989, Republika Çeke kaloi nëpër një proces të shpejtë tranzicioni post-komunist, duke përfshirë edhe shitjen e objekteve dhe kompanive publike me bono privatizimi. Gjatë këtij procesi transformimi politik dhe ekonomik, institucione rregullatore të dobëta, dhe një sistem drejtësie që nuk kishte përvojë në lidhje me metodat e reja të krimit të organizuar, krijuan hapësira për aktivitete mbrojtjeje dhe shantazhi, ekspozim ndaj korrupsionit, dhe pastrimit të parave të pista. Disa grupe kriminale ishin prezente në Republikën Çeke që përpara vitit 1989, por kaosi i viteve 90 krijoi një vakum, dhe ishte relativisht e lehtë për kriminelët që ta shfrytëzonin situatën e krijuar nga ndryshimi i sistemit për qëllimet e veta.

Ka disa arsye përse Republika Çeke ishte një vend tërheqës për kriminelët e rinj, veçanërisht për ato që vinin nga vende të ish-Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. E para ishte afërsia gjeografike me vende të Evropës perëndimore. E dyta ishte mundësia për të korrupuar autoritetet çeke.¹³⁴ Së treti, ishte shumë e lehtë për të huajt që të hapnin llogari bankare dhe të rregjistronin kompani në këtë vend – edhe në emrin e një personi të tretë.¹³⁵ Si rezultat i gjithë kësaj, ishte më e lehtë që të merrje leje qëndrimi të përhershme në Republikën Çeke, se në vendet e tjera të Evropës qendrore, dhe kjo ishte një nga qëllimet e anëtarëve të grupeve të krimit të organizuar.¹³⁶ Disa figura të njohura të krimit të organizuar ballkanik kanë regjistruar kompani në Republikën Çeke, duke përfshirë Darko Shariç, Andrija Drashković, Milan 'Lemon' Narançiç, Ismet Osmani dhe Qazim Osmani, si dhe Borislav Plavshić.¹³⁷¹³⁸ Në fakt, Qendra Çeke për Raportim Investigativ zbuloi në vitin 2015 se dhjetëra kompani të regjistruara në Pragë kishin lidhje, apo ishin përdorur direkt për pastrimin e parave të pista nga disa grupe të fuqishme të krimit të organizuar ballkanik, të përfshirë në trafikun e drogës, vrasjeve, dhe kontrabandës së cigareve.

Gjatë viteve 90, autoritetet çeke u përqendruan në luftën kundër forcimit të grupeve të krimit të organizuar nga vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, që konsideroheshin më të rrezikshme se grupet nga vendet e Ballkanit perëndimor. Kjo do të thotë se grupe kriminale nga Ballkani ishin në gjendje që të operonin gati pa rënë fare në sy në Republikën Çeke.¹³⁹ Edhe sot e kësaj dite, njohuritë në lidhje me këtë temë, edhe ndërmjet ekspertëve që fokusohen mbi luftën kundër krimit të organizuar në atë vend, mbetet relativisht i dobët.

Personazhe të krimit nga Ballkani me kontakte të forta në rajon krijuan bazat e tyre në Pragë. Një shembull tipik në këtë drejtim është edhe Jordan Mijalkov, babai i Sasho Mijalkov, që u bë shefi i shërbimit sekret të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë nën qeverisjen e Nikola Gruevskit, që u detyrua të linte postin pas akuzave për përgjime të shumta në vitin 2015. Jordan Mijalkov ishte ministri i parë i rendit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ai ka qenë gjithashtu edhe përfaqësues i kompanisë jugosllave Makoteks në Pragë, në vitet 80.¹⁴⁰ Ka shumë pak informacion në lidhje me aktivitetet e Jordan Mijalkovit në Pragë, por djali i tij Sasho, ndërsa mbante postin e shefit të policisë sekrete, refuzoi të jepte informacion mbi pasuritë e tij, duke përfshirë edhe pasuri të paluajtëshme me vlerë rreth dy milionë dollarë, dhe lidhjet me shumë kompani ndërtimi, ku kishin aksione disa partnerë të tij, duke përfshirë edhe vëllezërit Sparavalo, Dejan dhe Vojislav.¹⁴¹

Individë të tillë krijuan kontakte të forta me politikën dhe biznesin. Vetë fakti që disa personazhe nga Ballkani vazhdojnë të ruajnë pozita të forta në fushën e narkotikëve, bixhozit, dhe biznesit të pronave të paluajtëshme për dekada me radhë, tregon se këta individë ndihen rehat në shoqërinë çeke, falë kontakteve që kanë krijuar gjatë kësaj periudhe. Sa më shumë të forcohen pozitat e tyre, aq më të forta bëhen edhe lidhjet me autoritetet e vendit, kur vjen puna tek pasuritë e paluajtëshme, tenderat publikë, dhe biznesi i ndërtimit.

Nga ana tjetër, kriminelët shqipfolës (nga Kosova, Shqipëria, dhe Maqedonia e Veriut) janë marrë më shumë me krimin e rrugës, duke përfshirë edhe trafikimin e personave dhe drogës, veçanërisht në

qytetet pranë kufirit me Gjermaninë.¹⁴² Disa nga këto grupe janë bërë objekte hetimi për manipulime me taksën e TVSH-së dhe mashtime me sistemin e sigurimeve.¹⁴³ Sidoqoftë, në mes tyre ka patur edhe disa kriminelë me emër, si në rastin e Princ Dobroshit. Kosovari ishte një nga trafikantët kryesorë të drogës dhe transportonte heroinë nëpër korridorin ballkanik në Republikën Çeke, dhe prej andej në vendet nordike. Ai u arrestua në Pragë, në shkurt 1999, dhe më pas u ekstradua në Oslo (ku ishte arratisur nga burgu në vitin 1997). Më pas u lirua me kusht 'për sjellje të mirë', dhe u urdhërua të largohej nga vendi në janar 2005. Thuhet se është kthyer në Kosovë.¹⁴⁴

Një element tjetër që shpjegon arsyen përse Republika Çeke u kthye në një zonë problematike në lidhje me grupet kriminale nga Ballkani ishin lojërat e fatit. Që nga vitet 90, Çekia përdorej nga grupet e krimit të organizuar për pastrimin e parave të pista nëpërmjet pikave dhe kompanive të lojërave të fatit. Sipas ish-zëvendës ministrit të financës Ondrej Zavadski lojërat e fatit në Republikën Çeke nuk ishin të rregulluara me ligj deri në vitin 2017. Përpara reformës së sektorit të lojërave të fatit, në Republikën Çeke kishte më shumë se 6,000 pika për lojëra fati, dhe më shumë 70,000 makina lojërash elektronike.¹⁴⁵ Ky aktivitet tërhoqi një sërë personash me të kaluar kriminale, duke përfshirë Qazim Osmanin (që ishte një nga themeluesit e kompanisë së lojërave të fatit Banco Casino).¹⁴⁶ Sidoqoftë, Pavla Holková thotë se nuk ka më edhe aq shumë nevojë që bizneset e lojërave të fatit të përdoren si mekanizma për pastrimin e parave të pista.¹⁴⁷ Kjo vjen si pasojë e pozicionit që kanë fituar strukturat e krimit të organizuar nga vendet e Ballkanit perëndimor brenda rrjeteve globale të krimit të organizuar.¹⁴⁸ Këto grupe mund të përdorin fare lehtë rrjete ndërkombëtare për pastrimin e parave të pista dhe nuk kanë pse i mbajnë brenda Republikës Çeke.

Si përfundim, depërtimi i grupeve kriminale në vende të Evropës perëndimore tregon se si arritën të shfrytëzonin hapësira dhe mundësi, dhe si arritën të çanin në tregje kriminale të konsoliduara. Ashtu si tregohet edhe në kapitullin e mëposhtëm këto grupe i kishin hedhur sytë edhe nga lindja.



AFRIKA E JUGUT



Në periudhën 2018–2019, Afrika e Jugut u trondit nga një valë vrasjesh. Doli se shumë nga autorët dhe viktimat ishin shtetas të vendeve të Ballkanit perëndimor, veçanërisht nga Serbia. Ky kapitull tregon se si mëkatet e së kaluarës të gjejnë sado që mundohesh t'u fshihesh. Kjo analizë tregon se Afrika e Jugut mund të kthehet në një zonë problematike për trafikun e drogës për grupet nga Ballkani Perëndimor.

Importim kriminelësh

Komuniteti jugosllav në Afrikën e Jugut mendohet se ka më shumë se 10,000 vetë. Disa nga pjesëtarët e këtij komuniteti janë pasardhës të personave që kanë emigruar nga Jugosllavia në vitet 60 dhe 70. Pjesa tjetër kanë shkuar në atë vend në një valë të dytë emigrimi nga mesi i viteve 2000, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe pas tranzicionit të Afrikës së Jugut drejt demokracisë. Shumë prej tyre ishin profesionistë të zotë dhe me arsim të lartë, si mjekë apo llogaritarë, por kishte edhe kriminelë dhe ish-militantë që i fshiheshin drejtësisë. Ashtu si thotë edhe një ekspert vendas, “Në të vërtetë, ne po importonim kriminelë”.¹⁴⁹ Një gazetar serb nga *The Telegraph* tregon se sa e lehtë ishte për këta kriminelë që të ambientoheshin në Afrikën e Jugut:

Shumica e tyre ishin njerëz të ndershëm dhe punëtorë, por me ta u përzien edhe kriminelë që vazhduan aktivitetet e tyre jashtë vendit. Ata hynë lehtësisht në Afrikën e Jugut pa ndonjë kontroll të rreptë. Afrika e Jugut i kishte hapur dyert për persona nga Evropa lindore, kështu që ata përfituan nga rasti. Kishin sasi të mëdha parash dhe nuk e kishin problem të hapnin biznese. Ishin në gjendje që të përshtateshin shumë shpejt me kushtet e reja, dhe nuk hezitnin që të përfshihen në çfarëdo lloji aktivitetesh kriminale, me të gjitha organizatat apo gangsterët e vendit, pavarësisht nga feja, ngjyra e lëkurës, apo kombësia e tyre. Erdhën këty me eksperiencë kriminale për trafikim droge, shantazh, zhvatje, grabitje, vrasje, dhe vjedhje.¹⁵⁰

Afrika e Jugut ishte një vend tërheqës për kriminelët nga Ballkani perëndimor, pasi largësia e madhe nga vendi mëmë e bënte më të vështirë për autoritetet e ruajtjes së rendit që t'i gjurmonin (edhe si rezultat i mungesës së kanaleve të komunikimit, mangësisë në shkëmbimin e informacionit, dhe mungesës së marrëveshjeve dypalëshe të ekstradimit). Në të njëjtën kohë, Afrika e Jugut konsiderohet si vend i mirë për të bërë biznes, si në rrugë ligjore ashtu edhe në rrugë të paligjshme. Ky vend ka një sistem financiar të konsoliduar, infrastrukturë të mirë, dhe është një nyje e rëndësishme në shkëmbimin e mallrave dhe tregjeve botërore. Nga ana tjetër, sistemi i drejtësisë është i dobët, ka shumë korrupsion, dhe është një treg që krijon shumë mundësi për

- ◀ Vrasësi serb Dobrosav Gavrić në Gjykatën e Rrethit në Kejptaun, në seancën gjyqësore për ekstradimin e tij drejt Serbisë, në shkurt 2012. Gavrić u dënua në vitin 2008 për vrasjen e Arkanit, por u largua nga Serbia, dhe jetonte nën një emër të rremë në Afrikën e Jugut.

© Nardus Engelbrecht/Gallo Images nga Getty Images

aktivitete mbrojtjeje dhe shantazhi.¹⁵¹ Sipas një analisti, korrupsioni dhe kapja e shtetit e bën Afrikën e Jugut shumë tërheqëse për organizata kriminale.¹⁵² Po kështu, “numri i madh i vrasjeve në këtë vend u jep shumë mundësi që të shpëtojnë pa u diktuar kur kryejnë vrasje, pasi policia është e mbytur me punë”.¹⁵³ Disa të tjerë e vënë theksin mbi mungesën e kontrolleve: për shembull, ka mangësi në kontrollin e pasaportave të falsifikuara, që është një nga mënyrat

Krejçir dhe Gavriç

Këta dy kriminelë të regjur arritën në Afrikën e Jugut në vitin 2007: Radovan Krejçir (Krejćir), një çek që po i fshihej drejtësisë, dhe Dobrosav Gavriç nga Serbia.

Gjatë periudhës 2007–2013, Krejçir u bë një nga bosët e mafias në Afrikën e Jugut, dhe ka zëra se këtë e arriti duke korrumpuar si oficerë të rangut të ulët ashtu edhe komandantë të rangut të lartë të forcave policore të Afrikës së Jugut. Ai ka qenë i implikuar në vrasjen e disa individëve të lidhur me krimin, megjithëse nuk është dënua asnjëherë për vrasje. Më në fund u dënua për tentativë vrasje dhe rrëmbim personi, dhe aktualisht po vuan një dënim me 35 vjet burg. Ka bërë përpjekje në gjykata që të ekstradohet në Republikën Çeke.

Falë suksesit dhe pozitës së tij në qarqet kriminale në Afrikën e Jugut, Krejçir tërhoqi një numër personash që i fshiheshin drejtësisë nga Republika Çeke, Bullgaria, Libani dhe Serbia, që të punonin për të. Një prej tyre ishte edhe Veselin Laganin, një serb që më pas u gjet i vlarë në apartamentin e tij në Johannesburg në vitin 2013, pak kohë pasi Krejçir u arrestua. Aftësia që kishte Krejçir për të manipuluar forcat e ruajtjes së rendit i dha sinjalin kriminelëve në vende të tjera se Afrika e Jugut ishte një vend ku mund të kishin sukses.¹⁵⁶

Gavriç arriti në Afrikën e Jugut në vitin 2007 me shumë më pak bujë. Ai mbante emrin Sasha Kovaçević në Johannesburg për katër vjet, përpara se shërbimet informative të kishin dijeni për prezencën e tij në këtë vend. Në fakt, ai kishte të drejtë që e fshihte identitetin e tij të vërtetë. Sipas një dëshmie të paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit të Western Cape, Gavriç ishte pjesëtar i Forcave Policore Serbe në sektorin e parandalimit të krimit, që kryente disa funksione duke përfshirë edhe mbrojtjen e personaliteteve publike.¹⁵⁷ Gavriç ishte prezent kur u vra Zheļjko ‘Arkan’ Raznatoviç më 15 Janar 2000, në hollin e Hotelit Ndërkontinental në Beograd (Intercontinental Hotel). Edhe ai vetë u plagos gjatë këtij incidenti: një plumb qorr e goditi në shtyllën

kryesore për hyrjen e kriminelëve nga Evropa lindore në Afrikën e Jugut.¹⁵⁴ Duke qenë se shumica e pjesëtarëve të grupeve kriminale përdorin identitete të rreme për të hyrë në këtë vend, është e paqartë se sa prej tyre janë në Afrikën e Jugut. Burime policore thonë se hetimet kanë identifikuar nëntë individë deri në janar 2020, megjithëse mendohet se rrjeti kriminal është “shumë më i madh”.¹⁵⁵

kurrizore dhe që atëherë çalontë në mënyrë të dukshme. Gavriç pretendonte se nuk ishte përgjegjës për atë vrasje, por më pas u akuzua zyrtarisht për vrasjen e Arkanit. Gavriç e kuptoi se aleatët e Arkanit donin ta vrisnin dhe se “po sajuheshin prova të rreme për të siguruar dënimin e tij me burg” dhe se “e vetmja zgjidhje ishte që të ikte nga Serbia”.

Sipas burimeve nga shërbime informative, identiteti i rremë që përdorte Gavriç për t’u maskuar, ishte marrë nga një serb tjetër, që kishte jetuar në Johannesburg, dhe që çalonte kur ecte. Njëpërmjet këtij identiteti të rremë, Gavriç shtiu në dorë një sërë dokumentesh të ligjshme identifikimi nga Afrika e Jugut, si leje për çelje biznesi, leje për të mbajtur armë, dhe patentë. A hapi edhe një restorant në Johannesburg dhe arriti të hapë një kompani import–eksporti. Me sa duket, Gavriç krijoi marrëdhënie të ngushta me kriminelë vendas, duke përfutur edhe nga reputacioni i dhunshëm që kishin kriminelët nga Ballkani.

Identiteti i vërtetë i Gavriçit u zbulua në muajin mars 2011 pasi u plagos gjatë ekzekutimit të Cyril Beeka, një bos mafioz nga Cape Town. Gavriç po i jepte makinës së Beekas kur ndodhi incidenti. (Duket se Gavriç punonte si bodigard i Beekas, dhe i jepte informata mbi rrjete të krimit të organizuar nga Evropa lindore dhe Serbia, ndërsa Beeka mbronte Gavriçin nga policia.) Gavriç u arrestua pasi u kap me kokainë, si dhe për mbajtje të dokumenteve të rreme me emrin Sasha Kovaçević. Aplikimi i tij për strehim në Afrikën e Jugut u refuzua dhe ai vazhdon të mbahet i burgosur në Cape Town, ndërsa akoma vazhdon luftën për të shmangur ekstradimin në Serbi. Procesi gjyqësor ndaj Gavriçit ka nxjerrë në pah mangësitë e sitemit të drejtësisë penale në Afrikën e Jugut. Një proces që nuk duhet të kishte zgatur më shumë se tre muaj ka vazhduar për nëntë vjet me radhë – dokumentacionet gjyqësore kanë humbur dy herë, dhe duhet të niste procedura nga e para.



Ish-bosi çek i kimit të organizuar, Radovan Krejçir, i dënua me burgim, në gjykatën e rrethit në Palm Ridge, Johannesburg, dhjetor 2013. © Moeletsi Mabe/The Times/Gallo Images nga Getty Images

Një shembull tjetër që tregon qartë se Afrika e Jugut është bërë strehë për kriminelë serbë që kërkohen nga drejtësia është edhe rasti i Darko Shariç. Sipas raportimeve në media dhe burimeve brenda komunitetit serb, mendohet se Shariç fshihej në krahinën e Gautengut gjatë periudhës 2012–2013. Në atë kohë Shariç ishte një nga trafikantët e drogës më të kërkuar nga policia. Mendohet se përdorte një emër të rremë

dhe krerët e krimit në atë zonë e ndihmonin që të qëndronte fshehur, nëpërmjet kontakteve të tyre, dhe policëve të korrumpuar. Besohet se Shariç kishte lidhje të ngushta me Krejçirin, dhe pikërisht për këtë arsye kishte vendosur të shkonte në Gauteng.¹⁵⁸ Sapo autoritetet u informuan mbi praninë e tij në atë zonë dhe filluan hetimet, ai u largua nga Afrika e Jugut.

Larje hesapesh

Gjatë periudhës 2018–2020 pati të paktën nëntë ekzekutime dhe dy tentativa vrasje në zonën e Johannesburgut, që kishin të bënin me Serbë që ishin anëtarë të grupeve kriminale, apo ish-pjesëtarë të reparteve paraushtarake. Shumica e këtyre incidenteve i ngjasonin njëri-tjetrit dhe metodat e përdorura ishin pak a shumë të ngjashme. Në pjesën më të madhe të këtyre rasteve, objektivat e sulmit ishin kapur në befasi, dhe shpesh ishin duke i dhënë makinës. Sulmi kryhej nga dy persona në motoçikletë, dhe që të dy mbanin helmata për të fshehur identitetin. Të shtënat vinin nga pasagjeri në motoçikletë, që qëllonte me breshëri me armë automatike, dhe pastaj largoheshin me shpejtësi. Nga pamjet filmike të kamerave të sigurisë që kishin filmuar këto incidente, duke se vrasësit kishin patur stërvitje ushtarake dhe vepronin me precision gjatë ekzekutimit të sulmit, duke treguar se në të kaluarën kishin milituar në struktura ushtarake apo paraushtarake.¹⁵⁹

Kjo valë vrasjesh duket se ishte larje hesapesh të vjetra. Ashtu si shpjegon edhe Milica Vojinovic, këta persona kishin vajtur në Afrikën e Jugut disa vite më parë, dhe marrëdhëniet midis tyre kishin të bënin me lidhjet që kishin patur me rrjetet kriminale në të kaluarën.¹⁶⁰ “Shumica e tyre janë kriminelë disi më të vjetër që vepronin në Serbi në vitet 90. Zakonisht janë me të vjetrën, dhe u larguan nga Ballkani aty nga fillimi i viteve 2000.” Disa nga serbët që u vranë në Afrikën e Jugut gjatë periudhës 2018–2020 kishin lidhje me Gavriç, ishin pjesë e rrjetit të tij dhe prej tij kishin shkuar në Afrikën e Jugut. Një prej tyre ishte Milan ‘Miki’ Xhuriçiq, që u qëllua për vdekje në Strijdom Park (një lagje periferike e Johannesburgut) në prill 2018. Edhe ai kërkohet nga policia në Serbi për pjesëmarrje në vrasjen e Arkanit, ashtu si dhe Gavriç. Mendohet se Xhuriçiq kishte rreth tre vjet që qëndronte fshehur në Afrikën e Jugut ku kishte hyrë me një pasaportë belge.

*Afrika e Jugut
është një
vend tërheqës
për kriminelë
nga vende
të Ballkanit
perëndimor*

Raportimet nga terreni tregojnë se ai kishte hapur një biznes të vogël që kishte lidhje me hotele, por ishte gjithashtu i përfshirë në trafikim të qenieve njerëzore, dhe trafik droge.

Darko Kuliç, që u qëllua në Randburg (pranë Johannesburgut) në qershor 2018, kishte lidhje me Xhuriç, dhe mund të jetë vrasësi i pasit kishte informata mbi personin që vrau Xhuriç. Kuliç kishte luftuar në radhët e grupit parashtararak Garda Serbe gjatë luftës civile në Jugosllavi në vitet 90. Më pas thuhet se u përfshi në krimin e organizuar, dhe në fund vendosi të transferohej së bashku me familjen e tij në Johannesburg. Ai ishte edhe mik i biznesmenit malazezo-jugafrikan George 'Hollywood' Milhajevic, që u qëllua për vdekje në Bedfordview në shtator 2018. Ata mund të kenë qenë ortakë biznesi, ose ka të ngjarë se shkuan në Afrikën e Jugut ngaqë njihnin patriotët të tyre që mund t'i ndihmonin që të integroheshin në atë vend. Në shtator 2017, një person i quajtur Ivan Xhorxheviç (Djordjevic – një shok i Gavriçit) u qëllua, por nuk u vra, në një restorant KFC pranë Bedfordview. Ai u vra në prill 2019 kur dy persona më maska i ranë nga pas me makinë dhe hapën zjarr me armë gjysmëautomatike. Ka zëra se vdekja e tij lidhej me zhdukjen e një ngarkese me një ton kokainë.¹⁶¹ Në të dy rastet e vrasjeve të Xhorxheviç dhe Kuliç, makinat e përdorura nga vrasësit u braktisën diku pranë dhe iu vu flaka. Vrasësit u larguan me makina të tjera.

Disa mendojnë se për secilin rast vrasësit ishin sjellë nga Serbia, duke hyrë dhe dalë nga vendi për punë ditësh. Ka të tjerë që kanë hedhur idenë se vrasësit janë vendalinj. Ata mund të kenë qenë elementë të përzgjedhur nga bandat në Cape Town, ish ushtarakë nga Zimbabveja apo Mozambiku, apo edhe nga sektori i taksive. Ashtu si është dokumentuar edhe në librin e Mark Shaw *Vrasës me Pagesë (Hitmen for Hire)*, në Afrikën e Jugut ka shumë kandidatë për vrasës me pagesë.¹⁶²

Akoma nuk ka ndonjë shpjegim të qartë për rritjen e nivelit të dhunës pasi nuk ka patur arrestime apo procese gjyqësore. Edhe mbledhja e informatave nga forcat e ruajtjes së rendit nuk është në nivele të kënaqshme, si pasojë e dobësimit të institucioneve shtetërore gjatë dekadës së fundit të kapjes së shtetit. Siqodoftë, intervistat dhe raportimet mediatike sugjerojnë dy teori. E para është se vrasjet mund të jenë një formë hakmarrje për vrasjen e Arkanit në vitin 2000. Kjo lidhet me faktin se shumë nga viktimat kishin shumë vite që fshiheshin në Afrikën e Jugut, shpesh duke përdorur emra të rremë apo pseudonime, dhe ishin pjesë e një rrjeti të krijuar nga Gavriç. Mendohet se emrat e tyre të vërtetë janë dekonspiruar dhe më pas u bënë objekt sulmi. Ka njerëz që besojnë se e gjithë kjo situatë ka lidhje me kthimin në Serbi në vitin 2016 të mbledhësit të informatave George Darmonovic, dhe lëshimin e informacionit mbi personat që fshiheshin në Afrikën e Jugut, dhe ku mund të gjendeshin. Ai besohet se kishte lidhje të ngushta me qarqet kriminale në Serbi, shërbimet informative në Serbi dhe Afrikën e Jugut, dhe ka shkëmbyer informata me këto organizata. Me sa duket kjo e bëri objekt sulmi. Në maj 2018 ai u qëllua dhe u vra nga dy persona në motoçikletë, përballë një gjykate në lagjen e Beogradit të Ri në kryeqytetin serb, më pak se dy javë pas vrasjes së Xhuriç.

Sipas teorisë së dytë, këto vrasje u shkaktuan nga një luftë për kontrollin e drogës – mbase nga ndonjë konflikt midis fraksioneve rivale serbe mbi kontrollimin e korridoreve të transportit të drogës, ose nga mungesa e pagesës për ndonjë ngarkesë droge. Ndonëse ka shumë pak të dhëna në këtë drejtim, është hedhur ideja se ky konflikt mund të ketë lidhje me luftën midis dy grupeve malazeze, klani Kavacki dhe klani Shkaljarski.¹⁶³ Sidoqoftë, mund të jetë edhe një kombinim i të dy teorisë – drogë dhe hakmarrje.

Ka shumë dyshime në lidhje me aftësinë e policisë së Afrikës së Jugut për të arrestuar kriminelët dhe për të shkatërruar këto organizata. Në fakt, shumica e personave të intervistuar tha se policia nuk ndërhynte qëllimisht, duke i lënë "serbët të vrasin njëri-tjetrin." Mendohet se nuk ka ndonjë vullnet për t'i zgjidhur këto çështje pasi ka patur shumë pak viktime të pafajshme, dhe është në interes të vendit që kriminelët

të eliminojnë njëri-tjetrin. Por ky qëndrim mund të kthehet si bumerang. Mungesa e ngritjes së akuzave nga prokuroria, dhe proceset e stërzgatura gjyqësore, si në rastin e Gavriçit, mund të përçojnë mesazhin se kriminelët mund të veprojnë pa u hyrë

gjemb në këmbë në Afrikën e Jugut. Kjo mund të inkurajojë grupet kriminale që të thërrasin më shumë nga bashkëkombësit e tyre për të zgjeruar rrjetet e tyre kriminale në tokën e mrekullive.¹⁶⁴

Aktorë të rinj në skena të reja?

Me sa duket një gjeneratë e re kriminelësh nga ish-Jugosllavia po përfshihet në tregtinë e drogës në Afrikën e Jugut. Nuk ka patur arrestime, as marrje në pyetje, dhe as procese gjyqësore, duke e vështirësuar shumë mbledhjen e informacioneve. Sidoqoftë, Afrika e Jugut është kthyer në një pikë të rëndësishme tranziti në korridoret e trafikimit të drogës nga kartelet e kokainës, dhe tashmë dihet mirë se rrjetet serbe janë disa nga faktorët kryesorë në tregtinë e kokainës. Një oficer i lartë policie ka hedhur idenë se kokaina hyn në vend nga portet detare të Port Elizabeth dhe Durban, transportohet në Gauteng (ku ripaktohet), dhe shpërndahet më tej në destinacione. Ka të ngjarë se kokaina transportohet nga Amerika Latine në Afrikën e Jugut, dhe hyn në Evropë nga Turqia.

Po kështu, Afrika e Jugut mund të jetë një pikë tranziti në trafikimin drejt tregjeve të tjera të pasura, si Australia. Në të kaluarën ka patur disa arrestime që tregojnë se ka patur përpjekje për të krijuar korridore trafikimi midis dy vendeve – si në rastin e tentativës nga ana e Krejçir për të dërguar methamfetaminë në Australi në vitin 2013. Po kështu, në vitin 2019 u zbulua një sasi kokaine, që ishte fshehur në një ngarkesë me materiale ndërtimi që po dërgohej nga Afrika e Jugut për në Australi, dhe raportimet mediatike e lidhin këtë ngarkesë me një grup serb në Afrikën e Jugut. Ka patur edhe përpjekje për të krijuar një treg të brendshëm për drogat: sipas një prej krerëve të botës së krimit, serbët në Afrikën e Jugut po blejnë kokainë nga kolumbianët dhe e fusin për shitje në Afrikën e Jugut, duke përdorur vendasit për të shpërndarë narkotikë nëpër rrugë. Ka edhe informata se në Afrikën e Jugut janë ngritur laboratorë për përpunimin e drogave dhe eksportimin e tyre.¹⁶⁵

Duke qenë se kartelet kolumbiane gjenden nën presionin e organizatave policore ndërkombëtare dhe po mundohen të krijojnë korridore të reja, mund

ta shohin të udhës që të ngrenë baza operative në Afrikën e Jugut. Ka patur dy raste që tregojnë se diçka e tillë mund të ndodhë. Në mars 2017, një anije me vela u ndalua nga roja bregdetare portugeze në Oqeanin Atlantik, 600 milje nga Ishujt Azore. Gjatë kontrollit u gjendën 400 kilogramë kokainë shumë e pastër. Nga informata të mëvonshme doli se kokaina ishte ngarkuar në Afrikën e Jugut. Anija ishte regjistruar në Trieste, dhe duket se ky port ishte edhe destinacioni i fundit. Rezultatet e hetimit nuk janë bërë akoma publike, por mendohet se shtetas malazezë organizuan transportin e kësaj ngarkese narkotikësh. Në vitin 2019, një malazez, Marko Bozoviç, u arrestua në Afrikën e Jugut pasi dyshohej se ishte përfshirë në trafikimin e 807 kilogramëve kokainë nga Venezuela për në Evropë. Aktualisht po vuan dënimin në një burg në Afrikën e Jugut. Gjatë arrestimit iu gjet një pasaportë e Afrikës së Jugut.¹⁶⁶

Shkurtimisht, rasti i kriminelëve nga Ballkani perëndimor në Afrikën e Jugut tregon pasojat e konflikteve të vjetra, trashëgiminë e luftës dhe mungesën e stabilitetit në ish-Jugosllavi. Ndonëse personat që emigruan atje nuk mund të konsiderohen grup i mirëfilltë kriminal, historia e tyre tregon se si u munduan t'i shpëtonin drejtësisë dhe jetës së krimit në vendin e tyre (veçanërisht në Serbi), dhe se si nuk mundën t'i shpëtonin dot të kaluarës së tyre. Kjo tregon edhe dobësinë e sistemit të drejtësisë penale në Afrikën e Jugut dhe institucioneve të tjera, që lejuan hyrjen e këtyre personave në atë vend, i lanë të vepronin lirshëm, dhe në fund nuk ishin në gjendje të gjenin se kush i vrau. Ajo që është më shqetësuese për të ardhmen, është fakti se Afrika e Jugut duket se është kthyer në një vend tërheqës dhe zonë problematike për një brez të ri grupesh kriminale nga Ballkani perëndimor, që janë përfshirë në rrjetet botërore të trafikimit të kokainës.



TURQI

PORTA E HYRJES PËR NË LINDJE



Turqia është një bazë e rëndësishme për trafikimin e heroinës dhe trafikimit të emigrantëve. Ky kapitull merret me aktivitetet në Turqi të grupeve kriminale nga vendet e Ballkanit perëndimor, si dhe me bashkëveprimet ndërmjet grupeve kriminale turke dhe atyre nga vendet e Ballkanit perëndimor.

Lidhje të forta midis Turqisë dhe Ballkanit

Grupe kriminale nga Ballkani perëndimor kanë patur lidhje me Turqinë që nga vitet 70 dhe 80. Në atë kohë, persona nga ky rajon përdorshin si shoferë dhe transportues në trafikimin e drogës, dhe Ballkani përdorej si rajon tranzit, për ripaketimin dhe shpërndarjen e drogave. Disa raste kanë treguar se shqiptarët e Jugosllavisë (ashtu quheshin shqiptarët nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut), ishin angazhuar si ndihmës në trafikimin e heroinës dhe bazë morfine nga Turqia, nëpër Jugosllavi dhe Bullgari, deri në Itali.¹⁶⁷ Ashtu si u tha më lart, kishte edhe trafikim armësh.

Ashtu si dhe zonat e tjera problematike, Turqia ka një diasporë të madhe nga Ballkani perëndimor. Pjesa më e madhe e kësaj popullsie ka jetuar në Turqi që nga koha e shpërnguljeve dhe shkëmbimit të popullatave gjatë luftërave ballkanike të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe luftës së parë botërore, si dhe në disa valë emigrimi pas themelimit të Republikës së Turqisë në vitin 1923.¹⁶⁸¹⁶⁹ Sipas një përlllogaritjeje, 1.8 milionë persona emigruan nga Ballkani për në Turqi që nga viti 1923 deri në fillimet e viteve 90, që u ndoq nga disa dhjetëra mijëra emigrantë si pasojë e mungesës së stabilitetit në ish-Jugosllavi dhe Shqipëri në vitet 90.¹⁷⁰¹⁷¹ Disa nga këta emigrantë nga Ballkani jetonin në lagje relativisht të varfra ku krijuan lidhje me shitës ambulante kurdë në qytetet e mëdha turke, si Stambolli dhe Izmiri.

- ◀ Pjesëtarë të forcave të armatosura të Turqisë bëjnë rojë gjatë një operacioni kundër trafikut të qenieve njerëzore në Bodrum, tetor 2013. Lidhjet dhe rrjetet e trafikantëve të drogës po përdoren për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kalimin e paligjshëm të emigrantëve nga grupe të Ballkanit perëndimor. © Ali Balli/Anadolu Agency nga Getty Images

Gjatë luftës në Jugosllavi, grupet kriminale turke në përgjithësi i shmangeshin Ballkanit perëndimor. Nga fundi i viteve 90, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë Hercegovinë dolën si baza të reja për magazinimin e përkohshëm për sasi gjithnjë e më të mëdha heroine, që po vërshonte nëpër këtë rajon drejt Evropës perëndimore, si pasojë e shtimit të kultivimit të opiumit dhe prodhimit të heroinës nga lufta në Afganistan. Në fakt, studimet kanë treguar se rritja e prodhimit të opiumit afgan dhe rritja e

sasisë së heroinës të konfiskuar në Turqi përkon në një nivel prej 93 për qind.¹⁷²

Takimet kryesore midis grupeve ballkanike dhe turke kryheshin në vende të Ballkanit perëndimor (dhe Bullgari), dhe jo në Turqi. Ky rajon konsiderohej si vend i sigurtë për të zhvilluar bisedime. Ndonëse negociatat nuk zhvilloheshin në shtëpinë e tyre, turqit ishin në kontroll të kësaj marrëdhënieje asimetrike.

Nga valixhet tek kamionët

Në fillim të viteve 90, emigrantët ballkanikë në Turqi nisën një "tregti me valixhe" ndërmjet Turqisë dhe vendeve të origjinës. Ata blenin produkte të ligjshme me çmime të lira në Stamboll dhe i shisnin me çmime më të shtrenjta në tregjet ballkanike. Ata ishin në gjendje që të udhëtonin lirshëm midis këtyre vendeve, pasi Turqia aplikonte një politikë të lirshme vizash për shtetasit e vendeve të Ballkanit perëndimor. Ky aktivitet nuk ishte akoma krim i organizuar, por tregtia me valixhe u shfrytëzua shumë shpejt nga grupet turke dhe të Ballkanit perëndimor për kontrabandën e cigareve dhe drogave.¹⁷³ Në fakt, ndërkohë që disa përdornin valixhe, disa të tjerë përdornin kamionë, dhe çirakët shqiptarë e përvetësuan shumë shpejt artin e tregtisë së paligjshme që e mësuan nga shefat turq. Ata përfitonin nga numrat gjithnjë e të mëdha të emigrantëve shqiptarë në Evropën perëndimore për të zgjeruar rrjetin dhe veprimtaritë e tyre. Shumë shpejt shqiptarët (veçanërisht nga Kosova) u përfshinë në të gjitha hallkat e zinxhirit të trafikut: që nga blerja e drogës nga grupet turke, trafikimit të drogës (shpesh nëpërmjet Bosnjë Hercegovinës dhe Maqedonisë së Veriut), dhe shpërndarjes së saj nëpërmjet diasporës në Evropën perëndimore.

Si shembull mund të merret Sami Hostan, që njëhej në botën e krimit edhe me nofkën Arnavut (Shqiptari) Sami. Familja e tij kishte emigruar në Turqi nga Maqedonia e Veriut. Sipas burimeve policore turke, Hostani trafikonte sasi të mëdha droge nëpër Turqi, Amerikën e Jugut, dhe Evropë. Ai kishte lidhje të dyshimta biznesi me rrjete të trafikimit të drogës në Hollandë dhe Kolumbi.

Brenda një kohe të shkurtër arriti të fitojë shuma të mëdha nga trafiku i narkotikëve. Më pas filloi të investonte shumë në fushën e lojërave të fatit dhe ishte një nga pronarët e kazinosë në Hotel Sheraton në Stamboll. Sami Shqiptari u dënua me katër vjet burg për krijimin dhe drejtimin e një rrjeti kriminal.

Trafikantët ballkanikë kanë përfituar nga bumi i heroinës në Afganistan gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Grupet kriminale turke dhe nga Ballkani perëndimor bëjnë edhe përpunimin e heroinës që transportojnë, duke ulur nivelin e pastërtisë dhe duke shtuar kështu fitimet e tyre. Në pikat e hyrjes në lindje të Turqisë, pastërtia e heroinës është zakonisht në nivelin 70 për qind, dhe ulet nën 50 për qind kur kalon në krahinat perëndimore.¹⁷⁴ Kjo tregon se pastërtia e heroinës reduktohet për të rritur fitimet. Në vitin 2015, u llogarit se fitimi i përgjithshëm bruto nga trafikantët e opiateve në Evropën juglindore ishte rreth 1.7 miliardë dollarë në vit.¹⁷⁵

Në të njëjtën kohë, një kërkesë në rritje për kanabis, ekstazi dhe droga sintetike në Turqi krijoi mundësi për shtetasit e vendeve të Ballkanit perëndimor që të transportonin këto lloj drogash nga Evropa në Turqi në shkëmbim të heroinës. Po kështu, taksat e larta mbi cigaret në Turqi krijuan një treg në rritje për kontrabandën e cigareve shumë më të lira nga Ballkani.¹⁷⁶ Në fakt, thuhet se disa grupe që trafikonin heroinë kaluan tek kontrabanda e cigareve falë fitimeve të mëdha dhe rrezikut më të vogël për t'u dënuar me burg.¹⁷⁷

Thithja e investimeve dhe tregtisë

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, Turqia po kërkonte për investime të reja. Në fillim të viteve 90 u miratuan disa ligje për të lehtësuar udhëtimin dhe investimin në Turqi. Një nga efektet anësore të këtij procesi ishte se kriminelë nga vende të Ballkanit perëndimor që hiqeshin si biznesmenë e kishin të lehtë të udhëtonin dhe të bënin tregti në Turqi, dhe madje edhe të pajiseshin me pasaporta turke dhe të pastronin para. Po kështu, edhe shtetasit turq e kishin më të lehtë që të merrnin pasaporta dhe viza nga vendet e Ballkanit perëndimor.

Që nga viti 2020, shtetasit e të gjitha vendeve të Ballkanit perëndimor mund të qëndrojnë në Turqi deri në 90 ditë pa patur nevojë për viza.¹⁷⁸ Mund të përdorin letërnjoftimet e vendeve të origjinës, dhe pasaportat e tyre janë në vlefshme në Turqi për pesë vjet edhe pas afatit të skadencës. Në mënyrë reciproke, shtetasit turq mund të qëndrojnë në vendet e Ballkanit perëndimor pa viza për 90 ditë. Ky sistem lëvizjeje pa viza krijon shumë hapësira dhe mundësi për grupet kriminale për trafikim midis këtyre dy rajoneve. Po kështu, shumë emigrantë

nga vende të Ballkanit perëndimor kanë shtetësi të dyfishtë, gjë që i lejon të udhëtojnë lirshëm ndërmjet Turqisë dhe vendeve të tyre të origjinës.

Në vitin 2018, qeveria turke paraqiti një politikë të re për dhënie të nënshtetësisë, që shkaktoi rritjen e fluksit të kimit të organizuar në vend. Sipas rregullave të reja, kushdo që fut 250,000 dollarë në Turqi fiton nënshtetësinë turke pa patur nevojë që të justifikojë burimin e parave.¹⁷⁹ Kjo politikë krijon avantazhe për persona me të ardhura të paligjshme, dhe disa prej tyre kanë blerë prona luksoze, veçanërisht në Stamboll dhe Izmir, dy qytete që shërbejnë si pika koordinimi për pazare të paligjshme në nivele rajonale.¹⁸⁰

Gjatë 20 viteve të fundit, ka patur një rritje të madhe të aktivitetit tregtar ndërmjet Turqisë dhe vendeve të Ballkanit perëndimor, falë një sërë marrëveshesh për liberalizimin e tregtisë (shiko Figurën 2). Disa grupe kriminale, si në Turqi ashtu dhe në Ballkanin perëndimor, kanë shfrytëzuar këtë hapje duke krijuar kompani fantazëm për të maskuar trafikimin e sasive të mëdha të drogave, cigareve dhe armëve.¹⁸¹




FIGURA 2 Tregtia reciproke e Turqisë me vendet e Ballkanit perëndimor (në dollarë amerikanë)

BURIMI: Instituti i Statistikave të Turqisë, Statistikat mbi Tregtinë e Jashtme, shifra të datës 3 prill 2020, <https://biruni.tuik.gov.tr/disticaretapp/disticaret.zul?param1=4¶m2=0&sitcrev=0&isicrev=0&sayac=5808>

‘Korridori Ballkanik’ i heroinës

I ashtuquajtura korridori ballkanik njihet më tepër për transportimin e heroinës nga Afganistani nëpër Iran, në Turqi, dhe përmes Ballkanit perëndimor. Që këtë drogë dërgohet në tregjet kryesore në perëndim (Hollandë, Gjermani, Britani, Francë dhe Spanjë). Që nga vitet 70, sasi të mëdha heroine prodhohen në Turqi duke përdorur bazë morfine që silllet nga Irani dhe Afganistani. Reagenti kimik për prodhimin e heroinës nga opiumi –anhidrid acetik – importohet nga Republika Çeke, Rusia dhe Gjermania.¹⁸² Prodhimi i heroinës ka bërë që grupet turke të krimit të organizuar të bëhen furnizuesit dominantë të heroinës në Evropë.

Grupet turke prodhojnë heroinë të cilësisë së lartë (pastërti 70–97 për qind) falë një eksperience prej disa brezash.¹⁸³ Pronësia mbi laboratorët e prodhimit të drogës, kompanitë e transportit, dhe rrjetet e shpërndarjes në Evropë i ka dhënë mundësi grupeve turke që të dominojnë tregun e heroinës në Evropë për dekada me radhë. Llogaritet se të ardhurat vjetore nga tregtia e paligjshme e drogës nga mesi i viteve 90 arrinin në 50 miliardë dollarë.¹⁸⁴ Një studim tjetër llogariti se të ardhurat vjetore nga trafikimi i drogës në Turqi në vitin 2014 arrinin në rreth 15 miliardë dollarë.¹⁸⁵ Ka të ngjarë se kjo shifër është rritur që nga viti 2014, duke patur parasysh rritjen e ndjeshme të tregut të drogës brenda vendit dhe trafikimit rajonal. Sasia e heroinës së trafikuar mund të përlllogaritet në bazë të numrit të madh të arrestimeve, rasteve dhe konfiskimit të ngarkesave me heroinë. (shiko Figurën 3).




FIGURA 3 Arrestimet, rastet dhe sasia e ngarkesave me heroinë të konfiskuara (në kilogramë), Turqi, 2012–2018

BURIMI: TUBIM, Raporti i drogës për Turqinë 2019, Ankara, 2019.

Grupe kriminale nga Ballkani perëndimor zakonisht i bëjnë pazaret e drogës në Stamboll, Izmir, Tekirdag, Edirne, dhe pak më rrallë në Gaziantep.¹⁸⁶ Në shumë raste shkëmbejnë stimulantë tip amfetamine (ATS), ekstazi, dhe super marihuanë nga Evropa me heroinë që sillet nga Irani.

Shpesh trafikantë shqipfolës nuk e transportojnë heroinën direkt për në Evropën perëndimore, por e përpunojnë dhe ripaketojnë heroinën e blerë nga grupe turke dhe iraniane, duke reduktuar pastërtinë përpara futjes së heroinës afgane në Evropën perëndimore.¹⁸⁷ Nganjëherë heroina magazinohet përkohësisht në baza të ndryshme në vendet e Ballkanit perëndimor. Për shembull, ministria e rendit në Maqedoninë e Veriut raportoi mbi shkatërrimin e një organizate kriminale në muajin shkurt 2019, në bashkëpunim me agjencinë e luftës kundër drogës të Shteteve të Bashkuara (DEA). Grupi kriminal ishte përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në trafikimin e heroinës dhe kanabisit nga Turqia në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri, dhe më pas drejt Zvicrës, dhe vendeve të Evropës perëndimore. Ky grup kishte ngritur edhe laboratorë për prodhimin e stimulantëve tip amfetamine (ATS).¹⁸⁸ Ka të dhëna se heroina kalon tranzit edhe nga Kosova.¹⁸⁹

Një zhvillim i kohëve të fundit tregon se mund të ketë ndryshime në strukturën e trafikut të heroinës, dhe pasqyron rritjen e vetëbesimit nga ana e trafikantëve shqipfolës. Me sa duket, në disa raste ata janë përpjekur që të anashkalojnë rrjetet turke të trafikimit të drogës, dhe të krijojnë kontakte direkte me furnizuesit iranianë të heroinës. Për shembull, shtatë shtetas shqiptarë u arrestuan me 250 kilogramë heroinë në kuadër të një operacioni kundër një grupi kriminal me anëtarë nga shtete të ndryshme (duke përfshirë edhe iranianë), që vazhdimisht trafikonte heroinë nga Turqia për në Hollandë dhe Gjermani. Disa njësi nga sektori antikontrabandë dhe kundër krimit të organizuar të policisë turke (KOM) arrestuan një grup tjetër të përbërë nga shtatë shqiptarë në kuadër të pesë hetimeve paralele që çuan në konfiskimin e 82 kilogramëve heroinë, pesë kilogramëve opium, gjashtë kilogramëve të një reagenti kimik, dhe 450 gramë kanabis.¹⁹⁰ Nga ana tjetër, edhe grupet iraniane duket se po përpiqen që të krijojnë bazat e tyre në Ballkanin perëndimor. Kjo mund të ketë pasojë të paparashikueshme për sigurinë në Ballkan.¹⁹¹

Thuhet se trafikantët e heroinës përdorin të paktën 18 rrugë të ndryshme nga Turqia për në tregjet evropiane. Objektivi kryesor i ngarkesave më heroinë janë Holanda, Gjermania, Shqipëria, dhe Moldavia.¹⁹² Përveç korridoreve tokësore, hetime të zhvilluara në Turqi, Greqi dhe Shqipëri tregojnë se rrjetet turko-shqiptare shfrytëzojnë 174 portet detare të Turqisë, dhe mijëra mole të vogla përgjatë bregdetit të Detit të Zi, Detit të Marmarasë, Detit Egje dhe Detit Mesdhe për trafikimin e kanabisit dhe heroinës. Origjina primare e transportit të drogës me rrugë detare ka qenë Amerika e Jugut dhe Lindja e Mesme, ndërsa ngarkesat që dalin nga Turqia kanë si destinacione Hollandën, Gjermaninë, Belgjikën, Italinë, Britaninë, Greqinë dhe Italinë.¹⁹³ Që nga viti 2015, forcat e rendit në Turqi kanë konfiskuar sasi të mëdha droge nga mjete detare transporti që kontrolloheshin nga grupe kriminale shqiptare. Zakonisht kontrollet dhe siguria në mole është e kufizuar,¹⁹⁴ dhe duket se kjo është edhe pika më e dobët në kontrollin e kufirit të Turqisë me vendet e Bashkimit Evropian. Që këtu jahte luksoze dhe skafe që përdoren nga shqiptarë hyjnë e dalin pa ndonjë kontroll sigurie.

Një pjesë e drogës transportohet edhe nga ajri. Grupe afrikane kanë filluar këto kohët e fundit që të kalojnë drogë nëpërmjet aeroporteve turke.¹⁹⁵ Duke se grupe nga vende të Afrikës perëndimore paguajnë persona nga vendet e Ballkanit perëndimor

Grupet nga Ballkani perëndimor i kanë forcuar vazhdimisht pozitat e tyre në hierarkinë e krimit në Turqi



Policia turke kontrollon pako me heroinë që u kapën gjatë një operacioni të zhvilluar në dhejtor 2018.

© Kemal Ozdemir/Anadolu Agency nga Getty Images

si korrierë ajrorë për të transportuar bagazhe me heroinë dhe kokainë për në tregjet evropiane nëpërmjet Turqisë.¹⁹⁶

Ndonëse është e qartë se heroina është problemi kryesor, që nga vitet 90, Turqia po bëhet një treg gjithnjë e më i madh për ekstazi të prodhuar në Evropë, dhe një pjesë e saj trafikohet nga Ballkani perëndimor.¹⁹⁷ Grupet nga Kosova janë përfshirë në këtë trafik.¹⁹⁸ Po kështu ka të dhëna se disa shtetas të vendeve të Ballkanit perëndimor janë përfshirë në prodhimin e methamfetaminës në Turqi. Për shembull, kur sektori antidrogë i policisë në

Stamboll zbuloi një laborator methamfetamine në Beykoz, në vitin 2018, konfiskuan nëntë kilogramë methamfetaminë, 350,000 tableta ekstazi, dhe 1,100 kilogramë metilaminë (të sjellë nga Kina) që përdoret për prodhimin e methamfetaminës.¹⁹⁹ Kjo organizatë kriminale ndërkombëtare përbëhej nga shtetas nga Turqia, Uzbekistani, Irani, Britania, dhe Shqipëria. Po kështu, ka të dhëna se sasi të mëdha substancash psikoaktive (NPS)²⁰⁰ po hyjnë në Turqi. Nuk është akoma i qartë angazhimi i grupeve nga vendet e Ballkanit perëndimor në trafikun e këtyre substancave të reja.

Kanabis dhe super marihuana

Kanabisi është pa dyshim droga më e përhapur në tregun turk. Forcat e ruajtjes së rendit në Turqi konfiskuan 177.5 tonë kanabis në vitin 2017, dhe 80.7 tonë në 2018.²⁰¹ Edhe super marihuana (skunk), një lloj droge me bazë kanabis (e prodhuar në Shqipëri), është goxha e përhapur: 11 tonë nga kjo drogë u kapën në vitin 2018, një rritje prej 530 për qind krahasuar me një vit më parë.²⁰² Llogaritet se kërkesa për super marihanë do të vazhdojë të rritet në Turqi, veçanërisht në qytetet e mëdha.²⁰³

Trafikimi i kanabisit ndërmjet Turqisë dhe Ballkanit zakonisht kryhet më ngarkesa në sasi të mëdha, dhe autoritetet turke dhe ballkanike kanë konfiskuar një sërë ngarkesash me kanabis prej më shumë se një tonelatë secila. Nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e trafikantëve të kanabisit nga vendet e Ballkanit perëndimor, por mund të arrihet në përfundimin se shqiptarët janë përfshirë në trafikimin e kanabisit në Turqi. Së pari, shqiptarët sjellin sasi të mëdha kanabisi me mjete detare transporti në porte

turke në bregdetin e Egjeut. Kanabisi shpesh shkëmbehet për heroinë, që më pas transportohet duke u kthyer mbrapsht nëpër të njëjtin itinerar. Së dyti, një numër gjithnjë e më i madh shtetasish nga vendet e Ballkanit, kryesisht shqiptarë, janë përfshirë në trafikimin e super marihuanës.²⁰⁴ Autoritetet turke kanë konfiskuar sasi rekord të super marihuanës që nga viti 2016, dhe ekspertët mendojnë se një pjesë e madhe e super marihuanës furnizohet nga rrjete shqiptare.²⁰⁵

Në të vërtetë, disa grupe shqiptare e kanë kthyer Detin Adriatik në një autostradë detare për trafikun e drogës. Një nga trafikantët më famëkeqë është shqiptari Met Kenani, që transportonte sasi të mëdha drogash me mjete detare. Në mars 2018, një hetim i përbashkët midis forcave të policisë në Stamboll dhe Mugla solli konfiskimin e një sasive prej 1,100 kilogramësh super marihuanë në dy skafe luksoze. U arrestuan 13 persona, duke përfshirë edhe Kenanin.²⁰⁶ Ky ishte një nga shumë aksione gjatë një periudhe dyvjeçare që rezultuan me kapjen e sasive të mëdha drogash, që kishin lidhje me rrjetin e drejtuar nga Kenani. Në vitin 2017, autoritetet turke kapën 2.1 tonë kanabis, që thuhej se vinin nga i njëjti grup. Në vitin 2018, një gjykatë në Tiranë lëshoi urdhëra arresti për 18 pjesëtarët e një rrjeti që trafikonin drogë nëpër dy korridore: Turqi–Greqi–BE, dhe Turqi–Maqedoni–Shqipëri –BE.²⁰⁷ Më 26 Janar 2018, policia greke kapi 1,586 kilogramë kanabis dhe arrestoi nëntë shqiptarë dhe katër grekë që punonin për të njëjtën organizatë.²⁰⁸ Në mars 2018, sektori antidrogë i policisë së Stambollit bëri kontroll në një magazinë dhe arrestoi një shtetas turk me 24 kilogramë super marihuanë dhe 214 rrënjë kanabis.²⁰⁹ Policia tha se shtetasi turk punonte për Kenanin, që me sa duket kishte filluar të prodhonte kanabis dhe super marihuanë në disa pika në Turqi. Kjo tregon se grupet shqiptare jo vetëm që trafikojnë drogë në tregun turk, por kanë ngritur edhe pika për prodhimin e marihuanës në sera në këtë vend.

Arrestimi i Kenanit nuk e ndali dot rrjedhën e kanabisit. Në nëntor 2018, doganierët turq në kufirin me Greqinë kapën 1.5 tonë hashish në një kamion që transportonte sojë.²¹⁰ Tre persona u arrestuan, duke përfshirë edhe një shtetas shqiptar që i jepte kamionit. Në qershor 2019, sektori antidrogë i policisë së Stambollit goditi një rrjet ndërkombëtar të krimit të organizuar që trafikonte rregullisht super marihuanë nga Shqipëria në Turqi, dhe konfiskoi 525 kilogramë super marihuanë.²¹¹ Në tetor 2019, policia greke zhvilloi një hetim mbi një grup trafikantësh shqiptarë që trafikonin sasi të mëdha marihuane nga Shqipëria në Turqi, nëpërmjet Greqisë. Aksione të përbashkëta të policisë greke, Rojës Bregdetare, dhe Agjencisë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare (European Border and Coast Guard Agency – Frontex) rezultoi në kapjen e 1,172 kilogramëve opium të papërpunuar. Grupi shqiptar përdorte skafe për të dërguar kanabis në disa qytete në bregdetin turk. Nga hetimet doli se shqiptarët përdornin ishuj të pabanuar në Greqi për magazinimin e përkohshëm të drogës.²¹² Hetuesit thanë se grupi shqiptar e shkëmbente kanabisin për heroinë në Turqi, dhe transportonte heroinë duke u kthyer mbrapsht nëpër të njëjtin itinerar.

Trafikimi i emigrantëve

Deri tani, shumica e zonave problematike që përshkruhen në këtë raport janë përqenduar në përfshirjen e grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor në trafikun e drogës. Në rastin e Turqisë, që nga viti 2015, trafikimi i emigrantëve është kthyer në një aktivitet kriminal fitimprurës.

Në të kaluarën, ka patur emigrim të paligjshëm nga Ballkani perëndimor për në Turqi: gjatë periudhës 1995–2012 autoritetet turke identifikuan 4,676 emigrantë të paligjshëm nga Shqipëria, dhe 3,060 nga Jugosllavia.²¹³ Por që nga viti 2015 një numër shumë herë më i madh refugjatësh dhe emigrantësh kalojnë nga Turqia në Ballkanin perëndimor. Llogaritet se deri në mars 2020, rreth katër milionë refugjatë dhe emigrantë sirianë kanë hyrë në Turqi, dhe shumica e tyre dëshironin të kalonin në Bashkimin Evropian. Turqia u vu nën presion për të ulur rrjedhën e njerëzve drejt vendeve të BE-së dhe vendosi masa më të rrepta për kontrollin e kufijve. Kjo krijoi hapësira dhe mundësi për rrjetet e kontrabandës dhe trafikimit, duke përfshirë edhe disa grupe nga Ballkani perëndimor.²¹⁴

Shumica e grupeve të trafikimit të personave i kanë bazat në tre qytete në perëndim të Turqisë: Stamboll (21 për qind), Izmir (19 për qind) dhe Aydin (17 për qind).²¹⁵ Këto qytete janë pikat e koordinimit dhe transportit për operacionet e trafikimit të njerëzve nga toka dhe deti. Sipas informatave të mbledhura nga ky raport, emigrantët që vijnë nga Lindja e Mesme, Azia qendrore, dhe Azia jugperëndimore ndjekin gjashtë rrugë nga toka dhe nga deti për të arritur në Evropë. Tre nga këto korridore kalojnë nga vende të Ballkanit perëndimor:

- Turqi–Greqi–Shqipëri –Itali–Evropë perëndimore (korridor i vjetër)
- Turqi–Bullgari–Serbi–Bosnjë Hercegovinë –Slloveni–Austri–Evropë perëndimore (korridor i vjetër tokësor)
- Turqi–Greqi–Shqipëri –Mal i Zi–Bosnjë Hercegovinë–Kroaci–Slloveni (korridor i ri nga toka dhe deti)

Po kështu, ka të dhëna për ekzistencën e një korridori detar nga Turqia në Itali dhe Spanjë që mesa duket organizohet nga grupe shqiptare.²¹⁶ Rrjetet e trafikimit shqiptaro-turke përdorin jahte për të transportuar emigrantë në gjendje të mirë ekonomike nga Turqia për në Greqi dhe Itali. Vetëm një numër i vogël i këtyre mjeteve luksoze lundrimi janë kapur në korridoret detare në Detin Egje, në Mesdhe, dhe në Adriatik gjatë këtyre pesë viteve.

Kalimi i emigrantëve nëpër disa segmente të këtij korridori kryhet me ndihmën e trafikantëve nga vendet e Ballkanit perëndimor.²¹⁷ Për shembull, policia shqiptare njoftoi për shkatërrimin e një rrjeti që trafikonte shtetas turq, sirianë, dhe irakenë në Evropën perëndimore nëpërmjet Greqisë, Shqipërisë, Malit të Zi, dhe Kroacisë duke ecur nëpër zona malore në Ballkan. Ky rrjet drejtohej nga një shtetas turk që bashkëpunonte me shqiptarë.²¹⁸ Mesa duket ka edhe rrjete arabe që bashkëpunojnë me rrjete kriminale ballkanike për të organizuar komunikimin brenda vendit, transportin, dhe veprimtaritë e paligjshme jashtë kufirit turk.²¹⁹

Lidhjet midis rrjeteve të konsoliduara të trafikimit të drogës po përdoren tani për trafikim të qenieve njerëzore dhe trafikim të emigrantëve.²²⁰ Operacioni Limit nga policia shqiptare, që u zhvillua në bashkëpunim me Greqinë and Qendrën e Forcave të Ruajtjes së Rendit për Evropën Juglindore (Southeast European Law Enforcement Centre – SELEC), tregoi se grupe shqiptare të trafikimit të drogës “planifikojnë dhe organizojnë kalimin e paligjshëm të emigrantëve me origjinë nga Lindja e Mesme nga Greqia për në Shqipëri, dhe më pas drejt Malit të Zi”.²²¹ Policia shqiptare arrestoi 57 pjesëtarë të këtij rrjeti për trafikim të sasive të mëdha të narkotikëve dhe trafikim të qenieve njerëzore.

Në kufijtë perëndimorë të Turqisë, rrjete trafikantësh turq bashkëpunojnë me grupe arabe, shqiptare, greke, dhe bullgare për të kontaktuar me persona që specializohen

në falsifikim pasaportash, transport, përkthim, dhe interpretim të rregullave të imigracionit nga Moldavia, Iraku, Siria, Maroku, Shqipëria, Greqia, dhe Maqedonia e Veriut për transportimin e emigrantëve dhe refugjatëve në brendësi të Evropës.²²² Sipas një eksperti të intervistuar për këtë raport, emigrantëve u kërkohet që të paguajnë nga 3,000 deri në 8,000 euro për kalimin e tyre në zonën Schengen, por çmimi shkon deri në 30,000 dollarë për udhëtimin deri në SHBA dhe Kanada.

Trafikantët e refugjatëve shfrytëzojnë lehtësirat që krijohen nga sistemi tolerant i vizave dhe pasaportave midis Turqisë dhe vendeve të Ballkanit perëndimor, veçanërisht Bosnjë Hercegovinës. Që nga viti 2020, shtetas turq mund të udhëtojnë në Bosnjë thjesht me letërnjoftim. Shumë sirianë dhe irakenë sigurojnë letërnjoftime turke në mënyra të ligjshme dhe të paligjshme. Disa prej tyre kanë marrë edhe nënshtetësi turke falë politikave miqësore ndaj të huajve nga qeveria turke. Të tjerë blejnë letërnjoftime turke nga rrjete kriminale të specializuara në falsifikimin e dokumenteve.²²³ Një letërnjoftim mund të blihet në tregun e zi për 1,000 dollarë. Është vënë re se emigrantë me këto dokumente udhëtojnë drejt Bosnjës si turistë nga aeroporte të Stambollit, dhe nga Bosnja gjejnë kanale të tjera për të kaluar në Evropën perëndimore.²²⁴

Rrjete të konsoliduara të trafikimit të personave në Bosnjë organizojnë udhëtimin e mëtejshëm të këtyre emigrantëve. Në qershor 2019, policia e Elbasanit zhvilloi operacionin Tranzit kundër një rrjeti shqiptaro-turk për trafikimin e emigrantëve. Operacioni çoi në arrestimin e tetë pjesëtarëve të këtij grupi; shtatë prej tyre ishin shqiptarë dhe një turk. Ky grup ndihmonte emigrantët që të kalonin në mënyrë të paligjshme nga Turqia për në Greqi, dhe më pas drejt Shqipërisë dhe Malit të Zi.²²⁵

Trafikantët shqiptarë të qenieve njerëzore janë përfshirë edhe në trafikimin e emigrantëve nga Turqia dhe Lindja e Mesme drejt Italisë, Spanjës, dhe Britanisë. Në mars 2019, *karabinierët* arrestuan në Itali shtatë persona, duke përfshirë shtetas nga Italia, Shqipëria, Kolumbia, dhe Turqia, për trafikim personash në provincën e Modenas.²²⁶ Pjesëtari shqiptar i këtij rrjeti u akuzua edhe për mbajtje arme dhe drogë. Hetimet zbuluan se kjo organizatë kishte transportuar në mënyrë të paligjshme shtetas turq për në Itali dhe Evropë, në shkëmbim të 3,000 deri në 5,000 eurove për person. Hetuesit thanë se brenda një periudhe gjashtë mujore ky rrjet kishte transportuar në mënyrë të paligjshme 30 persona, kryesisht nga Turqia. Në gusht 2019, policia shqiptare arrestoi 19 shqiptarë dhe turq që po tentonin të udhëtonin nga Tirana për në Londër me letërnjoftime të vjedhura dhe dokumente të falsifikuara.²²⁷ Ky rrjet kishte kaluar në mënyrë të paligjshme në SHBA, Britani dhe Kanada shtetas turq me dokumente të falsifikuara.

Në përmbledhje, grupet nga Ballkani perëndimor – veçanërisht nga Kosova dhe Shqipëria – kanë ngjitur shkallët e hierarkisë në botën e krimit, si në Turqi ashtu dhe në marrëdhëniet e tyre me grupet turke që kanë lidhje me Ballkanin. Me zgjerimin e aktivitetit të tyre në Evropë rrjete kriminelësh shqipfolës arritën që të reduktonin hallkat ndërmjetëse në trafiket e paligjshme duke e blerë heroinën nga Turqia dhe duke e transportuar nëpërmjet rrjeteve të tyre të shpërndarjes në Britani, Gjermani, Spanjë dhe Hollandë. Këto kohët e fundit, grupe shqiptarësh kanë filluar të trafikojnë sasi të mëdha kanabisi dhe super marihuane për tregun e brendshëm turk nëpërmjet Adriatikut dhe Detit Egje. Po kështu, po zhvillohet edhe një treg i pasur për kontrabandën e cigareve, dhe grupet nga Ballkani perëndimor janë përfshirë në trafikimin e emigrantëve nga Turqia.

Trafikantët e qenieve njerëzore shfrytëzojnë lehtësirat që krijohen nga sistemi tolerant i emigracionit midis Turqisë dhe vendeve të Ballkanit perëndimor, veçanërisht me Bosnjë Hercegovinën.



AMERIKA LATINE



Amerika Latine është kthyer në një El Dorado për grupet kriminale nga Ballkani perëndimor. Ky kapitull tregon se si disa kriminelë të shkathët nga Ballkani perëndimor shkuan në atë rajon rreth viteve 2008–2009 për të hyrë në biznesin e kokainës. Gjatë kësaj dekade arritën që të ktheheshin në ndërmjetës të suksesshëm midis furnitorëve vendas dhe grupeve kriminale të konsoliduara, dhe tani së fundmi janë transformuar në faktorë kyç dhe shpërndarës të fuqishëm. Një vëmendje e veçantë i kushtohet Ekuadorit dhe Kolumbisë.


Në periudhën 2008–2020, Amerika Latine u kthye në një zonë problematike në lidhje me daljen në skenë të grupeve kriminale nga Ballkani. Ka disa arye pse ndodhi kjo. Së pari, prodhimi i kokës dhe kokainës është rritur dhe kërkesa mbetet e lartë anembanë botës, veçanërisht në tregjet e pasura evropiane, dhe në Australi. Së dyti, pati një çrregulim të ekuilibrave në furnizimin me kokainë në Kolumbi pas marrëveshjes së paqes në vitin 2016 me grupin rebel FARC (që kontrollonte territore të gjera ku kultivohej bima e kokës), dhe kjo krijoi mundësi për kriminelët nga Ballkani perëndimor që të krijonin lidhje me furnitorë të rinj. Së treti, trafikimi i drogës paraqet një rrezik relativisht të ulët në Amerikën Latine, si pasojë e korrupsionit të shfrenuar, hapësirave që lejon ligji, trazirave dhe paqëndrueshmërisë në disa shtete (si Venezuela), si dhe zyrtarë porti që bashkëpunojnë me trafikantët në të dy krahët e zinxhirit të trafikut. Si rezultat, disa kriminelë mendjemprehtë nga Shqipëria, Mali i Zi, dhe Serbia udhëtuan drejt vendeve prodhuese të kokainës për t'u përfshirë në furnizimin dhe shpërndarjen e drogës.

Zanafilla e grupeve të kokainës

Informacionet e para (të paktën nga materialet e bëra publike) në lidhje me bashkëpunimin midis mafias në Evropën lindore dhe karteleve kolumbiane doli në vitin 2001. Atë vit u arrestuan tre shqiptarë në kuadër të operacionit *Rrugëtimi* (Journey), që zgjati dy vjet, dhe u zhvillua nga DEA në bashkëpunim me vende të tjera për të goditur trafikimin me rrugë detare nga Kolumbia. Po atë vit u zbulua

- ◀ Një bujk në Bolivi punon për të tharë gjethet e sapokëputura të kokas. Në periudhën 2008 - 2020, Amerika Latine u bë zonë problematike në lidhje me aktivitetin e grupeve kriminale nga Ballkani, kryesisht si pasojë e rritjes së kërkesës për kokainë.

© Georg Ismar/Picture Alliance nga Getty Images



SLIKA 4 Trafikimi i kokainës nga Amerika Latine drejt Evropës perëndimore, Afrikës së Jugut dhe Australisë

edhe grupi i parë shqiptar që trafikonte kokainë. Policia arrestoi gjashtë pjesëtarë të një grupi, duke përfshirë dy persona që në atë kohë punonin në prokurorinë e përgjithshme në Tiranë. Operacioni Rrugëtimi konfirmoi se ky grup kishte patur kontakte me kartelin e Medellin në Kolumbi që nga viti 1999, dhe ishte pjesë e një rrjeti të trafikimit të kokainës të shpërndarë në të gjithë botën.²²⁸ Kjo lidhje mund të shpjegohet me faktin se mafia shqiptare ka lidhje të ngushta me mafian italiane, që ka lidhje të hershme me kartelet kolumbiane.

Por trafiku i vërtetë duket se ka nisur rreth periudhës 2008–2009, kur Darko Shariç u përfshi në trafikun e drogës nga Amerika Latine në Evropë. Shariç ra në sy për herë të parë në vitin 2009, kur policia në Uruguai konfiskoi një jaht me drogë, pas një informate të ardhur nga agjencitë antidrogë të SHBA-së dhe Serbisë. Jahti që do të shkonte në Evropë, u kap me dy tonë kokainë brenda, ndërsa lundronte në lumin La Plata, që ndan Uruguain me Argjentinën. Pas kësaj, 490 kilogramë kokainë – të paketuar në tullumbace shumëngjyreshe – u gjetën në një shtëpi në Buenos Aires, që kidhte lidhje me grupin e Shariçit.²²⁹ Me sa duket, Shariç kishte lidhje të forta me grupin kolumbian Los Rastrojos (kashta) që kryesohej nga Wilber ‘Sapun’ Varela, që u vra në Venezuelë në vitin 2008.²³⁰ Disa nga bashkëpunëtorët e Shariçit që u kapën nga policia treguan se rrjeti i ngritur nga Shariç trafikonte drogë nga Kolumbia, Uruguai dhe Brazili drejt Evropës lindore. Kjo ishte vetëm maja e ajsgutit të një biznesi të paligjshëm miliona dollarësh prej të cilit Shariç mori nofkën ‘Mbreti i Kokainës’.²³¹ Dy vjet më vonë, në prill 2011, policia konfiskoi një ngarkesë me dy tonë kokainë në Uruguai, që kishte mbërritur nga Kolumbia dhe kishte si destinacion Evropën. Një shetas serb u arrestua.

Në periudhën 2008–2009, kur Shariç po çante përpara në Amerikën Latine, shqiptari Arbër Çekaj vajti në Ekuador dhe hapi një kompani për tregtinë e bananave.²³² Doli se ishte një biznes aq i frytshëm, sa që brenda pak viteve Çekaj u bë trafikanti më i madh i drogës në Shqipëri, duke e fshehur drogën në ngarkesat me banane që i eksportonte në Evropë.²³³

Pse Amerika Latine është vend kaq tërheqës

Duke qenë se është burimi i një prej drogave më fitimprurëse – kokainës – është e natyrshme që Amerika Latine duket tërheqëse për grupet kriminale nga Ballkani. Kolumbia është prodhuesja më e madhe në botë e gjetheve të kokas, dhe eksportuesja kryesore e kokainës, e ndjekur nga Peruja dhe Bolivia. Sidoqoftë, kjo nuk është ndonjë gjë e re. Interesant është fakti se grupet nga Ballkani perëndimor u përfshinë në një aktivitet të dominuar prej kohësh nga grupet kolumbiane dhe italiane. Për të kuptuar më mirë si, kur, dhe pse disa vende të Amerikës Latine u kthyen në zona problematike të grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor ia vlen të analizojmë shtetin që Çekaj, dhe të tjerë, zgjodhën për të futur këmbët në atë kontinent, pra Ekuadorin.

Ekuadori

Në krimin e organizuar, ashtu si dhe në tregun e pasurive të paluajtëshme, vendndodhja është gjëja më kryesore. Ekuadori ndodhet midis Kolumbisë dhe Perusë, që prodhojnë rreth 90 për qind të kokainës në botë. Në periudhën 1996–2006, Ekuador konsiderohej si demokracia më e paqëndrueshme në Amerikën Latine. Kjo pasqyrohet edhe nga fakti se ky vend pati tetë presidentë të ndryshëm brenda një dekade, dhe tre prej tyre u hoqën nga posti me vendim parlamenti dhe nga protesta masive. Ka edhe faktorë të tjerë që e bëjnë Ekuadorin vend shumë tërheqës për grupet ndërkombëtare të krimit të organizuar, si kufij porozë, legjislacion i mangët, dhe procedura shumë të lehta për ndërrimin e identitetit dhe blerjen e dokumenteve false, si letërnjoftime dhe pasaporta.

Një tjetër faktor ishte edhe mbyllja në vitin 2009 e bazës ushtarake amerikane në qytetin bregdetar të Mantas.²³⁵ Për një dekadë me radhë, amerikanët kishin zhvilluar operacione antidrogë nga kjo bazë. Sipas ish-drejtorit të shërbimit informativ të ushtrisë

Shumë shpejt të tjerë filluan të ndjekin shembullin e Shariçit dhe Çekajt, pasi kapjet e ngarkesave me drogë nga policia, arrestimet, dhe artikujt e lajmeve tregojnë se ka një angazhim gjithnjë e më të madh të kriminelëve nga Ballkani perëndimor në trafikimin e kokainës nga Amerika Latine.²³⁴

ekuadoriane, mbyllja e bazës e bëri më të lehtë hyrjen e organizatave kriminale nga Ballkani, Lindja e Mesme, dhe Azia në Ekuador, dhe përdorimin e portit kryesor në Manta.²³⁶

Gjatë po kësaj periudhe, futja në kushtetutën e re të konceptit të shtetësisë universale (e amenduar në vitin 2008) i lejonte të huajt e çdo shtetësie që të vizitonte Ekuadorin deri në 90 ditë pa patur nevojë për vizë turistike: kjo periudhë mund të zgjatej për 90 ditë të tjera, duke i lejuar vizitorët që të qëndronin në mënyrë ligjore në Ekuador për gjashtë muaj me radhë.²³⁷ Për ata që qëndronin ilegalisht në Ekuador, gjoha maksimale ishte 800 dollarë amerikanë. Të gjitha këto elemente e bënë Ekuadorin një vend shumë mikpritës për kriminelët ‘turistë’ nga Ballkani (dhe zona të tjera).

Disa burime që u kontaktuan për këtë raport përmendën nivelin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë penale si një nga faktorët kryesorë për infiltrimin e grupeve të huaja kriminale në vend. Dhe me të vërtetë, të paktën në dy raste gjyqësore që kishin të bënin me kriminelë nga Ballkani Perëndimor, trafikantët përfituan ulje dënimi apo nuk u dënuan fare. Për shembull, në vitin 2014, tetë ekuadorianë, dy shqiptarë, dhe një kosovar u kapën në kuadër të operacionit Ballkani dhe u akuzuan për magazinimin e sasive të mëdha drogash në Guayaquil, për t'i trafikuar në Evropë, por megjithë natyrën serioze të këtyre akuzave, kosovari Remzi Azemi u lirua një muaj pas arrestimit të tij. Në nëntor 2018, një shqiptar dhe një grek u arrestuan në një aksion antidrogë në bregdetin ekuadorian dhe u akuzuan për trafik droge, së bashku me gjashtë ekuadorianë. Kur çështja shkoi në gjykatë, gjykata e shkallës së parë dënoi ekuadorianët por lëshoi të lirë shtetasit e huaj.²³⁸ Edhe në Kolumbi duket se situata është e ngjashme. Kolumbia ka një nga nivelet më të



Kjo kokainë e fshehur në kuti bananesh të importuara nga Kolumbia u konfiskua në Berlin, në janar 2014. Arbër Çekaj u bë trafikanti më i madh i drogës në Shqipëri, duke përdorur ngarkesa me banane për të fshehur drogën. © Odd Andersen/AFP nga Getty Images

larta të pandëshkueshmërisë gjyqësore në Amerikën Latine (është në vendin e pestë në klasifikimin e Transparency International për nivelin e pandëshkueshmërisë). Sipas degës së kësaj organizate për Kolumbinë, për çdo 100 krime që kryhen në këtë vend, vetëm gjashtë dënohen (me fjalë të tjera niveli i pandëshkueshmërisë është 94 për qind). Kjo do të thotë se Kolumbia është një bazë e sigurtë për kriminelët.

Një element tjetër që e bën Ekuadorin vend shumë tërheqës për krimin e organizuar është dollari amerikan. Në vitin 2000, pas një krize financiare, Ekuadori vendosi të ndërrojë monedhën e vendit me dollarin amerikan. Si pasojë e kësaj reforme, Ekuadori ka monedhë të fortë, por ka nivel të ulët të përdorimit të sistemit bankar nga publiku i gjerë. Për shembull, në vitin 2018, 48.1 për qind e ekuadorianëve nuk përdorte ndonjë shërbim financiar, sipas një studimi të bankës qendrore të Ekuadorit. Me fjalë të tjera, një sasi e madhe parash ngelet jashtë sistemit bankar zyrtar, dhe kjo e bën më të vështirë që të evidentohen shkëmbimet financiare dhe rrjedha e fondeve, dhe lehtëson pastrimin e parave të pista (për shembull, nëpërmjet biznesit të ndërtimit dhe pronave të paluajtëshme). Për më tepër, Ekuadori nuk ka ligje për konfiskimin e pasurive të trafikantëve të drogës. Si rezultat, ashtu si thotë edhe një burim nga policia, “kriminelët bëjnë dy-tre vjet burg, dhe pastaj dalin jashtë e shijojnë paratë e tyre”.

Ndërsa grupet e huaja kriminale filluan të hynin në Ekuador, shteti kishte pak mundësi që t'i identifikonte dhe të parandalonte aktivitetet e tyre. Sipas një oficeri madhor të shërbimit informativ të Ekuadorit, vëmendja kryesore e qeverisë së Rafael Correa (2007–2017) ishin mbledhja e informatave ndaj kundërshtarëve politikë, dhe jo kriminelëve. Gjithashtu, ky vend u përqendrua më shumë tek bashkëpunimi me SHBA në luftën kundër krimit të organizuar (me një marrëveshjeje të rinovuar në vitin 2019), dhe jo tek bashkëpunimi i gjerë ndërkombëtar, asistenca ligjore reciproke,


dhe shkëmbimi i të dhënave informative. Këtë problem nuk e ka vetëm Ekuadori. Për shembull, Kolumbia nuk ka marrëveshje ekstradimi me asnjë nga gjashtë vendet e Ballkanit perëndimor.²³⁹

Forcat e ruajtjes së rendit i kanë duart e lidhura, edhe ngaqë Ekuadori është një nga të paktët vende në botë që nuk mban një bazë të dhënash me shenjat e gishtave dhe fotografitë e vizitorëve. Kjo e bën shumë të vështirë gjurmimin e pasaportave, sidomos kur kriminelët përdorin më shumë se një emër të rremë. Mungesa e njohjes së gjuhëve Ballkanike dhe natyrës së këtyre grupeve kriminale është një tjetër pengesë. Ndërkohë që thuhet se shumë nga kriminelët serbë dhe shqiptarë që veprojnë në Amerikën Latine e flasin rrjedhshëm spanjishten, shumë pak nga forcat policore kanë ekspertë për gjuhët apo kriminalitetin nga Ballkani.²⁴⁰

Nga ana tjetër, duket se policët nuk janë të vetmit që kanë vështirësi në identifikimin e kombësisë të personave nga Ballkani. Me sa duket, edhe trafikantët kolumbianë të drogës shpesh i referohen kolegëve të tyre nga Evropa lindore si 'Rusë'.²⁴¹ Një nga kriminelët më famëkeqë nga Ballkani, Miro Niemeier Rizvanovic, njëhej si 'El Ruso' (Rusi), megjithëse ishte me origjinë boshnjake dhe gjermane.

Në vendin e duhur dhe në kohën e duhur

Pas depërtimit në tregun e Amerikës Latine në fillim të viteve 2000, kriminelët nga Ballkani patën fatin që të gjendeshin në vendin e duhur dhe në kohën e duhur, gjatë një periudhe tranzicioni në tregun e kokainës. Një nga faktorët kryesorë ishte procesi i paqes në Kolumbi. Gjatë negociatave ndërmjet qeverisë kolumbiane FARC në periudhën 2012–2016, zona e mbjellë me bimën e kokas filloi të rritej ndjeshëm, pas një periudhe kur ishin arritur nivelet më të ulëta të kultivimit, pas një ofensive çrrenjosjeje nga ushtria (shiko Figurën 5). Sipas organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi drogën dhe krimin (UNODC),



FIGURË 5 Hektarë të kultivuar me koka në Kolumbi, 2008–2019

BURIMI: Organizata e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin (UNODC), Kolumbia: Monitorimi i territoreve të prekura nga të lashtat e paligjshme (Monitoreo de territorios afectados por cultivos ilícitos) 2018, gusht 2019, f 22, https://www.unodc.org/documents/crop-monitoring/Colombia/Censo_cultivos_coca_2018.pdf.

numri i hektarëve të mbjellë me koka u rrit më shumë se katër herë gjatë periudhës 2013–2019, nga 50,000 hektarë në vitin 2013, në 212,000 hektarë në vitin 2019.²⁴² Llogaritet se prodhimi potencial i kokainës së pastër arriti deri në 951 tonë.²⁴³ Kjo erdhi si pasojë e zbutjes së ofensivës antidrogë; shkuljes me dorë të bimëve, pasi spërkatja nga ajri u ndalua me urdhër të gjykatës kushtetuese në vitin 2015; dhe shtimit të mbjelljes së bimës së kokas me shpresën e programeve për shkëmbimin vullnetar të të mbjellave, që do t'i sillte fshatarëve fitime monetare.

Në vitin 2017, pas nënshkrimit të marrëveshjes së paqes, FARC filloi të tërhiqej nga territoret që mbante nën kontroll. Kjo krijoi një vakum pushteti që filloi të mbushej nga aktorë të tjerë kriminalë, që deshën të shtinin në dorë një biznes fitimprurës që tanimë ishte pa zot. Ndërmjet këtyre aktorëve të rinj kishte banda kriminale, disidentë të FARC që ishin kundër marrëveshjes së paqes, grupe nga njësi të vogla guerrilesh marksiste, si Ushtria Çlirimtare Kombëtare (ELN), apo 'narko' krahu i Ushtrisë Popullore Çlirimtare (EPL), që gati ishte zhdukur fare.

Në të njëjtën kohë, kokaina që kishte ngelur në depo që nga fillimi i negociatave të paqes filloi të vërshonte në treg. Si pasojë e sasive të mëdha të kokainës, kartelet kolumbiane dhe grupet braziliane si Komanda e Parë Kapitale (First Capital Command – PCC) po kërkonin për tregje të reja dhe partnerë të rinj.²⁴⁴ Grupet nga Ballkani perëndimor ishin në pozitë të mirë për të hyrë në treg.

Roli i grupeve nga vendet e Ballkanit perëndimor

Autoritetet kanë identifikuar të paktën katër grupe nga Ballkani Perëndimor që kanë lidhje me kartelet kolumbiane

Ashtu si u shpjegua edhe në kapitullin mbi Evropën perëndimore, nga fillimi i viteve 2000, grupet kriminale serbe dhe shqiptare kishin krijuar lidhje të ngushta me grupet mafioze italiane, që ishin shpërndarësit kryesorë të kokainës kolumbiane në Evropën perëndimore. Ata i përdorën këto kontakte për të luajtur rolin e ndërmjetësit midis furnizuesve në Amerikën Latine dhe shpërndarësve në Evropë. Në fakt, në disa raste ata ngjiten shkallët e krimit dhe u kthyen në shpërndarës. Disa trafikantë serbë dhe malazezë (si Darko Shariç) duket se u munduan që të eliminonin komplet edhe hallkat e ndërmjetme duke bërë transportimin e drogës me anije apo avionë të vegjël nga Amerika Latine në Evropë, madje edhe në Afrikë.

Pas fragmentarizimit të karteleve kolumbiane në vitet 90, ndërmjetësit që mund të lidhnin prodhuesit në Amerikën Latine me konsumatorët evropianë, dhe që kishin aftësi të koordinonin dërgesa droge prej disa tonelatash, u bënë faktorë shumë të rëndësishëm në botën e krimit.²⁴⁵ Elementë me prirje për biznes nga Ballkani perëndimor nxituan që të luanin këtë rol, pasi e panë se jashtë rajonit të tyre ofroheshin mundësi të mëdha. Të gjendur nën presionin e forcave të ruajtjes së rendit në vendet e tyre, ata vendosën që të transferonin aktivitetet e tyre në Evropën perëndimore, pasi kishin zotësinë, zgjuarsinë, dhe guximin për t'i hyrë asaj rruge. Një shembull tipik, që ilustron këtë valë të re kriminelësh biznesmenë është 'El Ruso', që thuhet se krijoi një marrëdhënie të ngushtë pune me Dairo Antonio Usuga (që njihej edhe me nofkën Otoniel – *Bosi i madh*), kreu i Klanit të Gjirit, organizata më e madhe e trafikimit të drogës në Kolumbi. Ai koordinonte transportin e ngarkesave me drogë me rrugë detare nga Kolumbia dhe Brazili drejt Evropës dhe Azisë.²⁴⁶ Ai ndihmoi në krijimin e kontakteve midis karteleve kolumbiane dhe mafieve shqiptare, kosovare dhe kalabreze.²⁴⁷

Që nga viti 2008, shqiptarët vajtën në Amerikën Latine si emisarët e grupeve mafioze italiane si 'Ndrangheta dhe Kamorra, dhe si përfaqësues të grupeve mafioze nga vende të tjera evropiane, si Greqia dhe Spanja. Ata duket se kanë krijuar lidhjet e tyre edhe me mafiet turke dhe marokene për shpërndarjen e narkotikëve në Evropë. Sipas një burimi, roli i tyre fokusohet mbi shpërndarjen e brendshme të drogës, veçanërisht në shërbim të mafieve italiane dhe spanjolle, që kanë lidhje më të hershme me kartelet kolumbiane.

Sipas burimeve policore në Ekuador dhe Kolumbi, këta emisarë zakonisht shkojnë në Amerikën Latine "me një mision të porositur dhe të drejtuar nga persona në destinacionet e drogave në Evropë". Ata zakonisht hiqen si biznesmenë dhe turistë, dhe flasin shumë mirë spanjisht, gjë që natyrisht i ndihmon shumë në krijimin e kontakteve me grupet kriminale vendase. Detyrë e emisarëve është krijimi i kontakteve, negociatat për pazaret e drogës (duke përfshirë edhe çmimin), organizimi i transportit, dhe dërgesa e drogave. Sa më shumë pazare të bëjnë, aq më i gjerë bëhet rrjeti i kontakteve. Në të njëjtën kohë (nëse i gjithë procesi shkon mirë), ata bëhen më të vlefshëm për krerët e organizatës në vendin e origjinës, ngaqë janë kthyer në sytë dhe veshët e bosëve të tyre në Evropë. Nuk është akoma e qartë se si është ndikuar puna e emisarëve nga Ballkani perëndimor nga kriza e COVID-19, megjithëse kuptohet se kufizimet i bëjnë më të vështira udhëtimet vajtje-ardhje, dhe lëvizjen e parave. Ndonëse transporti i kokainës përmes Atlantikut vazhdon, izolimet dhe karantina duket se ka krijuar bllokime dhe mbingarkesë në skemën e shpërndarjes në Evropë, si dhe probleme në kryerjen e pagesave për dërgesat e kokainës.²⁴⁸

Në Kolumbi, raportohet se emisarët takohen me mafiozë vendas në qytete si Pereira, Medellín, Cali, Pasto, dhe Cúcuta. Policia ka identifikuar disa raste ku ndërmjetës nga vende të Ballkanit perëndimor kanë udhëtuar në zonat ku prodhohet kokaina në Kolumbi, si Tibú, në krahinën e Norte de Santander (në kufirin me Venezuelën), që kontrollohet nga ELN, apo në Tumaco, që ndodhet në krahinën Narino (pranë kufirit me Ekuadorin) ku janë të pranishëm një sërë grupesh të armatosura, dhe midis tyre ka edhe fraksione të ngelura nga FARC. Në një incident, në prill 2020, një serb – Dejan Stanimirovic (që njihet edhe si 'Marcos') – vdiq në rrethana misterioze ndërsa ishte në shoqërinë e ish-komandantit paraushtarak, Jose Vicente Rivera Mendoza, që njihet edhe si Soldado (Ushtari), në Guamal, Kolumbi.²⁴⁹ Ai ishte një emër i njohur për disa forca policore në Evropën perëndimore, që e mbanin nën vëzhgim për gati një dekadë, me dyshimin se merrej me koordinimin e dërgesave të drogës nga Amerika Latine për në Evropë.²⁵⁰

Në Ekuador, krahinat e Guayaquil dhe El Oro duket se janë pikat kryesore të takimit. Në Peru, raportohet se një grup serb ka krijuar lidhje direkte me klane familjare që prodhojnë kokainë në luginat e lumenjve Apurimec, Ene dhe Mataro, dhe më pas e transportojnë në Lima, dhe në bredret.²⁵¹ Ashtu si u përmend edhe në kapitullin mbi Hollandën, klani Tito dhe Dino mendohet se ka qenë i përfshirë në trafikimin e drogës nga Peruja.

Policia ka vënë re se lëvizjet e emisarëve ndjekin një rutinë të caktuar: ata qëndrojnë nga tetë ditë deri në një muaj; udhëtojnë zakonisht në grupe me tre persona, shpesh me shtetas spanjollë ose italianë (që kanë patur kontakte më të hershme në terren, dhe e kuptojnë më mirë spanjishten); dhe mbajnë shpesh dokumente të rreme. Udhëtimi në grupe me tre veta bëhet për qëllime praktike: kur negociohet për pazaret e kokainës, kartelet vendase shpesh kërkojnë që një person nga organizata porositëse të qëndrojë në Kolumbi, që të verifikojë cilësinë e ngarkesës, por edhe që të shërbejë si garanci që blerësi do të paguajë të gjithë shumën e rënë dakord pasi të dorëzohet ngarkesa.

Ndonëse transporti i kokainës përmes Atlantikut vazhdon, izolimet dhe karantina krijuan bllokime dhe mbingarkesë në skemën e shpërndarjes në Evropë

GRUPET

Nganjëherë thuhet se në Amerikën Latine ka një 'kartel ballkanik'. Ky lloj portretizimi i një organizmi njëbllokësh nuk është i saktë, pasi bëhet fjalë më shumë për një sërë grupesh nga Ballkani perëndimor (veçanërisht nga Shqipëria, Mali i Zi, dhe Serbia) të përfshirë në trafikimin e kokainës nga Amerika Latine. Nganjëherë punojnë me njëri-tjetrin, herë pas here duket se kanë edhe mosmarrëveshje midis tyre, por zakonisht veprojnë pa rënë në sy dhe në mënyrë efektive.

Grupa Amerika

Grupa Amerika (që e nisi aktivitetin në rrugët e Beogradit në vitet 90) duket se specializohet në shërbime logjistike dhe transportimin e kokainës (dhe heroinës) nga Kolumbia për në Amerikën e Veriut dhe Evropë. Grupi drejtohej nga Mile Miljaniç, dhe zëvendësi i tij Zoran Jakshiç. Në qershor 2016, Jakshiç u arrestua në Peru me akuzën e trafikimit të drogës nga Amerika

Grupi Shariç

Grupi Shariç e mori emrin nga drejtuesi i tij Darko Shariç, që u dënua në vitin 2018 me 15 vite burg nga një gjykatë serbe.²⁵⁵²⁵⁶ Shariç (që ra në sy në vitin 2009 gjatë operacionit Luftëtari i Ballkanit që konfiskoi 2.7 tonë kokainë në Uruguai) duket se ishte një nga kriminelët e parë me peshë nga Ballkani perëndimor që arritën të krijonin lidhje në Amerikën Latine. Ky grup ishte përgjegjës për transportimin e sasive të mëdha (me tonelata) kokaine nga Amerika Latine në Evropë, nëpërmjet Ballkanit. Sipas policisë serbe, Shariç organizonte dy dërgesa me kokainë në vit, dhe ishte në gjendje që t'i paguante organizatat kriminale kolumbiane

Grupi i Sreten Jociç

Grupi Sreten Jociç e ka marrë emrin nga bosi i këtij rrjeti, një personazh i njohur i mafias serbe, që njihet edhe si Joca Amsterdam. Grupi vepron në Ballkanin perëndimor, Hollandë, Bullgari, Austri, Turqi, dhe Gjermani. Raportohet se ky grup është përgjegjës për organizimin e ngarkesave të mëdha me kokainë nga Kolumbia nëpërmjet Karaiibeve, dhe veçanërisht Arubas.

Gjatë dekadës së fundit, autoritetet kanë identifikuar prezencën e të paktën katër grupeve apo celulave nga Ballkani Perëndimor – shpesh me lidhje familjare apo nga e njëjta qytezë në vendin mëmë – që kanë lidhje me kartelet kolumbiane dhe merren me trafikimin e kokainës nga Kolumbia. Nuk është e qartë nëse të gjitha këto grupe veprojnë akoma, pasi dy nga këto grupe kanë humbur bosët e tyre.

e Jugut në Evropë. Hetuesit thanë se kishin prova se Jakshiç krijoi një strukturë kriminale për të siguruar kokainë në Peru and Ekuador.²⁵² Në janar 2019, pjesëtari i Grupa Amerika, Smail Shikalo (nga Bosnja), u arrestua në kuadër të një operacioni që konfiskoi 1.5 tonë kokainë.²⁵³ Në prill 2019, një anëtar i rëndësishëm i klanit Amerika, Veselin Raicevic, u arrestua në Beograd.²⁵⁴

me para në dorë për disa toneleta kokainë.²⁵⁷ Duket se ka edhe një lidhje me grupin PCC në Brazil. Në gusht dhe shtator 2016 u kapën dy ngarkesa të mëdha me drogë në portin e Santosit, dhe një nga personat e përfshirë ishte një serb me emrin Bozhidar Kapetanović (që njihet edhe me nofkën 'Xhudo'), që sipas policisë braziliane dyshohej se ishte pjesëtar i grupit Shariç. Ndihmësi i tij Miroslav Jevtić – një serb që njihet me nofkën Felipe – u arrestua nga autoritetet braziliane për trafik droge dhe dyshime për përfshirje në pastrim parash, duke përdorur Bitcoin.²⁵⁸ Në vitin 2019, ai u dënua me 17 vite burg.

Duket se ka krijuar lidhje të ngushta me grupe shqiptare në Evropën perëndimore. Sipas një informate, grupi Jociç bashkëpunon direkt në Kolumbi me prodhuesit dhe furnitorët kolumbianë të kokainës, për të trafikuar drogë në porte evropiane nëpërmjet disa korridoreve, duke përfshirë edhe ishujt Kanarie.²⁵⁹ Raportohet se Jociç ka udhëtuar në Kolumbi në vitin 1996. Sipas një analize:

“Ndonëse Jociç ushtron kontroll strategjik mbi grupin, aktivitetet në terren, duke përfshirë edhe operacionet për trafikun e drogës nga Kolumbia, mbikqyren nga anëtarë të grupit të një niveli më të ulët, dhe një rrjet i

Klani Berane

Ky grup është përfshirë kryesisht në trafikun e drogës, veçanërisht trafikimit të kokainës nga vende të Amerikës së Jugut, si Venezuela dhe Kolumbia, sipas të njëjtit burim të përmendur më lart.²⁶¹ Ka shumë pak informacion në lidhje me këtë grup, dhe nuk dihet mirë

Grupe shqiptare dhe malazeze

Ashtu si u përmend edhe më lart (shiko shënimin 235), një sërë grupesh shqiptare të kimit të organizuar janë përfshirë në trafikimin e kokainës nga Amerika Latine në Evropë. Këto grupe luajnë rolin e hallkës lidhëse ndërmjet karteleve të Amerikës Latine dhe grupeve mafioze italiane, dhe – ashtu si u përmend edhe në rastin e Mbretërisë së Bashkuar dhe vendeve të Beneluksit – po përfshihen gjithnjë e më shumë në shitje me pakicë. Grupet shqiptare më të suksesshme kanë akumuluar deri më sot rreth një dekadë eksperiencë dhe kontakte. Zakonisht ato përbëhen nga 15 deri në 20 anëtarë, janë fleksibël, përshtaten shpejt, kanë lidhje të forta politike, mbështetje të fortë financiare, dhe kanë reputacion të mirë kriminal për sigurimin e mallrave me cilësi të lartë dhe çmime të favorshme. Këto grupe veprojnë në mënyrë pak a shumë autonome, por mund të bashkërendojnë aktivitetet e tyre në rrjete më të gjera kriminale kur shihet e përshtatshme. Grupet shqiptare që veprojnë në Amerikën Latine konsiderohen më të sofistikuara se ato që operojnë vetëm brenda territorit shqiptar, apo që kanë lidhje vetëm me ndonjë grup kriminal në vendet fqinje.²⁶³

Kur fasim për rolin e luajtur nga grupet e Ballkanit perëndimor, ia vlen të përmendim faktin se marinarë nga Mali i Zi duket se luajnë një rol tepër të madh në formimin e ekuipazheve të anijeve të përfshira në trafikun e drogës. Llogaritet se 7,000 marinarë malazezë punojnë për kompani detare ndërkombëtare. Punësimi në kompanitë e transportit detar është një

gjerë celulash të mirë-organizuara”.²⁶⁰ Duket se kjo ka ndikuar që grupi të jetë rezistent, pasi aktivitetet e tyre vazhduan edhe pasi Jociç u arrestua në prill 2009 dhe u shpall fajtor në lidhje me dy vrasje të porositura.

niveli i aktiviteve të tyre. Disa nga anëtarët kryesorë të këtij klani u paditën në Malin e Zi në vitin 2004 për trafikimin e 200 kilogramëve kokainë nga Venezuela në Serbi, nëpërmjet portit italian në Gioia Tauro, dhe portit të Tivarit në Malin e Zi.²⁶²

perspektivë e pëlqyeshme për malazezët duke patur parasysh situatën e vështirë social-ekonomikë në atë vend. Ndonëse këto vende pune kanë rroga të mira, disa marinarë malazezë tundohen nga ideja e fitimit të një shume të barabartë me një vit rrogë për një udhëtim të vetëm, duke ndhmuar grupet kriminale në trafikimin e kokainës.²⁶⁴ Në shkurt 2020, disa marinarë malazezë u arrestuan kur pesë tonë kokainë u konfiskuan në një anije pranë Arubas. Katër marinarë malazezë u arrestuan në Filadelfia në Qershor 2019 për përfshirje në trafikimin e gati 20 tonëve kokainë nga Amerika Latine. Në vitin 2015, pesë marinarë malazezë u arrestuan pas organizimit të transportit të një ngarkese me kokainë që u hodh në det nga një anije pranë brigjeve spanjolle dhe u mblodh nga jahte. Një vit më pas, një malazez që punonte në një anije mallrash u dënua me gjashtë vite burg, pasi kishte hedhur në det 261 kilogramë kokainë, që u mblodh nga peshkatarë pranë bregdetit hollandez. Po kështu, në mars 2020, një anëtar malazez i ekuipazhit të një anijeje u arrestua në lidhje me 500 kilogramë kokainë që u kap në një anije hambar malazeze (*bulk carrier* me emrin *Budva*) në Hamburg, që ishte nisur nga porti brazilian i Santosit, me një ndalesë në Kazablanka.²⁶⁵ Ashtu si u përshkrua më lart edhe në kapitullin mbi Afrikën e Jugut, marinarë malazezë janë arrestuar edhe për trafikimin e kokainës me jahte.²⁶⁶ Përveç kësaj, në prill 2019, u raportua se 50 kilogramë kokainë u gjetën në një anije stërvitore të marinës malazeze të ankoruar në portin e Tivatit.²⁶⁷

Disa nga këta emisarë shkojnë e vijnë në këtë rajon, dhe shpesh përdorin dy apo më shumë identitete për të hyrë në një vend. Sipas një oficeri të shërbimeve informative të policisë: “Kur vijnë këtu nuk prekin asnjë gram kokainë me dorë, ata vetëm se krijojnë kontakte për të saktësuar detajet e pazarit.”²⁶⁸ Pak a shumë të njëjtën gjë tha edhe një nga prokurorët kryesorë në prokurorinë e përgjithshme (Fiscalía General de la Nación) i specializuar në luftën kundër drogës: “Ata vijnë pa para me vete, dhe largohen pa drogë me vete. Është e pamundur t’i kapësh në flagrancë.”²⁶⁹

Pavarësisht kësaj, disa nga emisarët (për shembull, në Ekuador) duket se kalojnë shumë kohë në atë vend, dhe bëjnë një jetë luksoze. Një prokuror tha për median ekuadoriane se shqiptarët e përfshirë në trafikun e drogës hiqen si biznesmenë, frekuentojnë hotele dhe bare të shtrenjta, kalojnë shumë kohë në palestër, dhe zotërojnë mallra luksi që nuk i justifikojnë dot se nga vijnë. Kur marrin apartamente me qera, zakonisht zgjedhin lagje private me roje dhe shërbime sigurie. Paratë u vijnë nëpërmjet transfertave bankare dhe kanë shuma të mëdha nëpër duar. Zakonisht nuk blejnë pasuri të paluajtëshme në ato vende, por marrin me qera shtëpi të mbrojtura mirë, në lagje të pasura.²⁷⁰

Gjatë dekadës së fundit, grupet nga Ballkani janë integruar në skenën kriminale vendase në Ekuador, veçanërisht në qytetet Guayaquil, dhe Machala, ku magazinohen drogat dhe nisen për trafikim. Gjithashtu duket se kanë marrë statusin e eprorit në marrëdhëniet e partneritetit me kolegët e tyre vendas. Nga ana tjetër, duket se ka edhe partneritete midis mafieve shqiptare dhe ekuadoriane, që e trafikojnë kokainën së bashku, dhe më pas ndajnë fitimet. Kriminelët nga Ballkani perëndimor i paguajnë ekuadorianët që të zbatojnë urdhërat e tyre, dhe të kryejnë detyra të ndryshme që kërkon ky lloj biznesi i paligjshëm, si ruajtja e ngarkesës, transportimi i konteinerëve, dhe fshehja e drogës në konteinerë me dijeninë e zyrtarëve të portit. Duket se janë në gjendje t’i shpëtojnë burgut, gjë që tregon se nuk i përlyejnë duart, ose kanë burime të mjaftueshme parash për të korrupuar zyrtarë me ryshfete të mëdha.

Mëgjithëse këta emisarë janë anëtarë të nivelit të mesëm në grupet kriminale në vendin e origjinës, kur arrijnë në Ekuador ata bëhen krerët e grupit kriminal në vendin ku transplatohen. Sidoqoftë, duket se mbahen në kontakt të vazhdueshëm me rrjetet kriminale në Ballkanin perëndimor, dhe me diasporën në Evropën perëndimore, dhe gjithnjë e më shumë këto komunikime kryhen nëpërmjet telefonëve të koduar. Në vitin 2014, në momentin kur u arrestua Dritan Rexhepi, një person i rrezikshëm që kërkohet nga INTERPOL në tre shtete evropiane, ai u mundua të thyente telefonin duke e pëplasur në tokë.

Korridoret dhe mënyrat e trafikimit

Shumica e kokainës që transportohet nga Amerika Latine në Evropë kryhet me konteinerë të ngarkuar në anije të mëdha. Në fakt, 90 për qind e kokainës që hyn në Evropë vjen në konteinerë të ngarkuara në anijë të mëdha tregtare që ankorohen në porte si Anversa, Algeciras, Le Havre, Rotterdam, dhe Hamburg.²⁷¹ Ngarkesat me kokainë zakonisht fshihen në konteinerë me fruta të freskëta (veçanërisht banane), si dhe në ngarkesa me tul frutash të ngirë nga Kolumbia dhe Ekuadori.²⁷² Pakot e drogës duket se mbështillen me karbon që të mos diktohen. Ngaqë këto lloj ngarkesash janë mallra që mund të prishen dhe është e nevojshme që të kalohen shpejt, i nështrohen më pak kontroleve në portet e hyrjes.



Nganjëherë drogat fshihen në konteinerë që në fermat ku mblidhet prodhimi bujqësor, ndonjëherë rrugës për në port, dhe herë të tjera në territorin e portit. Duket se metoda që përdoret më dendur është heqja e vulave të sigurisë që vendosen në konteinerë të ngarkuar me mallra të ligjshme, dhe futen droga brenda. Kur ngarkesa arrin në destinacion, bashkëpunëtorët njoftohen për numrin serial të konteinerit me kokainë, drogat hiqen që aty dhe vendosin vula false në derë për të maskuar hapjen e konteinerit.²⁷³ Vetë fakti se kjo gjë është e mundur tregon se ka nivele të larta korrupsioni në mes të personelit që ruan portet, si në dalje ashtu dhe në hyrje. Mesa duket, një shofer kamioni (në Guayaquil) mund të fitojë deri në 10,000 dollarë për të devijuar një konteiner, ndërsa një punonjës porti që punon me makineri pirun (për shembull në Anversë) mund të fitojë nga 25,000 deri në 75,000 euro nëse sasia e drogës shkarkohet pa u diktuar.²⁷⁴ Prokurorët thonë se kartelet mund t'i ofrojnë doganierëve nga 500,000 deri në një milion dollarë për të kaluar ngarkesat pa u kontrolluar.

Bazuar në të dhënat mbi sasinë e drogës të kapur, duket se sasia e kokainës që hyn në Evropë është goxha e madhe. Në fakt, sasia e kokainës të kapur në Evropë arrin në shifra rekord. Në vitin 2017, pati 104,000 konfiskime (shumica e tyre ishte në sasi të vogla) për një total prej 140.4 tonë. Sasia e kokainës së kapur ishte 20 tonë më shumë se rekordi historik i vitit 2006, dhe dyfishi i sasisë së konfiskuar një vit më parë. Sipas një raporti të BE-së, pjesa më e madhe e kokainës që u konfiskua në Evropë

Hamburg: doganierë po inspektojnë një anije për transport konteinerësh; 90 për qind e kokainës që hyn në Evropë arrin me anije të tilla; vetëm 2 për qind e konteinerëve kontrollohen nga autoritetet. © Christian Charisius/ Picture Alliance nga Getty Images

gjatë vitit 2017 u kap në pesë shtete: në Belgjikë (44,752 kilogramë), e ndjekur nga Spanja (40,960 kilogramë); Franca (17,500 kilogramë); Holanda (14,629 kilogramë); dhe Britania (5,697 kilogramë).²⁷⁵ Dallgët kanë nxjerë drogë në breg në Detin e Zi. Dy serbë u arrestuan në mars 2019, pasi gati një ton kokainë u zbulua në një anije të abandonuar, dhe në pako të shpërndara në bregdetin rumun.²⁷⁶ Pastërtia e kokainës që hyn në vendet e BE-së ka arritur nivelin më të lartë në 10 vjet.²⁷⁷ Për shembull, u raportua se kokaina që doli në breg në Rumani kishte një nivel pastërtie prej më shumë se 90 për qind.²⁷⁸

Sipas një raporti të vitit 2011 nga UNODC, Venezuela është “vendi kryesor për nisjen e ngarkesave me kokainë direkt për në Evropë,” ndërsa shumica e drogës është prodhuar në Kolumbi. Gjatë periudhës 2006 -2008, më shumë se gjysma e ngarkesave me drogë të nisura për në Evropë, që u kapën në Atlantik, ishin nisur nga Venezuela. Nuk ka shumë informacion mbi aktivitetet e grupeve nga vende të Ballkanit perëndimor në Venezuela. Një nga informacionet e pakta në këtë drejtim erdhi këto kohët e fundit, me kapjen e pesë tonëve kokainë në një anije pranë Arubas, në Karaibe, në shkurt 2020. Anija ishte nisur nga Surinami, kishte ndalur në portin e Guaranaos në Venezuelë, dhe ishte nisur për në Selanik. Disa pjesëtarë ekuipazhi malazezë u arrestuan për trafik droge.²⁷⁹

Një sasi e konsiderueshme droge po vjen direkt nga Kolumbia. Në të kaluarën shumica e saj shkonte në SHBA, por një burim nga shërbimet informative të policisë kolumbiane thotë se 60 për qind e kokainës që del nga Kolumbia shkon në Evropë. Nga ana tjetër, gati 70 për qind e kokainës që hyn në Evropë trafikohet nga rrjete të lidhura me grupe kriminale nga Ballkani perëndimor, sipas të njëjtit burim.²⁸⁰ Sidoqoftë, kjo shifër duhet të merret me rezervë.

Grupet kriminale nga Ballkani mendohet se janë përfshirë edhe në trafikun e drogës në portin Callao, në Peru. Grupe të mafias serbe thuhet se bashkëpunojnë me organizata kriminale vendase (*chhalaco*) për të trafikuar drogë në anije mallrash për në Evropë.²⁸¹ Këto grupe vendase, që kanë marë nofkën ‘ninxhat’ nga shkathtësia e tyre, hidhen mbi kamionë dhe anije për të fshehur kokainë në ngarkesat me verë, arra, apo perime. Në vitin 2019, u raportua se drogat ishin ngarkuar në një anije (MSC *Gayane*) kur ishte në det, pas nisjes nga një port peruan. Oficeri i anijes i ngarkuar me kursin e udhëtimit (*second mate*), Ivan Durasevic nga Mali i Zi, i tha hetuesve se ishte ngarkuar nga zëvendës-kapiteni i anijes që të ndihmonte të paktën dy pjesëtarë të ekuipazhit dhe katër persona me maska që të ngarkonin pako me kokainë në bordin e *Gayane*, nga disa anije më të vogla që u afruan pak pasi u nisën nga porti në Peru.²⁸² Në fund të udhëtimit ai do të paguhej 50,000 dollarë në kriptomonedha.²⁸³ Kur anija, që ishte




FIGURA 6 Drogat e kapura në Ekuador që kishin si destinacion Belgjikën, 2014–2020

BURIMI: Raportime nga mediat vendase, dhe faqja e internetit e policisë kombëtare të Ekuadorit

nisur për në Rotterdam, u kontrollua në Filadelfia në qershor, policia gjeti gati 20 tonë kokainë (që vlen më shumë se një miliardë dollarë). Ky operacion renditet në vend të dytë për sasinë e drogës të konfiskuar në historinë e SHBA-së.²⁸⁴

Ashtu si u përmend më lart në lidhje me grupin Shariç, ka edhe një lidhje midis grupeve kriminale nga vendet e Ballkanit perëndimor dhe Komandës së Parë Kapitale (Primeiro Comando da Capital – PCC) në trafikimin e kokainës nga porti brazilian në Santos drejt Evropës perëndimore, duke përfshirë porte në Evropën veriore, si dhe Gioia Tauro, një nga portet më të mëdha në Mesdhe që njihet për ndikimin e grupit mafioz Ndrangheta.

Uruguai duket se po përdoret gjithnjë e më shumë si pikë për nisjen e ngarkesave me drogë. Në vitin 2019, numri i konfiskimeve të drogës në vend u dyfishua në krahasim me një vit më parë. Pati të paktën tre konfiskime të sasive të mëdha të kokainës në anije që ishin nisur nga Uruguai, apo që kishin bërë një ndalesë në atë vend, ndërsa në vitin 2019 u kap një sasi e madhe droge në një avion privat që ishte nisur nga Montevideo.²⁸⁵

Korridorin nga Ekuadori për në Evropë, veçanërisht për në Belgjikë, duket se përdoret shpesh nga trafikantët (shiko Figurën 6). Sipas një analisti, grupet kriminale që veprojnë në Ekuador preferojnë portin e Anversës

ngaqë ka tarifa të ulëta dhe transporti i mëtejshëm është më i lehtë. Dhe me të vërtetë, nga një shqyrtim i destinacioneve të ngarkesave me kokainë të kapura në portet ekuadoriane del se shumica e tyre do të shkonte në Anversë, porti i dytë për nga madhësia në Evropë. Më 8 janar 2020, autoritetet belge raportuan se gjatë vitit 2019 në Anversë ishte kapur një sasi rekord drogash, gati 62 tonë kokainë. Nga Ekuadori ishte nisur 17 për qind e kësaj sasive (10.5 tonë), dhe ministria e financave të Belgjikës e konsideron Ekuadorin si një tre eksportuesit më të mëdhenj të kokainës në Anversë, bashkë me Kolumbinë dhe Brazilin.²⁸⁶ Sipas një lajmi të botuar nga agjencia AFP, drejtori i përgjithshëm i portit të Anversës Kristian Vanderwaeren tha për radio televizionin publik VRT se “doganat belge mund të kontrollojnë vetëm një apo dy për qind të miliona kontainerëve që arrijnë në portin flamand”.²⁸⁷

Ekuadori ka tetë porte kryesore, dhe njëri prej tyre, Guayaquil, duket se është një zonë problematike në lidhje me grupet nga Ballkani perëndimor. Për shembull, në kuadër të operacionit Ballkani, në qershor 2014, në Guayaquil u arrestuan 11 persona, duke përfshirë ekuadorianë, shqiptarë dhe kosovarë. Hetimet zbuluan se kjo bandë e kishte bazën në atë qytet, nga ku organizonin dërgimin e ngarkesave me drogë për në Evropë. Në një rast tjetër, në maj 2019, një grup i drejtuar nga shqiptarë u arrestua në krahinën bregdetare të El Oro. Që aty, grupi kriminal dërgonte




FIGURA 7 Sasia e drogës së kapur në portet ekuadoriane (në tonelata), 2016–2019

BURIMI: Drejtoria Kombëtare e Policisë Antinarkotikë e Ekuadorit

SHËNIM: Të dhënat jepen deri për periudhën 25 shtator 2019



Disa trafikantë ballkanikë preferojnë të përdorin jahte për trafikimin e drogës. Në këtë fotografi tregohet një jaht i ngarkuar me kokainë që është ndalur nga autoritetet në afërsi të bregdetit irlandez. © Niall Carson/PA Images nga Getty Images

drogë duke e fshehur në ngarkesa me prodhime bujqësore. Sipas një eksperti të çështjeve të sigurisë, Ekuadori nuk ka skanera nëpër porte. Si rezultat, vetëm një për qind e konteinerëve kontrollohen në mënyrë të rastësishme nga policia me qen të stërvitur.²⁸⁸ Mungesa e kontrolleve përkeqësohet edhe nga nivelet e larta të korrupsionit në porte.²⁸⁹

Gjatë periudhës 2016–2019, policia bllokoi gati 63 tonë drogë në portet ekuadoriane (shiko Figurën 7). Po ta krahasosh me sasinë që mendohet se kalon nëpër këto porte, kjo shifër ka mundësi të jetë më pak se 10 për qind e kokainës që niset drejt Evropës, ku një gram nga kjo drogë blihet 20 fish më shtrenjtë se në Ekuador.²⁹⁰

Metoda të tjera të trafikimit të drogës

Drogat transportohen edhe me mënyra të tjera. Sasi të vogla dërgohen me persona që luajnë rolin e korrierit, dhe udhëtojnë me avionë linjash drejt Evropës, për shembull nga aeroportet në Guayaquil, apo në Quito. Një metodë relativisht e re është marrja e avionëve me qera (charter flights), apo të ashtuquajturit 'avionët e drogës' (narco-jets).²⁹¹ Për shembull, në prill 2018, dy shqiptarë u arrestuan pasi 1,000 kilogramë kokainë dhe më shumë se 1.5 milionë dollarë u zbuluan në një fluturim çarter nga Kolumbia në Madrid.²⁹² Në qershor 2019, Michael Dokovich, një shtetas i Malit të Zi me origjinë shqiptare, u arrestua pasi 600 kilogramë kokainë u kapën në një avion privat Gulfstream në Bazel, Zvicër që vinte nga Uruguai (me një ndalesë në Nisë).²⁹³ Ndihmësi i tij, Pero 'Pjer' Sharac (Šarac) u arrestua pasi vajti tre herë në Amerikën e Jugut në vitin 2018, dhe mendohet se gjatë këtyre vizitave organizonte dërgimin e ngarkesave me kokainë.²⁹⁴ Operacioni Familia, që u organizua nga DEA dhe EUROPOL, solli arrestimin e 16 personave. Është interesant fakti se pesë nga arrestimet u kryen në Azi. Mendohet se trafikantë nga Ballkani organizojnë dhe koordinojnë trafikimin në rrugë detare të ngarkesave shumë-kilogramëshe me kokainë, kryesisht në Hong Kong dhe Macao.²⁹⁵

Disa trafikantë ballkanikë duket se preferojnë të përdorin jahte.²⁹⁶ Një grek dhe një shqiptar u arrestuan in Guayaquil në vitin 2018, ndërsa mundoheshin të trafiknin drogë në Evropë dhe Australi me një anije me vela. Darko Shariç gjithashtu përdorte jahte, dhe përdorimi i këtyre mjeteve lundimi u përmend edhe në rastet e analizuara në kapitujt mbi Afrikën e Jugut dhe Turqinë. Një numër personash nga Ballkani perëndimor (veçanërisht serbë) janë arrestuar vitet e fundit duke trafikuar kokainë me jahte (që njihen edhe si *narcoveletero*, apo *narko-jahtet*) nga Amerika Latine në Evropë, duke kaluar nga ishujt Azore, apo edhe nga ishujt Kanarie. Për shembull, në maj 2015, katër serbë u arrestuan në ishujt Azore pasi në anijen e tyre u gjetën 1,150 kilogramë kokainë.²⁹⁷ Në qershor 2019, 797 kilogramë kokainë u konfiskuan pranë ishujve Azore në një anije që duket se ishte marrë me qera nga një grup kriminal serb.²⁹⁸ Po kështu, duket se, që nga viti 2018, Australia ka filluar të bëhet destinacion për trafikimin e kokainës nga Ekuadori.

Nganjëherë thuhet se në Amerikën Latine vepron një kartel ballkanik. Ky është një portretizim tepër i ngurtë i situatës

Një model i suksesshëm biznesi

Shkurtimisht, gjatë dekadës së fundit, Amerika Latine është kthyer në një zonë problematike në lidhje me përfshirjen e grupeve nga Ballkani perëndimor në trafikun e drogës. Nga informatat e mbledhura së fundmi duket se kjo tendencë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Për shembull, sipas një burimi të afërt me strukturat anti-drogë në Ekuador, 160 shqiptarë hynë në atë vend gjatë vitit 2018, dhe 20 prej tyre mund të kenë qenë trafikantët droge, ndërsa një burim nga policia kolumbiane tha se kanë vënë re një "rritje të pajustificuar" në hyrjen e shtetasve shqiptarë në Kolumbi. Nga ana tjetër, së shpejti mund të ndryshojnë edhe pikat e hyrjes: në janar 2020 Shqipëria dhe Guyana (në kufi me Brazilin dhe Venezuelën) nënshkruan një marrëveshje për heqjen e vizave.²⁹⁹

Kërkesa dhe oferta për kokainë mbetet e lartë, ndonëse edhe sasia e konfiskuar vazhdon të rritet. Nuk është e qartë nëse kjo vjen nga puna më e efektshme e forcave të ruajtjes së rendit apo është thjesht një pasqyrim i rritjes së sasisë së drogës në qarkullim. Pikat e dobëta dhe mangësitë që shfrytëzohen nga grupet kriminale nga vendet e Ballkanit perëndimor në Amerikën Latine duket se nuk do të zhduken edhe aq shpejt, dhe po kështu edhe volumi i trafikut të konteinerëve drejt Evropës perëndimore ka shumë pak gjasa që të bjerë (edhe në kushtet e pandemisë COVID-19).

Nuk ka dyshim se grupet kriminale nga Ballkani perëndimor kanë fituar reputacion si partnerë të efektshëm dhe të besueshëm. Përveç kësaj këto grupe dinë të përballen me frikën. Të gjitha këto i kanë ndihmuar në krijimin e marrëdhënieve të mira me furnizuesit në Amerikën Latine, si dhe të fitojnë pozita më të forta në rrjetet e shpërndarjes, duke përdorur edhe porte në Evropën perëndimore, ku kanë bashkëpunëtorët e tyre. Duke qenë në gjendje që të blejnë direkt nga burimi në Amerikën Latine, dhe të shesin direkt tek blerësit në Evropën perëndimore, kanë mundësi që të kontrollojnë të gjithë zinxhirin e trafikut. Kjo i ka lejuar që të rrisin pastërtinë e produktit, të ulin çmimet, dhe të kontrollojnë tregun. Për shembull, raportohet se grupet shqiptare në Britani ishin në gjendje që të blenin kokainë nga kartelet kolumbiane për 4,000 deri në 5,500 paund britanikë për kilogram, ndërsa rivalët e tyre kujtonin se po bënin pazar me leverdi kur blenin kokainë nga trafikantët hollandezë për 22,500 paund për kilogram.³⁰⁰ Po kështu, janë edhe oportunistë, duke kërkuar vazhdimisht për partnerë të rinj, korridore dhe tregje të reja; mënyra të reja transporti; si dhe metoda inovative për pastrimin e parave (duke përfshirë edhe kriptomonedhat). Shkurtimisht, duket se kanë gjetur një model të suksesshëm biznesi.



AUSTRALIA

TENTAKULAT ZGJATEN DERI
POSHTË NË JUG



Australia ka konsumin më të lartë të kokainës për banor në botë. Është një treg i pasur. Gjatë këtyre viteve të fundit, është regjistruar një rritje e ndjeshme në trafikun e drogës nga Amerika Latine nëpër ishujt e Paqësorit deri në Australi.³⁰¹ Ka të dhëna mbi persona nga Ballkani që janë përfshirë në trafikun e drogës në atë rajon, ashtu si doli edhe nga konfiskimi i një sasive të madhe kokaine në Zelandën e Re në vitin 2017.³⁰² Duke patur parasysh përvojat dhe aktivitetet e grupeve nga vende të Ballkanit perëndimor në zona të tjera të botës, nuk është ndonjë çudi e madhe që ky korridor të përdoret prej tyre.

Sipas një burimi nga policia australiane, “aktualisht, krimi i organizuar ballkanik është kërcënimi më i madh për Australinë, është kaq i disiplinuar, kaq i ndërthurur dhe me influencë në komunitetet vendase, dhe paraqet një sfidë serioze për forcat e rendit.”³⁰³ Sidoqoftë, sipas një eksperti në Komisionin Informativ mbi Krimin në Australi (Criminal Intelligence Commission), ndonëse ka një prezencë të vogël të krimit të organizuar nga vende të Ballkanit perëndimor, “grupe të tjera etnike dhe jo etnike kanë një prezencë më të madhe në Australi”.³⁰⁴

Ashtu si dhe zona të tjera problematike nëpër botë, grupet kriminale nga Ballkani perëndimor në Australi duket se kanë evoluar nga diaspora që emigroi nga Jugosllavia në vitet 80, dhe në fillim të viteve 90. Mendohet se pjesëtarë të klanit të Zemunit u strehuan në Australi për njëfarë kohe, përpara dhe pas operacionit Shpata.

Një grup i madh kriminal në Australi duket se drejtohet nga shqiptari i Malit të Zi Vaso Ulic (që ka nënshtetsi të dyfishtë nga Australia dhe Mali i Zi). Në pikun e vet, ky grup raportohet të ketë trafikuar gjashtë tonë drogë në vit në Australi, Afrikën e Jugut, dhe Kinë. Ashtu si kriminelë të tjerë nga vendet e Ballkanit perëndimor në zona të tjera të botës, Ulic e nisi karrierën si kriminel i vogël në lagjen me drita të kuqe në Sidnei, që njihej edhe si *milja e artë* (*golden mile*). Brenda 20 vjetësh ai u kthye në bosin e trafikimit të drogës në Australi (njihej edhe si Eskobari Malazez), duke krijuar edhe lidhje të ngushta me faktorët kryesorë në botën e krimit në Australi. Ulic u largua

◀ Kreu i grupit serb të Hells Angels, dhe ish-pjesëtar i grupit të motoçiklistëve Bandido, Zeljko Mitroviç, u vra nga kimisti që i përgatiste methamfetaminën, në Sidnei në vitin 2013.
© Getty Images

*'Krimi i organizuar
ballkanik është
kthyer në rrezikun
më të madh për
Australinë'.*

nga Australia në vitin 2005, kur policia australiane kërkoi ta merrte në pyetje në lidhje me nëntë vrasje me porosi që nuk ishin zbardhur akoma, dhe kapjen e një sasive të madhe me drogë. Mendohet se Ulic vazhdonte të kishte influencë në Malin e Zi. Ai u arrestua në gusht 2017 nën akuzën se nga qershori 2007 deri në maj 2008 kishte drejtuar një organizatë kriminale që kishte trafikuar 60 kilogramë methamfetaminë nga vende të tjera në Australi. U lirua në vitin 2019.

Edhe pjesëtarë të komunitetit serb në Australi janë elementë të rëndësishëm në mesin e bandave të motoçiklistëve (apo *bikie*) në këtë vend. Besohet se disa nga anëtarët e bandës së motoçiklistëve *Balkan Bandidos* e kanë njohur njëri-tjetrin që kur ishin fëmijë në mbrëmjet që zhvilloheshin tek kisha ortodokse serbe në lagjet e tyre. Në fakt, djali i një ish-prifti është një nga krerët e bandës *Bandidos*.

Po kështu, një nga krerët e grupit australian të bandës së motoçiklistëve *Hell's Angels* (Engjëjt e Ferrit), Zeljko Mitrovic, është me origjinë serbe. Në vitin 2013, ai u vra nga ish-kimisti që përgatiste methamfetaminë për grupin e tij – dhe prehet në varrezën e një kisha ortodokse serbe. Në vitin 2014, Senad Catic (i lindur në Bosnjë, ish-anëtar i grupit *Bandidos*, që ka patur disa probleme me ligjin) u arrestua me akuzën e drejtimit të një organizate që trafikonte methamfetaminë me vlerë prej disa milionë dollarë, dhe mendohet se paratë e fituara mund të jenë pastruar nëpërmjet konvertimit në Bitcoin. Një tjetër ish-pjesëtar i grupit *Bandidos*, Bogdan Cuic, u ekstradua nga Serbia në Australi në vitin 2016 për t'iu përgjigjur akuzave për një vrasje që kishte lidhje me pazaret e drogës. Me gjithë faktin se nuk ka marrëveshje ekstradimi ndërmjet Australisë dhe Serbisë, policia australiane e vlerësoi lart bashkëpunimin që pati me autoritetet serbe.³⁰⁵

Gjatë periudhës shtator 2011 dhe prill 2012, tre persona me origjinë nga Ballkani u vranë në lagjet periferike në jug të Wollongong. Që të tre mendohet se ishin të përfshirë në trafikun e drogës.³⁰⁶ Dy nga këto tre viktima (Saso Ristevski dhe Goran Nikolovski) e njihnin njëri-tjetrin, dhe ishin dënuar më parë me burg, pasi policia i kishte kapur së bashku me një sasi të madhe kokaine, në vitin 2004.³⁰⁷

Edhe kriminelët shqipfolës kanë goxha nam në tregun australian të drogës. Një shembull në këtë drejtim është Daniel Kalaja, babai i të cilit emigroi nga Shqipëria në Australi në vitet 70. Kalaja ngjiti shkallët e krimit që nga shpërndarës marihuane në Melburn deri tek drejtimi i një perandorie të drogave sintetike në zonën australiane të Bregut të Artë (Gold Coast).³⁰⁸ Ai ishte një nga figurat kryesore të krimit deri sa u arrestua në vitin 2010. Në vitin 2012, policia australiane dëboi nga vendi shqiptarin Leonard Gjeka, që thuhej se ushtronte dhunë për llogari të bandave të motoçiklistëve në zonën jugore të Australisë.³⁰⁹



**MAFIA
BALLKANIKE
ËSHTË VËNË
NË LËVIZJE**



Përpara përfundimit, ia vlen që të analizojnë raportin midis zonave të ndryshme problematike që u analizuan në këtë raport dhe Ballkanit perëndimor.

Një nga elementet kryesore në këtë vëzhgim është fakti se nuk ka ndonjë pikë koordinimi të aktiviteteve të grupeve të ndryshme kriminale nga Ballkanit perëndimor që zhvillojnë aktivitetin jashtë këtij rajoni. Nuk ka atdhe të krimit në Ballkanin perëndimor, dhe po kështu nuk ka ndonjë bos të madh nga rajoni që organizon aktivitetet e grupeve të ndryshme nga vendet e Ballkanit perëndimor. Sidoqoftë, historia e këtij rajoni dhe kushtet social-ekonomike kanë ndikuar në eksportimin e aktiviteteve kriminale. Ballkani ka ekonomi politike të paqëndrueshme, dhe në disa raste ka patur edhe qeverisje kriminale, dhe ky lloj sistemi krijon një situatë pasigurie, që shtyn individë të ndryshëm që të kërkojnë apo të ofrojnë mbrojtje, të krijojnë rrjete, dhe të pastrojnë para të pista.

Një nga lidhjet kryesore midis zonave problematike në botë dhe Ballkanin perëndimor është logjistika. Rajoni gjendet në kryqëzimin e korridoreve të rëndësishme të trafikeve, si për shembull, për trafikimin e heroinës përgjatë korridorit ballkanik, dhe madje është edhe epiqendra e trafikimit të emigrantëve. Që nga viti 2010, rajoni është kthyer në një nyje të rëndësishme për trafikimin e kokainës. Gjatë dekadës së kaluar, ka patur një numër konfiskimesh të ngarkesave me drogë në portet shqiptare dhe malazeze, si Durrësi dhe Tivari, gjë që tregon se këto porte po përdoren si pika për shkarkimin e sasive të mëdha të kokainës që vijnë me anije nga Amerika Latine, dhe që më pas dërgohet në tregjet kryesore, në Itali dhe vende të tjera të Evropës.

Një tjetër faktor i rëndësishëm është pastrimi i të ardhurave të krimit në këtë rajon. Duket se kjo ka patur një ndikim të madh në industrinë e ndërtimit dhe pasurive të paluajtëshme – duke sjellë rritjen e çmimeve ndërkohë që të ardhurat nuk shtohen. Metoda të tjera të përdorura gjerësisht për pastrimin e parave të pista janë investimet në turizëm, lojëra fati, call centre, agjenci të shkëmbimit të parave, dhe dërgime parash nga emigrantët në vendin mëmë. Kjo është një çështje që ka

◀ **Budva, Mal i Zi. Përgjatë dekadës së fundit, ka pasur disa sekuestrime droge në porte të ndryshme të detit Adriatik në Ballkan.** © *Velveteye për Shutterstock*

nevojë për studime të mëtejshme, dhe do të analizohet nga GI-TOC në një raport që do të vijë më pas.

Disa grupe transportojnë sasi të mëdha parash në vendet e tyre të origjinës, duke i fshehur në ndarje dhe dysheme të dyfishta në vetura, dhe makina pak më të mëdha. Ka të dhëna se disa nga grupet më të sofistikuar po i pastrojnë fitimet e tyre direkt në Evropën perëndimore, në parajsë financiare, apo me anë të konvertimit në kriptomonedha. Megjithëse vendet e Ballkanit perëndimor kanë miratuar ligje kundër pastrimit të parave dhe kalimit të fitimeve të paligjshme, për të arritur standardet evropiane, realiteti në terren duket se është goxha ndryshe. Do të jetë me interes që të shihet ndikimi i këtyre parave mbi ekonominë – sidomos në Ballkanin perëndimor – nëse do të ketë ndonjë krizë likuiditeti, si rezultat i pandemisë COVID-19.

Sipas këtij raporti, është e vështirë të gjykohet në lidhje me ndikimin e zonave problematike nëpër botë mbi ekonominë politike të Ballkanit perëndimor. Nga ana tjetër, është e qartë se ekosistemi i korrupsionit, pandëshkueshmëria politike, dhe sistemi i dobët i drejtësisë penale në vendet e Ballkanit perëndimor krijojnë një strehë që mbron disa nga figurat kryesore. Nga ana tjetër, disa nga këto figura mund të bëhen të padëshirueshme për disa udhëheqës politikë. Për këtë arsye, disa persona të intervistuar për këtë raport thanë se nganjëherë është më e lehtë dhe më e sigurtë për grupin kriminal që të zhvillojë aktivitetin e tij jashtë Ballkanit perëndimor, ku nuk i duhet të shqetësohen në lidhje me kontrollin dhe mbështetjen e autoriteteve vendore, apo konkurrencë me grupe kriminale krahinore. Mund të duket si kundër-intuitive, por ka raste kur ombrella e mbrojtjes politike, që u identifikua si element shumë i rëndësishëm në lidhje me zonat problematike të krimit të organizuar në Ballkanin perëndimor, mund të krijojë probleme për grupet që kanë patur sukses në vende të huaja.³¹⁰

Pavarësisht se sa të ngushta, apo sa të dëshiruara, janë lidhjet midis grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor që veprojnë jashtë vendit dhe figurave kryesore në vendet e origjinës, reputacioni i vendeve të Ballkanit perëndimor vuan nga aktivitetet e grupeve kriminale në zonat problematike nëpër botë. Shumë nga klisjet apo stereotipet që iu veshën këtij rajoni në vitet 90 vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, pjesërisht si pasojë e aktivitetit të grupeve kriminale ballkanike jashtë rajonit. Në fakt, problemet që shkaktojnë kriminelët nga vendet e Ballkanit perëndimor në disa vende, si Holanda, janë përdorur si argumente kundër zgjerimit të BE-së.

Është e vështirë të gjykohet se sa kohë kalojnë kriminelët nga rajoni në zonat problematike nëpër botë dhe sa kohë shpenzojnë në Ballkanin perëndimor. Në disa nga rastet e marra në shqyrtim, duket se ndërmjetësit e niveleve të larta shkojnë e vijnë nga zonat e aktivitetit në vendet e origjinës. Nga ana tjetër, disa nga ndihmësit kryesorë të krerëve të grupeve kriminale lëvizin më pak dhe janë më të integruar në komunitetet ku veprojnë, ndërsa në raste të tjera, si në Amerikën Latine, udhëtojnë në rajone të ndryshme si emisarë. Ka të dhëna edhe për shtimin e kriminalitetit sezonal, ku anëtarët e grupeve udhëtojnë drejt një vendi për të kryer ndonjë detyrë të caktuar, dhe më pas kthehen sërish në vendin e tyre.³¹¹

Disa nga kriminelët më të suksesshëm nga Ballkani (si Darko Shariç) arritën të shfrytëzojnë rrjetet ekzistuese në 'Jugosferën'³¹² e Ballkanit perëndimor, dhe i kombinuan këto lidhje me hapësirat dhe mundësitë që ofronin zona të ndryshme nëpër botë. Një shembull tjetër është Naser Kelmendi, një shqiptar i Kosovës me

*Disa nga kriminelët
më të suksesshëm
nga Ballkani arritën
të shfrytëzojnë
rrjetet ekzistuese
në 'Jugosferën' e
Ballkanit perëndimor,
dhe i kombinuan këto
lidhje me hapësirat
dhe mundësitë që
ofronin zona të
ndryshme nëpër botë*

nënshitet boshnjake. Organizata e drejtuar nga Kelmendi besohet se ka qenë e përfshirë në trafikun e drogës (veçanërisht heroinë), kontrabandën e cigareve, pastrimin e parave të pista, dhe para me fajde me interesa shumë të larta. Bërthama e grupit kriminal Kelmendi përbëhet nga pjesëtarë të familjes dhe fisit (djem, kushërinj, dhe të njohur të tjerë). Besohet se kjo organizatë ka goxha influencë në Kosovë, Bosnjë Hercegovinë, në Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Kroaci, Serbi, Gjermani dhe në SHBA.³¹³ Kelmendi u përball në një gjykatë rrethi në Kosovë me disa akuza për përfshirje në aktivitete kriminale (duke përfshirë edhe vrasje me paramendim), por në vitin 2018 u dënua vetëm me gjashtë vite burg për trafik droge.³¹⁴

Kriminelët që zhvillojnë aktivitete të paligjshme nëpër botë zakonisht preferojnë të kthehen në vendet e tyre në Ballkanin perëndimor. Është vënë re se disa nga Panterat Rozë ktheheshin në Ballkanin perëndimor në periudhën ndërmjet grabitjeve të ndryshme, por e njëjta gjë mund të thuhet edhe për vrasësit me pagesë që udhëtojnë nga Ballkani perëndimor për të kryer vrasje dhe pastaj kthehen sërish në vendin e tyre. Ashtu si pasqyrohet edhe nga ky raport, ka edhe raste kur kriminelët kthehen në atdhe për t'iu fshehur forcave të ruajtjes së rendit në zonat problematike ku veprojnë, për të eliminuar rivalët e tyre, dhe për t'i shpëtuar problemeve me drejtësinë në vende të tjera. Krejt ndryshe nga sa thotë Varese, disa kriminelë që kanë patur sukses në zonat problematike jashtë rajonit, janë kthyer dhe janë transplantuar në Ballkanin perëndimor. Natyrisht që shtetet e Ballkanit perëndimor duhet të bëjnë më shumë për të penguar kriminelët e kërkuar nga drejtësia që të shkojnë e vijnë pa problem.


Po kështu, ekziston rreziku që grupet nga Ballkani perëndimor që veprojnë në zonat problematike nëpër botë mund të sjellin më vete në vendet e origjinës problemet dhe eskperiencën kriminale që kanë akumuluar jashtë vendit, bashkë me fitimet e paligjshme. Për shembull, partnerët e tyre në vendet e huaja mund të kenë interes që të çajnë në tregun e Ballkanit – dhe kjo situatë mund të shkaktojë tërheqjen e një investimi të huaj të gabuar, dhe që kryhet nga persona të padëshiruar.

Gjithashtu, nëse paratë e pista pastrohen në Ballkanin perëndimor duke hapur biznese që nuk kontrollohen sa duhet nga shteti (si, turizmi, kazinotë, dhe industria e zbavitjes), kjo mund të krijojë një situatë ku elementë të tjerë kriminale marrin shembull dhe përfshihen në aktivitete të ngjashme. Kjo mund të shërbejë edhe si një lloj magneti për grupet kriminale nga Asia, Lindja e Mesme, Turqia, apo Rusia. Po kështu mund të tërhiqen edhe investitorë të dyshimtë nga jashtë që duan të përfitojnë nga mangësitë në legjislacion dhe masat e dobëta rregullatore – si në rastin e Republikës Çeke në fillimet e viteve 90. Në vijim, ia vlen të shtrohet pyetja se mos ndoshta ekziston rreziku që interneti të kthehet në një zonë problematike (virtuale) e krimit të organizuar nga Ballkani perëndimor.³¹⁵

Si përfundim, ndërkohë që disa grupe kriminale kanë përfitur nga konflikti në Lindjen e Mesme, nëpërmjet trafikimit të armëve dhe emigrantëve, kjo situatë ka patur gjithashtu një efekt bumerang, ngaqë ka ngjallur pakënaqësi në popull si pasojë e rritjes së numrit të emigrantëve, dhe shqetësimeve në lidhje me kthimin e luftëtarëve të huaj, dhe radikalizimin. Në të ardhmen, është e rëndësishme që të analizohet jo vetëm përhapja e krimit të organizuar nga Ballkani perëndimor nëpër botë, por edhe nëse (dhe si) grupet e krimit të organizuar nga jashtë mund të depërtojnë në Ballkanin perëndimor.



PËRFUNDIME



Ky raport ka për qëllim që të identifikojë vendndodhjen e zonave problematike në lidhje me aktivitetin e grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor. Raporti analizoi raste të veçanta nga Amerika Latine, Evropa perëndimore, Turqia, Afrika e Jugut, dhe analizoi në mënyrë të përgjithshme Australinë.

Ka disa ngjashmëri midis zonave problematike, por edhe ndryshime të rëndësishme. Shumë nga zonat problematike kanë njëfarë lidhjeje me pasojat e ngjarjeve dramatike që ndodhën në Jugosllavi dhe Shqipëri në vitet 90, por zona të tjera kanë të bëjnë me zhvillime më të vonshme, dhe mundësi të krijuara nga ndryshime politike dhe globalizimi. Në shumicën e zonave problematike jeton një numër i madh personash që kanë emigruar nga Ballkani perëndimor, por në disa prej tyre kjo diasporë nuk ekziston (si në Amerikën Latine). Disa zona problematike kanë institucione dhe sisteme drejtësie relativisht të dobëta, dhe u bënë vende tërheqëse për grupet kriminale gjatë një periudhe tranzicioni, por në disa zona të tjera kjo nuk qëndron (si në Evropën perëndimore, Australi dhe Turqi).

Gati të gjitha zonat problematike të identifikuar nga ky raport lidhen me drogat; me furnizimin e tyre (Amerika Latine), kalimin tranzit (Turqi), apo shpërndarje dhe shitje (Evropa perëndimore dhe Australia). Edhe trafikimi i emigrantëve dhe cigareve janë disa nga veprimtaritë kriminale për grupet ballkanike, veçanërisht në rastin e Turqisë.

Afrika e Jugut është një rast i veçantë. Duket se ky vend ka qenë një zonë problematike gjatë periudhës 2018–2019, si pasojë e larjes së hesapeve dhe hakmarrjeve midis një grupi të vogël personash që ishin lidhur në njëfarë mënyre me vrasjen e Arkanit. Nga ana tjetër, ka shenja se ky vend po kthehet në një zonë problematike për trafikimin e kokainës, edhe si pasojë e përfshirjes së grupeve nga Ballkani perëndimor.

Në pjesën më të madhe të këtyre zonave problematike, grupet kriminale nga Ballkani perëndimor kanë ngjitur shkallët e krimit gjatë 20 viteve të fundit. Disa individë nga qyteza të vogla në Ballkanin perëndimor (duke përfshirë shumë zona problematike që u identifikuan nga një raport i mëparshëm i GI-TOC) sot janë në gjendje që të organizojnë trafikimin e tonelatave me kokainë nga xhunglat e Amerikës Latine, nëpër portet më të mëdha në Evropë, deri tek rrugët e kryeqyteteve evropiane. Detarë dhe kriminelë nga Ballkani po përdorin jahte për të trafikuar drogë në Afrikën e Jugut dhe Australi, apo edhe emigrantë nga Turqia për në Evropën perëndimore. Ndërmjetës nga vende të Ballkanit perëndimor po bëjnë pazare droge dhe po lidhin marrëveshje

◀ **Brez i ri i trafikantëve nga Ballkani perëndimor është i aftë të përdorë teknologji të reja për të shmangur ndërhyrjet e forcave të ruajtjes së rendit.** © Millenius/Shutterstock

me disa nga kartelet më të mëdha të Amerikës Latine, mafias italiane, dhe grupeve turke me eksperiencë të madhe kriminale. Grupet nga Ballkani janë kthyer në aktorë kryesorë në skenën e krimit.

Shumica e aktiviteteve kriminale në zonat problematike nuk janë të dhunshme. Edhe në këtë rast Afrika e Jugut bën përjashtim, por duket se kjo erdhi si pasojë e konflikteve të brendshme që lidheshin më shumë me hakmarrje, dhe jo aq për rivalitetet mbi tregje kriminale. Kohët e fundit ka patur edhe raste dhune në Itali, tregues i një konflikti me grupe që mund të kundërshtojnë fuqizimin e rrjeteve shqiptare në disa nga tregjet kryesore të kokainës, si Roma. Një tjetër përjashtim bën edhe dhuna e ushtruar ndërmjet klaneve Shkaljarski and Kavacki. Sidoqoftë, përveç një numri të vogël vrasjesh në Evropën perëndimore, dhuna ushtrohet kryesisht në Serbi dhe Malin e Zi, dhe jo në zonat problematike të krimit jashtë Ballkanit.

Karakteristikat e grupeve

Është e vështirë të bësh përgjithësime rreth grupeve kriminale nga Ballkani perëndimor që veprojnë në zona problematike nëpër botë, ngaqë nuk ka një model të përbashkët organizimi, por edhe si pasojë e një mungese informacioni. Sidoqoftë, është e qartë se karteli ballkanik nuk ekziston, madje nuk ka as një mafia të mirëfilltë shqiptare. Ato teori presupozojnë një shkallë organizimi dhe koordinimi që nuk ekziston. Në realitet ka një numër grupesh dhe rrjetesh, që nganjëherë bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, apo edhe me grupe vendase.

Rrallë ndodh që grupet kriminale nga vendet e Ballkanit perëndimor në zona problematike nëpër botë të kenë vetëm anëtarë nga një kombësi e vetme, megjithëse grupet shqiptare tradicionalisht kanë preferuar të punojnë me persona nga fisi apo komuniteti i tyre. Ka edhe një prirje nga kriminelët e Ballkanit perëndimor që të punojnë me persona të tjerë nga ky rajon. Rastet e marra në shqyrtim nga ky raport tregojnë se grupet kriminale nga Ballkani perëndimor që veprojnë jashtë rajonit përshtaten shumë lehtë me kushtet e reja, dhe janë të gatshëm që të bashkëpunojnë ngushtë me persona të çfarëdolloj kombësie.

Mungesa e dhunës nga ana e grupeve nga Ballkani perëndimor tregon se mund të jenë treguar pragmatikë dhe kanë gjetur mënyra se si të shkojnë mirë me partnerët vendas dhe grupet e tjera, ose tregon se kanë besim të plotë në aftësitë e tyre për të kontrolluar aktivitete dhe tregje të caktuara. Alternativa e dytë mund të shpjegohet, në disa raste, me krijimin e aleancave me partnerë të fuqishëm, me reputacionin që kanë si të dhunshëm, me burime dhe rezerva të mjaftueshme për të siguruar pandëshkueshmërinë e tyre në vende ku sistemi i drejtësisë penale është i dobët, si dhe me ekzistencën e një ombrelle mbrojtëse në vendet e origjinës.

Disa nga anëtarët e këtyre grupeve – veçanërisht nga Serbia dhe Mali i Zi – akoma e ndiejnë trashëgiminë e luftërave në Jugosllavi në vitet 90, edhe pse shumë nga kriminelët e asaj gjenerate kanë vdekur, janë në burgje, ose janë tërhequr nga aktivitetet kriminale. Përjashtim bën Afrika e Jugut, ku u mbledhën një grup personash (pjesa më e madhe e tyre mbi moshën 50 vjeç) që kishin lidhje me ngjarje nga fillimi i viteve 2000, dhe që donin, në mënyrë paradoksale, që të shpëtonin nga e kaluara e tyre.

Ka edhe nga ata që janë pjesë e një 'brezi të dytë', që u larguan nga Ballkani perëndimor kur ishin fëmijë, apo që kanë lindur jashtë rajonit. Në disa raste, ata kanë lidhje me grupe nga Ballkani perëndimor, por në shumë raste u vihet damka si "kriminelë ballkanikë", edhe pse e vetmja lidhje me rajonin është mbiemri i tyre.

Në ditët e sotme ka dalë në skenë një brez i ri kriminelësh profesionistë që përdorin gjerësisht teknologjitë e reja.

Në ditët e sotme ka dalë në skenë një brez i ri kriminelësh profesionistë që dinë gjuhë të huaja, janë të aftë të përdorin teknologji të reja, të fshehin paratë në parajsë financiare dhe kriptomonedha, dhe që dinë të përfitojnë nga globalizimi. Ata janë kaluar nga Jugosfera në qytetarë të botës, dhe tani janë kthyer në personazhe që në Ballkan quheshin dikur 'biznesmenë disi të dyshimtë'. Ky brez i ri trafikantësh ka fituar njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë për të shmangur survejimin nga ana e forcave të rendit. Për shembull, ata përdorin GPS për transportimin dhe dorëzimin e drogave, apo për t'u orientuar në korridoret e trafikimit. Përdorin telefona satelitorë, Protokollet për Komunikim Vokal në Internet (Voice over Internet Protocols – VoIP), dhe komunikime interneti të koduara, që vështirë se mund të përgjohen. Po kështu, ata janë aktivë në internetin e fshehtë (darknet), dhe po përdorin gjithnjë e më shumë kriptomonedha, si Bitcoin, që është e vështirë të gjurmohen dhe bllokohen.

Një model biznesi i pashoq

Një nga konkluzionet më interesante të këtij raporti është evoluimi dhe forcimi i pozitave të grupeve kriminale nga Ballkani Perëndimor. Brenda një periudhe 20 vjeçare, ata kanë kaluar nga korrierë apo kriminelë të vegjël, që po mundoheshin t'i shpëtonin trazirave dhe varfërisë, në shpërndarës të mëdhenj droge në disa nga tregjet më të pasura në botë. Ata kanë arritur të pozicionohen pranë burimeve më të mëdha në botë të kokainës dhe heroinës, dhe madje – si në rastin e shqiptarëve – janë kthyer edhe në prodhues kanabisi. Janë aktivë edhe në tregtinë me pakicë, veçanërisht në Evropën perëndimore, falë aksesit në porte të BE-së si Anversa, Amsterdami, Hamburgu, Valencia, Algeciras, dhe Pireu.³¹⁶³¹⁷ Kanë krijuar lidhje edhe me shpërndarës rruge, duke përfshirë edhe bashkëkombësit e tyre nga vende të Ballkanit perëndimor. Kjo i ka dhënë mundësi që të ulin çmimet, duke bërë që përdoruesit e drogës të harxhojnë më pak, kanë siguruar një mall me cilësi më të lartë dhe me çmim të arsyeshëm, dhe si rezultat e kanë shkatërruar konkurrencën. Ky është një model biznesi i pashoq. Po të vazhdojnë të punojnë në këtë mënyrë, ky model biznesi do të vazhdojë të jetë shumë fitimprurës pasi kërkesat dhe ofertat për kokainë, heroinë, dhe kanabis janë të larta.

Ngritja e këtij lloji sistemi me të gjitha hallkat e zinxhirit të trafikimit nuk është diçka e rastit. Grupet kriminale nga Ballkani perëndimor kanë treguar se janë të gatshëm që ta marrin në sy rrezikun, si dhe të kërkojnë e shfrytëzojnë mundësi të reja, si për shembull përdorimi i koridoreve dhe teknologjive të reja. Ata kanë fituar respektin e partnerëve vendas në të dy krahët e zinxhirit të trafikut. Kanë treguar se janë inovativë, të shkathët dhe përshtaten lehtë me rrethanat e reja.

Faktorë ndihmës

Ky raport ka identifikuar një sërë faktorësh që kanë ndihmuar grupe kriminale nga Ballkani perëndimor që të ushtrorin aktivitetin jashtë këtij rajoni. Ashtu si u përmend edhe më lart, në disa raste këto faktorë janë qeverisja e dobët dhe korrupsioni në vendet ku zhvillojnë aktivitetet. Një tjetër faktor është edhe aftësia e tyre për të përdorur disa identitete dhe për të shmangur zbulimin nga forcat e rendit.

Edhe kontrolli i mangët i konteinerëve është një problem, ose si pasojë e korrupsionit, ose thjesht si rezultat i numrit të stërmadh të konteinerëve që kalojnë nëpër disa porte. Ka mundësi që një pjesë e këtyre mallrave të paligjshme kalojnë nëpërmjet zonave të lira ekonomike: kjo e bën të vështirë ndalimin e tyre. Në disa raste, kontrolli i dobët i kufirit dhe doganave, si dhe mangësi në patrullimin e detit, e bëjnë punën e trafikantëve relativisht të lehtë.

Ashtu si u përmend më lart, teknologjia është një nga faktorët ndihmës për grupet e analizuar në këtë raport: si për shembull, sistemet e kodimit, kriptomonedhat, dhe përdorimi i GPS. Edhe sistemi financiar duket se i ndihmon disa nga këto grupe në administrimin dhe transferimin e fondeve. Përndryshe, si ka mundësi që janë në gjendje që të lëvizin dhe të investojnë shuma qaq të mëdha parash? A janë në gjendje bankat dhe kompanitë e pronave të paluajtëshme që të njohin klientët e tyre?

Bashkëpunimi midis forcave të ruajtjes së rendit

Ndërkohë që kriminelët nga Ballkani vjelin frytet e bashkëpunimit ndërkombëtar, ky raport tregon se forcat e ruajtjes së rendit nga shtete të ndryshme mund të punojnë së bashku në mënyrë të efektshme. Operacioni Luftëtari i Ballkanit ishte një operacion i përbashkët midis DEA-s, shërbimit informativ serb, dhe forcave policore në Uruguai dhe Argjentinë, që mposhti Darko Shariç në vitin 2010. Ka patur edhe operacione të tjera të suksesshme me bashkëpunimin e forcave të ruajtjes së rendit nga SHBA, Evropa perëndimore, Amerika Latine, dhe vende të Ballkanit perëndimor. SELEC ka treguar se është një mekanizëm i efektshëm koordinimi gjatë zhvillimit të hetimeve të përbashkëta. Një nga avantazhet e SELEC është se Turqia është anëtare e saj.

Ka patur edhe shembuj të bashkëpunimit të frytshëm në operacione detare, si kapja e një sasia droge në shkurt 2020 pranë ishullit Aruba, në kuadër të një operacioni të përbashkët midis forcave të ruajtjes së rendit nga Serbia, Mali i Zi, Holanda, dhe Britania e Madhe. Në fakt, gjatë periudhës 2018 – 2020, numri operacioneve dhe sasia e drogës së kapur u rrit, ose si pasojë e një bashkëpunimi më të mirë midis forcave të ruajtjes së rendit, ose si pasojë e rritjes së volumit të trafikimit, ose të dy faktorët bashkë.

EUROPOL luan një rol kyç në këtë drejtim. Për shembull, më 11 mars 2020, EUROPOL njoftoi se kishte ndihmuar në shkatërrimin e një rrjeti të madh kriminal nga Ballkani që trafikonte droga, kryesisht kokainë, nga Amerika Latine në Evropë. Një operacion i komplikuar ndërkombëtar, që nisi në vitin 2017, ndaloi një katamaran që po trafikonte 840 kilogramë kokainë nga Karaibet për në Evropë.³¹⁸ Katër pjesëtarë të ekuipazhit me shtetësi boshnjake, malazeze, dhe serbe u arrestuan në vitin 2018, dhe disa anëtarë të tjerë të grupit u arrestuan më 10 mars 2020. Kjo tregon se EUROPOL mund të realizojë shkëmbimin e

I rëndësishëm është fakti që disa nga faktorët bazë që detyruan shumë persona nga Ballkani perëndimor që t'i hynin krimit të organizuar në vitet 90 ekzistojnë akoma: mungesa e vendeve të punës, korrupsioni, pabarazia, acarimi me situatën e tensionuar politike në vend dhe hapat e ngadaltë në procesin e hyrjes në BE. Nëse këto probleme nuk zgjidhen, mijëra të rinj në vendet e Ballkanit perëndimor, apo në diasporë, do të vazhdojnë të jenë të gatshëm që t'i futen rrugës së krimit.

informacionit, të sigurojë mbështetje për koordinimin e punës, dhe të analizojë informatat operative duke përdorur duke përdorur bazën e të dhënave që ka akumuluar nëpër vite në mënyrë që të informojë dhe të orientojë hetimet në drejtimin e duhur. Kjo përjasje është përdorur për t'iu kundërvënë trafikimit të qenieve njerëzore, dhe kontrabandës së cigareve, si dhe trafikimit të emigrantëve në Ballkanin perëndimor.

Eurojust po ndihmon vendet e Ballkanit perëndimor që të përmirësojnë kapacitetet e tyre, dhe japin ndihmë në ndjekjen penale të çështjeve të ndryshme. Në përgjithësi, duke qenë se ndjekja penale e çështjeve është hallka më e dobët kur vjen puna tek lufta kundër krimit të organizuar, ndihma e vendeve të tjera mund të jetë me vlerë, duke përfshirë edhe ekstradimin. Në disa raste, oficerë ndërlidhës nga forcat policore në vendet e Ballkanit perëndimor janë stacionuar në vendet e origjinës për të ndihmuar në identifikimin e të dyshuarve dhe analizimin e informatave. Ky lloj bashkëpunimi ka qenë i suksesshëm.

Është e nevojshme që të zhvillohet edhe bashkëpunimi dypalësh. Një shembull i mirë në këtë drejtim është bashkëpunimi ndërmjet forcave të ruajtjes së rendit në Itali dhe Shqipëri, duke përfshirë edhe operacione të përbashkëta. Italia, së bashku me SHBA-në dhe një numër vendesh të BE-së, ka mbështetur procesin e reformimit të sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri. Po kështu ka patur bashkëpunim edhe në kuadër të programit të ndihmës para hyrjes në BE (EU's Instrument for Pre-Accession Assistance), që jep asistencë financiare dhe teknike për vendet candidate për të hyrë në BE. Në disa raste, kjo ka mundësuar operacione të suksesshme kundër grupeve të krimit të organizuar dhe konfiskime të pasurive të krimit. Hetimet e zhvilluara kanë prekur të gjithë spektrin e aktiviteteve të krimit të organizuar – nga trafikimi i qenieve njerëzore, armëve, drogës, terrorizmit, dhe

pastrimit të parave të pista. Hetimet u zhvilluan si në vendet e Ballkanit perëndimor, ashtu edhe në vendet e BE-së, madje edhe në shtete të tjera. Bashkëpunimi me BE-në mund të jetë edhe më i efektshëm nëse vendet e Ballkanit perëndimor do të kenë akses në Sistemin e Informacionit Schengen (Schengen Information System). Kjo do të përmirësonte dhe do të shpejtonte punën e policisë dhe rojeve kufitare për identifikimin e personave të kërkuar.

INTERPOL luan një rol të rëndësishëm në koordinimin e operacioneve të përbashkëta. Për shembull, në janar 2020 kjo agjenci drejtoi një operacion të madh kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimit të emigrantëve në Ballkan, me emrin Operacioni Tezeu (Theseus). Si rezultat i këtij operacioni, u arrestuan 72 persona të dyshuar si trafikantë, dhe 167 trafikues emigrantësh; u shpëtuan 89 viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, dhe u identifikuan 2,000 emigrantë.³¹⁹ Sistemi i Pullës së Kuqe (Red Notice) të INTERPOL-it ka rëndësi të dorës së parë për të identifikuar kriminelët.³²⁰ Është interesant fakti se INTERPOL kishte një projekt të tërë të dedikuar për kapjen e Panterave Rozë.

Mund të bëhet më shumë përsa i përket forcimit të bashkëpunimit ndërmjet forcave të ruajtjes së rendit në vendet e prodhimit dhe konsumit, dhe angazhimit në këtë proces të kolegëve të tyre nga Ballkani perëndimor. Po kështu, është e nevojshme të tregohet një vëmendje më e madhe ndaj sigurisë detare (veçanërisht nëpërmjet operacioneve të bazuara në të dhëna informative), dhe forcimit të kontrollit të konteinerëve, duke përdorur në mënyrë më të efektshme Programin e Kontrollit të Konteinerëve të Organizatës Botërore të Doganave (UNODC – World Customs Organization

Container Control Program). Po kështu, duhet që të përmirësohet urgjenisht asistencë e përbashkët ligjore ndërmjet vendeve të Ballkanit perëndimor dhe vendeve të tjera nëpër botë ku veprojnë më shumë grupet kriminale nga Ballkani perëndimor (zonat problematike).

